



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 177

Tiranë – E hënë, 10 gusht 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 19, datë 4.8.2026	Për miratimin e rregullave specifike për kryerjen e kontrolleve zyrtare në prodhimin e mishit dhe për zonat e prodhimit dhe të transferimit të molusqeve bivalvare të gjalla..... 17925
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 20, datë 4.8.2026	Për përcaktimin e kontrolleve të veçanta shëndetësore për mbledhjen dhe përpunimin e disa molusqeve bivalvare me një nivel të toksinës amnesike të molusqeve (ASP), që tejkalon kufirin 20 mg/kg..... 17936
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 6, datë 3.8.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016, “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, të ndryshuar..... 17938
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 7, datë 3.8.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 1649, datë 16.8.1999, “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar..... 17939
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 798, datë 4.8.2026	Për delegim të kompetencave..... 17946
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 11748, datë 5.8.2026	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare..... 17946
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 77, datë 23.6.2026	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-2121, datë 27.5.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë..... 17946

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 79, datë 30.6.2026	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 27, datë 13.2.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, nr. 00-2025-2165, datë 5.6.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë, me tjetër trup gjykues.	17957
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 197, datë 21.7.2026	Mbi pezullimin e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, lidhur me kërkesën e shoqërisë “Greensol” sh.p.k. për përfshirjen e veprave ndihmëse/njësi të depozitimit të energjisë elektrike në aneksin a, të licencës së prodhimit të energjisë elektrike, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit fotovoltaike.....	17967
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 198, datë 21.7.2026	Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, lidhur me kërkesën e shoqërisë “ASSA Energy Solutions” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	17968
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 199, datë 21.7.2026	Mbi kërkesën e shoqërisë “Bushttrica 2017” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	17969
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 200, datë 21.7.2026	Mbi pezullimin e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, lidhur me kërkesën e shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 20 mw.....	17971
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 201, datë 21.7.2026	Mbi pezullimin e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, lidhur me kërkesën e shoqërisë “Erseka Solar Park 2” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 20 mw.....	17972
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 202, datë 21.7.2026	Mbi pezullimin e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, lidhur me kërkesën e shoqërisë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 100 mw	17974
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 203, datë 21.7.2026	Mbi fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 50 mw.....	17976
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 204, datë 21.7.2026	Mbi pezullimin e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, lidhur me kërkesën e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 8.8 mw.....	17978
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 205, datë 21.7.2026	Mbi pezullimin e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, lidhur me kërkesën e shoqërisë “Power Energy” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 25 mw.....	17979
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 206, datë 21.7.2026	Mbi pezullimin e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, lidhur me kërkesën e shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 100 mw.....	17981

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 207, datë 21.7.2026	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Diezela” sh.p.k.....	17983
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 208, datë 24.7.2026	Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në kontratën “Për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti (KESH sh.a.), dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a.”	17985
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 209, datë 24.7.2026	Mbi miratimin e një ndryshimi në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 139, datë 14.4.2023, “Mbi miratimin e kufijve minimalë dhe maksimalë të lejuar të çmimit për tregun e ditës në avancë”	17991
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 796/16, datë 4.8.2026	Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Pastrim i kolektorit nga rruga ‘Demokracia’ deri tek rruga ‘Vasil Puka’, Bashkia Vlorë”	17993



UDHËZIM

Nr.19, datë 4.8.2026

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE
SPECIFIKE PËR KRYERJEN E
KONTROLLEVE ZYRTARE NË
PRODHIMIN E MISHIT DHE PËR
ZONAT E PRODHIMIT DHE TË
TRANSFERIMIT TË MOLUSQEVE
BIVALVORE TË GJALLA¹**

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 7 të nenit 18, të ligjit nr.61, datë 30.6.2026 “Për kontrollet zyrtare dhe aktivitete të tjera zyrtare të kryera për të garantuar zbatimin e legjislacionit mbi ushqimin dhe ushqimin për kafshë, rregullimeve mbi shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve si dhe mbi shëndetin e bimëve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

Neni 1

Objekti dhe fusha e zbatimit

1. Ky udhëzim përcakton rregulla specifike në lidhje me kryerjen e kontrolleve zyrtare të përmendura në nenin 18, pika 1, të ligjit nr. 61, datë 30.6.2026 “Për kontrollet zyrtare dhe aktivitete të tjera zyrtare të kryera për të garantuar zbatimin e legjislacionit mbi ushqimin dhe ushqimin për kafshë, rregullimeve mbi shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve si dhe mbi shëndetin e bimëve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve në Republikën e Shqipërisë”, këtu e në vijim ligji nr.61/2026 “Për kontrollet zyrtare”, të kryera mbi produktet me origjinë shtazore.

2. Këto rregulla specifike rregullojnë:

a) kriteret dhe kushtet për të përcaktuar:

i) rastet kur kontrolli para therjes (ante-mortem) në disa thertore mund të kryhet nën mbikëqyrjen ose nën përgjegjësinë e një veterineri zyrtar;

ii) rastet kur kontrolli para therjes (ante-mortem) mund të kryhet jashtë thertores në rast të therjes emergjente;

iii) rastet kur kontrolli para therjes (ante-mortem) mund të kryhet në fermën e origjinës;

iv) garancitë që duhet të jenë në fuqi për kryerjen e kontrolleve pas therjes (post-mortem) dhe të veprimtarive të auditimit nën përgjegjësinë e veterinerit zyrtar, siç përcaktohet në shkronjat (c) dhe (ç), të pikës 2 të nenit 18, të ligjit nr.61/2026 “Për kontrollet zyrtare”;

v) përjashtimet nga pika 6 e nenit 18, të ligjit nr.61/2026 “Për kontrollet zyrtare” lidhur me klasifikimin e zonave të prodhimit dhe të transferimit në lidhje me Pectinidae, gastropodët detarë dhe ekinodermët;

vi) rastet kur kontrollet zyrtare në impiantet e prerjes mund të kryhen nga personel i caktuar nga autoriteti kompetent për këtë qëllim dhe i trajnuar në mënyrë të përshtatshme;

b) përcaktimin e përjashtimeve specifike në lidhje me *Rangifer tarandus tarandus*, *Lagopus lagopus* dhe *Lagopus mutus*, me qëllim lejimin e vijimësisë së zakoneve dhe praktikave vendore dhe tradicionale të konsoliduara;

c) përcaktimin e kërkesave specifike minimale, përfshirë kërkesat për trajnim për veterinerin zyrtar, ndihmësin zyrtar dhe personelin e caktuar nga autoriteti kompetent, për të siguruar kryerjen e detyrave të përshkruara në nenin 18 të ligjit nr.61/2026 “Për kontrollet zyrtare”;

ç) përcaktimin e kërkesave minimale të përshtatshme për trajnim për personelin e thertoreve që ndihmon në kryerjen e detyrave të përshkruara në pikën 3 të nenit 18, të ligjit nr.61/2026 “Për kontrollet zyrtare”.

Neni 2

Përkufizime

1. Termat e përdorura në këtë udhëzim kanë të njëjtën kuptim me përkufizimet e nenit 4 të ligjit nr.61/2026 “Për kontrollet zyrtare”.

2. Sipas këtij udhëzimi, termat e mëposhtme kanë këtë kuptim:

1. “thertore” nënkupton një stabiliment që përdoret për therjen dhe përpunimin fillestar të kafshëve, mishi i të cilave është i destinuar për konsum njerëzor;

¹ Ky udhëzim është përafshuar pjesërisht me Rregulloren e Deleguar e Komisionit (BE) 2019/624, datë 8 shkurt 2019, mbi rregullat specifike për kryerjen e kontrolleve zyrtare në prodhimin e mishit dhe për zonat e prodhimit dhe të transferimit të molusqeve bivalvore të

gjalla, në përputhje me Rregulloren (BE) 2017/625 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (Tekst me rëndësi për ZEE-në); CELEX: 32019R0624, Fletorja e Bashkimit Evropian, seria L 131, datë 18.5.2019, faqet 1-17).



2. “ferma e origjinës” është ferma ku kafshët janë rritur për herë të fundit. Në rastin e cervidëve gjysmë të zbutur, që janë kafshë të familjes Cervidae të mbajtura nga njerëzit, megjithëse jo në një territor të mbyllur, ky term përfshin edhe grumbullimet që synojnë përzgjedhjen e kafshëve për therje;

3. “zonë prodhimi” është çdo zonë detare, estuarine ose lagunore, që përmban shtretër natyrorë të molusqeve dyguaskore ose zona të përdorura për kultivimin e tyre, dhe nga e cila merren molusqe dyguaskore të gjalla;

4. “zonë transferimi” është çdo zonë detare, estuarine ose lagunore, me kufij të përcaktuar qartë dhe të shënuar me bova, shtylla ose mjete të tjera fikse, e cila përdoret ekskluzivisht për pastrimin natyral të molusqeve dyguaskore të gjalla;

5. “personel i caktuar nga autoritetet kompetente” është një person, përveç ndihmësit zyrtar dhe veterinerit zyrtar, i cili është i kualifikuar në përputhje me këtë udhëzim për të vepruar në këtë cilësi në impiantet e prerjes dhe të cilit autoriteti kompetent i cakton kryerjen e veprimeve specifike;

6. “analizë e rrezikut” është një proces që përbëhet nga tre komponentë të ndërlidhur: vlerësimi i riskut, menaxhimi i riskut dhe komunikimi i riskut;

7. “impiant prerjeje” është një impiant i përdorur për heqjen e kockave dhe/ose prerjen e mishit;

8. “shpendë” janë shpendët e rritur në fermë, përfshirë shpendët që nuk konsiderohen shtëpiakë, por që rriten si kafshë shtëpiake, me përjashtim të ratitëve;

9. “lagomorfë” janë lepujt, lepurjt e egër dhe brejtësit;

10. “operator i biznesit ushqimor” është një person fizikë ose juridikë përgjegjës për sigurimin që kërkesat e legjislacionit të ushqimit përmbushen brenda biznesit ushqimor që është nën kontrollin e tij;

11. “ungulatë shtëpiake” janë kafshët shtëpiake të gjedhit (përfshirë llojet Bubalus dhe Bison), derrat, delet dhe dhitë, si dhe njëhundrakët shtëpiakë;

12. “mish” është pjesa e ngrënshme e ungulatëve shtëpiakë, shpendëve, lagomorfë, kafshë të egra gjahu, kafshë gjahu të mbarështuara, kafshë të egra të vogla të gjahut, kafshë të egra të mëdha të gjahut, përfshirë gjakun;¹³⁾ “kafshë gjahu të rritura në fermë” janë ratitët e rritur në fermë dhe gjiarët tokësorë të rritur në fermë, përveç njëhundrakëve shtëpiakë;

14. “konsumator përfundimtar” është konsumatori përfundimtar i një produkti ushqimor, i cili nuk do ta përdorë ushqimin si pjesë të ndonjë veprimtarie apo operacioni të biznesit ushqimor;

15. “tregti me pakicë” është trajtimi dhe/ose përpunimi i ushqimit dhe ruajtja e tij në pikën e shitjes ose të dorëzimit të konsumatori përfundimtar, dhe përfshin терминаlet e shpërndarjes, veprimtaritë e kateringut, mensat e fabrikave, kateringun institucional, restorantet dhe operacione të tjera të ngjashme të shërbimit ushqimor, dyqanet, qendrat e shpërndarjes së supermarketeve dhe pikat e shitjes me shumicë;

16. “njësi” është çdo njësi e një biznesi ushqimor;

17. “thertore me kapacitet të ulët” është një thertore të përcaktuar nga autoriteti kompetent në bazë të një analize të rrezikut dhe në të cilën therja kryhet vetëm gjatë një pjese të ditës së punës ose kryhet gjatë gjithë ditës së punës, por jo në çdo ditë pune të javës;

18. “njësi për trajtimin e gjahut me kapacitet të ulët” është një njësi për trajtimin e gjahut e përcaktuar nga autoriteti kompetent në bazë të një analize të rrezikut dhe në të cilën trajtimi i gjahut kryhet vetëm gjatë një pjese të ditës së punës ose kryhet gjatë gjithë ditës së punës, por jo në çdo ditë pune të javës;

19. “njësi blegtorale” është një njësi standarde matëse që lejon bashkimin e kategorive të ndryshme të bagëtive, në mënyrë që ato të mund të krahasohen;

20. “gjah i vogël i egër” është shpendë gjahu të egër dhe lagomorfë që jetojnë lirshëm në natyrë;

21. “njësi për trajtimin e gjahut” është çdo ndërmarrje në të cilën përgatiten gjahu dhe mishi i gjahut i siguruar pas gjuetisë, për t’u hedhur në treg;

22. “qendër dërgimi” është çdo stabiliment në tokë ose në det të hapur për pranimin, kondicionimin, larjen, pastrimin, klasifikimin, mbështjelljen dhe paketimin e molusqeve të gjalla bivalvare të përshtatshme për konsum njerëzor;

23. “molusqe bivalvare” janë molusqe bivalvare filtruese;

24. “përpunim” është çdo veprim që ndryshon në mënyrë të konsiderueshme produktin fillestar, përfshirë ngrohjen, tymosjen, kriposjen, maturimin, tharjen, marinimin, ekstraktimin, ekstrudimin ose një kombinim të këtyre proceseve;



25. “organe të brendshme” janë organet e zgavrave torakale, abdominale dhe pelvike, si dhe trakea dhe ezofagu, dhe te shpendët, gusha;

26. “prodhim parësor” është prodhimi, rritja ose kultivimi i produkteve primare, duke përfshirë korrien, mjeljen dhe prodhimin e kafshëve të fermës para therjes. Ai përfshin gjithashtu gjuetinë dhe peshkimin, si dhe mbledhjen e produkteve të egra;

27. “fermë për prodhimin e qumështit” është një stabiliment ku mbahen një ose më shumë kafshë të fermës për prodhimin e qumështit, me qëllim hedhjen e tij në treg si ushqim.

Neni 3

Kriteret dhe kushtet që përcaktojnë kur kontrollet para therjes (ante-mortem) në disa thertore mund të kryhen nga një ndihmës zyrtar

1. Me përjashtim të përcaktimeve të shkronjës “a”, të pikës 2 të nenit 18, të ligjit nr. 61/2026 “Për kontrollet zyrtare”, kontrollet para therjes (*ante-mortem*) mund të kryhen nga një ndihmës zyrtar nën mbikëqyrjen e veterinerit zyrtar për specie të tjera përveç shpendëve dhe lagomorfëve, me kusht që procedurat e zbatuara në thertore të jenë në përputhje me kriteret dhe kushtet e mëposhtme:

a) detyrat në kuadër të kontrolleve para therjes (ante-mortem) janë të natyrës praktike dhe kanë të bëjnë vetëm me një ose më shumë nga sa vijon:

i) verifikimin që operatori i biznesit ushqimor respekton kërkesat që lidhen me informacionin e zinxhirit ushqimor dhe me kontrollin e identitetit të kafshës;

ii) përzgjedhjen paraprake të kafshëve që shfaqin anomali të mundshme në lidhje me kërkesat për shëndetin e njeriut, shëndetin e kafshëve dhe mirëqenien e kafshëve;

b) veterineri zyrtar njoftohet menjëherë nga ndihmësi zyrtar që kryen kontrollin kur vërehen ose dyshohen anomali të mundshme dhe veterineri zyrtar më pas kryen personalisht kontrollin para therjes (ante-mortem); dhe

c) veterineri zyrtar verifikon rregullisht zbatimin e detyrave në mënytë të rregullt nga ndihmësi zyrtar.

2. Me përjashtim të shkronjës “a”, e pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr. 61/2026 “Për kontrollet zyrtare”, kontrollet para therjes (ante-mortem) kryhen për të gjitha speciet nga një ndihmës zyrtar në një thertore

nën përgjegjësinë e veterinerit zyrtar, me kusht që të plotësohen kriteret dhe kushtet e mëposhtme:

a) kontrolli para therjes (ante-mortem) është kryer tashmë nga veterineri zyrtar në fermën e origjinës, në përputhje me nenin 5 të këtij udhëzimi;

b) veterineri zyrtar njoftohet menjëherë nga ndihmësi zyrtar që kryen kontrollin kur vërehen ose dyshohen anomali të mundshme dhe veterineri zyrtar më pas kryen personalisht kontrollin para therjes (ante-mortem); dhe

c) veterineri zyrtar verifikon rregullisht zbatimin e detyrave në mënytë të rregullt nga ndihmësi zyrtar.

3. Përjashtimet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen:

a) për kafshët që i nënshtrohen therjes emergjente të përmendur në kreun III, seksioni A, pika 19 të udhëzimit të ministrit nr.23, datë 25.11.2010 “Për kërkesat specifike të higjienës për mishin dhe produktet e mishit, duke përfshirë produktet e mishit, mishin e grirë dhe mishin e ndarë në mënyrë mekanike”, i ndryshuar;

b) për kafshët për të cilat dyshohet se kanë një sëmundje ose gjendje që mund të ndikojë negativisht në shëndetin e njeriut;

c) për gjedhët nga njësi të përcaktuara në pikën 27 të nenit 4 të ligjit nr.41/2025 “Për shëndetin e kafshëve”, të cilave nuk u është dhënë statusi “të lira nga infeksioni me kompleksin Mycobacterium tuberculosis” (M. bovis, M. caprae dhe M. tuberculosis), siç përcaktohet në seksionet 1 dhe 2 të pjesës II të kreut I, të aneksit IV të udhëzimit të ministrit për rregullat për mbikëqyrjen, programet e çrrënjësjes dhe statusin e të qenit i lirë nga sëmundja për disa nga sëmundjet e listuara dhe sëmundjet e reja në shfaqje, që transponon rregullat e BE-së në Republikën e Shqipërisë;

ç) për gjedhët, dhentë ose dhitë nga njësi të përcaktuara në pikën 27 të nenit 4 të ligjit nr.41/2025 “Për shëndetin e kafshëve”, të cilave nuk u është dhënë statusi “të lira nga infeksioni me Brucella abortus, B. melitensis dhe B. suis pa vaksinim”, siç përcaktohet në seksionet 1 dhe 2 të pjesës I të kreut 1 të aneksit IV të udhëzimit të ministrit për rregullat për mbikëqyrjen, programet e çrrënjësjes dhe statusin e të qenit i lirë nga sëmundja për disa nga sëmundjet e listuara dhe sëmundjet e reja në shfaqje që transponon rregullat e BE-së në Republikën e Shqipërisë;

d) për kafshët që vijnë nga një zonë e kufizuar, siç përcaktohet në nenin 126, pika 1, shkronja b)



nënparagrafi (iii), të ligjit nr.41/2025 “Për shëndetin e kafshëve”, dhe që i nënshtrohen kufizimeve brenda asaj zone;

dh) për kafshët që i nënshtrohen kontrolleve më të rrepta për shkak të përhapjes së sëmundjeve në zhvillim ose sëmundjeve të veçanta të listuara nga Organizata Botërore për Shëndetin e Kafshëve.

Neni 4

Kriteret dhe kushtet që përcaktojnë kur kontrollet para therjes (ante-mortem) mund të kryhen jashtë thertores në rast të therjes emergjente

1. Me përjashtim të përcaktimeve të shkronjës “a”, të pikës 2 të nenit 18, të ligjit nr.61/2026 “Për kontrollet zyrtare”, veterineri zyrtar kryen kontrollet para therjes (ante-mortem) jashtë thertores në rast të therjes emergjente, vetëm në rastin e ungulatëve shtëpiakë dhe me kusht që të respektohen kërkesat për therjen emergjente të përcaktuara në pikat 33, 34 dhe 38 të udhëzimit të ministrit nr.23, datë 25.11.2010 “Për kërkesat specifike të higjienës për mishin dhe produktet e mishit, duke përfshirë produktet e mishit, mishin e grirë dhe mishin e ndarë në mënyrë mekanike”.

2. Modeli i certifikatës shëndetësore, siç përcaktohet në udhëzimin e ministrit për modelin e certifikatave zyrtare për kafshë dhe mallra të caktuara, që përafron rregullat e BE-së në Republikën e Shqipërisë, lëshohet për kafshët e përshtatshme për therje. Certifikata shëndetësore shoqëron kafshët deri në thertore ose dërgohet paraprakisht në çdo format. Çdo vëzhgim i rëndësishëm për kontrollin pasues të mishit regjistrohet në certifikatën shëndetësore.

Neni 5

Kriteret dhe kushtet e përgjithshme që përcaktojnë kur kontrollet para therjes (ante-mortem) mund të kryhen në fermën e origjinës

1. Me përjashtim të përcaktimeve të shkronjës “a” dhe “b”, të pikës 2 të nenit 18, të ligjit nr.61/2026 “Për kontrollet zyrtare”, autoriteti kompetent mund të lejojë që kontrollet para therjes (ante-mortem) për kafshët e destinuara për therje të kryhen në fermën e origjinës, në përputhje me kriteret dhe kushtet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni dhe në nenin 6 të këtij udhëzimi.

2. Kriteret dhe kushtet e mëposhtme zbatohen për të gjitha speciet:

a) kontrolle mbi regjistrat ose dokumentacionin në fermën e origjinës, përfshirë verifikimin e informacionit të zinxhirit ushqimor;

b) ekzaminimi individual i kafshëve lehtësohet nga operatori i biznesit ushqimor, nëse kërkohet;

c) kontrollet para therjes (ante-mortem) në fermën e origjinës përfshijnë ekzaminim fizik të kafshëve për të përcaktuar nëse:

i) ato kanë një sëmundje ose gjendje që mund të transmetohet te kafshët ose te njerëzit përmes trajtimit ose konsumimit të mishit të këtyre kafshëve, ose nëse sillen, individualisht ose kolektivisht, në një mënyrë që tregon se një sëmundje e tillë ka ndodhur;

ii) ato shfaqin çrregullime të përgjithshme të sjelljes, shenja sëmundjeje ose anomali që mund ta bëjnë mishin e këtyre kafshëve të papërshtatshëm për konsum njerëzor;

iii) ka prova ose arsye për të dyshuar se kafshët mund të përmbajnë mbetje kimike mbi nivelet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, ose mbetje të substancave të ndaluara;

iv) ato shfaqin shenja që tregojnë probleme të lidhura me mirëqenien e kafshëve, përfshirë papastërti të tepruar;

v) ato janë të përshtatshme për transport.

ç) kontrollet dhe kontrolli para therjes (ante-mortem) në fermën e origjinës të parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të kësaj pike, kryhen nga një veteriner zyrtar;

d) kafshët e përshtatshme për therje identifikohen në mënyrë të duhur, ndahen nga kafshët e tjera dhe dërgohen në thertore drejtpërdrejt nga ferma e origjinës;

dh) një certifikatë shëndetësore, siç përcaktohet në udhëzimin e ministrit për modelin e certifikatave zyrtare për kafshë dhe mallra të caktuara, që transponon rregullat e BE-së në Republikën e Shqipërisë, lëshohet për kafshët e përshtatshme për therje. Certifikata shëndetësore shoqëron kafshët deri në thertore ose dërgohet paraprakisht në çdo format. Çdo vëzhgim i rëndësishëm për kontrollin pasues të mishit regjistrohet në certifikatën shëndetësore.

3. Në thertore kryhen kontrollet shtesë të mëposhtme në përputhje me shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 2 të nenit 18, të ligjit nr.61/2026 “Për kontrollet zyrtare” dhe nenin 3 të këtij udhëzimi:



a) verifikimi i rregullt i zbatimit të detyrimit nga operatorët e biznesit ushqimor për të siguruar që kafshët të jenë të identifikuar në mënyrën e duhur;

b) verifikimi i rregullt që rregullat për mirëqenien e kafshëve janë respektuar gjatë transportit dhe në momentin e mbërritjes në thertore, si dhe nëse ka shenja të ndonjë gjendjeje që mund të ndikojë negativisht në shëndetin e njeriut ose të kafshëve.

4. Në rast se kafshët nuk theren brenda tre ditëve, ose brenda 28 ditëve në rastet e parashikuara në pikën 5 të nenit 6 të këtij udhëzimi, nga data e lëshimit të certifikatës shëndetësore të përmendur në shkronjën (dh) të pikës 2 të këtij neni:

a) kur kafshët nuk janë dërguar nga ferma e origjinës në thertore, kryhet një kontroll shtesë para therjes (ante-mortem) dhe lëshohet një certifikatë e re shëndetësore;

b) kur kafshët janë aktualisht në rrugë për në thertore ose ndodhen në thertore, therja mund të autorizohet sapo të jetë vlerësuar arsyeja e vonësës, me kusht që kafshët t'i nënshtrohen një kontrolli shtesë para therjes (ante-mortem), në përputhje me kërkesat për inspektimin para therjes në thertore, të përcaktuara në udhëzimin e ministrit për vendosjen e procedurave praktike të unifikuara për kryerjen e kontrolleve zyrtare të produkteve me origjinë shtazore të destinuara për konsum njerëzor, në përputhje me ligjin për kontrollët zyrtare, që transponon rregullat e BE-së në Republikën e Shqipërisë.

Neni 6

Kriteret dhe kushtet specifike sipas specieve që përcaktojnë kur kontrollet para therjes (ante-mortem) mund të kryhen në fermën e origjinës

1. Autoriteti kompetent zbaton kriteret dhe kushtet specifike të përcaktuara në këtë nen në rastet përkatëse për shpendët, kafshët e gjahut të rritura në fermë, gjedhët, dhentë, dhitë dhe derrat shtëpiakë, si dhe solipedët shtëpiakë.

2. Në rastin e shpendëve të rritur për prodhimin e “foie gras” dhe të shpendëve të vonuar të paevisceruar, të therur në fermën e origjinës, certifikata shëndetësore e plotësuar në përputhje me modelin e certifikatës shëndetësore të përcaktuar në kreun 2 të aneksit IV të udhëzimit të ministrit që përcakton rregullat për zbatimin e ligjit nr.41/2025 “Për shëndetin e kafshëve” dhe ligjit nr.61/2026

“Për kontrollet zyrtare” në lidhje me modelet e certifikatave të shëndetit të kafshëve, modelet e certifikatave zyrtare dhe modelet e certifikatave të kombinuara të shëndetit të kafshëve/zyrtare, për hyrjen në Republikën e Shqipërisë dhe lëvizjen brenda Republikës së Shqipërisë të dërgesave të kategorive të caktuara të kafshëve dhe mallrave, si dhe certifikimin zyrtar që lidhet me këto certifikata, që transponon rregullat e BE-së në Republikën e Shqipërisë, që shoqëron karkasat e paevisceruara deri në thertore ose në impiantin e prerjes, ose dërgohet paraprakisht në çdo format, në vend të certifikatës shëndetësore të përmendur në shkronjën “dh” të pikës 2 të nenit 5 të këtij udhëzimi.

3. Në rastin e kafshëve gjedhë, dhen, dhi dhe derra shtëpiakë, solipedëve shtëpiakë dhe kafshëve të gjahut të rritura në fermë, të therura në fermën e origjinës në përputhje me parashikimet e kreut III, seksioni A, pika 19 ose kreun II, seksioni D, pika 3 e udhëzimit të ministrit nr.23, datë 25.11.2010 “Për kërkesat specifike të higjienës për mishin dhe produktet e mishit, duke përfshirë produktet e mishit, mishin e grirë dhe mishin e ndarë në mënyrë mekanike”, certifikata shëndetësore e plotësuar në përputhje me modelin e certifikatës shëndetësore të përcaktuar në kreun 3 të Aneksit IV të udhëzimit të ministrit që përcakton rregullat për zbatimin e ligjit nr.41/2025 “Për shëndetin e kafshëve” dhe ligjit nr.61/2026 “Për kontrollet zyrtare” në lidhje me modelet e certifikatave të shëndetit të kafshëve, modelet e certifikatave zyrtare dhe modelet e certifikatave të kombinuara të shëndetit të kafshëve/zyrtare, për hyrjen në Republikën e Shqipërisë dhe lëvizjen brenda Republikës së Shqipërisë të dërgesave të kategorive të caktuara të kafshëve dhe mallrave, si dhe certifikimin zyrtar që lidhet me këto certifikata, që transponon rregullat e BE-së në Republikën e Shqipërisë, që shoqërojnë kafshët deri në thertore ose, në rastin e kafshëve të gjahut të rritura në fermë, ose deri në thertore ose në njësinë për trajtimin e gjahut, ose dërgohet paraprakisht në çdo format, në vend të certifikatës shëndetësore të përmendur në shkronjën “dh” të pikës 2 të nenit 5 të këtij udhëzimi.

4. Në rastin e kafshëve të gjahut të rritura në fermë, të therura në fermën e origjinës në përputhje me kreun II, seksioni D, pika 3 e udhëzimit të ministrit nr.23, datë 25.11.2010 “Për kërkesat specifike të higjienës për mishin dhe produktet e



mishit, duke përfshirë produktet e mishit, mishin e grirë dhe mishin e ndarë në mënyrë mekanike”;

a) një certifikatë shëndetësore e plotësuar në përputhje me modelin e certifikatës shëndetësore të përcaktuar në kreun 4 të aneksit IV të udhëzimit të ministrit që përcakton rregullat për zbatimin e ligjit nr.41/2025 “Për shëndetin e kafshëve” dhe ligjit nr.61/2026 “Për kontrollet zyrtare” në lidhje me modelet e certifikatave të shëndetit të kafshëve, modelet e certifikatave zyrtare dhe modelet e certifikatave të kombinuara të shëndetit të kafshëve/zyrtare, për hyrjen në Republikën e Shqipërisë dhe lëvizjen brenda Republikës së Shqipërisë të dërgesave të kategorive të caktuara të kafshëve dhe mallrave, si dhe certifikimin zyrtar që lidhet me këto certifikata, që transpozon rregullat e BE-së në Republikën e Shqipërisë shoqërojnë kafshët deri në thertore ose në njësinë për trajtimin e gjahut, ose dërgohet paraprakisht në çdo format, në vend të certifikatës shëndetësore të përmendur në shkronjën “dh” të pikës 2 të nenit 5 të këtij udhëzimi:

b) veterineri zyrtar verifikon rregullisht që personat që kryejnë therjen dhe gjakderdhjen i realizojnë detyrat e tyre në mënyrë të duhur.

5. Me përjashtim nga pika 4 e nenit 5, të këtij udhëzimi, mund të lejohet therja e kafshëve të gjahut të rritura në fermë deri në 28 ditë nga data e lëshimit të certifikatës shëndetësore të përmendur në shkronjën “dh” të pikës 2 të nenit 5 të këtij udhëzimi:

a) vetëm sasi të vogla të mishit të kafshëve të gjahut të rritura në fermë furnizohen drejtpërdrejt nga prodhuesi te konsumatori përfundimtar ose te njësitë vendore të tregtisë me pakicë që furnizojnë drejtpërdrejt konsumatorin përfundimtar; dhe

b) nuk theren më shumë se 50 kafshë në vit për çdo fermë të origjinës.

Neni 7

Kriteret dhe kushtet për kryerjen e kontrolleve pas therjes (post-mortem) nën përgjegjësinë e veterinerit zyrtar, të përmendura në nenin 18, pika 2, shkronja (c), të ligjit nr.61/2026 “Për kontrollet zyrtare”

1. Kontrollet pas therjes (post-mortem) të parashikuara në nenin 18, pika 2, shkronja “c”, të ligjit nr.61/2026 “Për kontrollet zyrtare” kryhen nga ndihmësi zyrtar nën përgjegjësinë e veterinerit zyrtar, me kusht që të respektohen parashikimet e

kreu II i aneksit të këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij, kur plotësohen kriteret dhe kushtet e mëposhtme:

a) therja ose aktivitetet e trajtimit të gjahut kryhen në një thertore me kapacitet të ulët ose në një njësi për trajtimin e gjahut me kapacitet të ulët, e cila ther ose trajton:

i) më pak se 1 000 njësi blegtorale në vit; ose

ii) më pak se 150 000 shpendë, lagomorfë dhe gjah të vogël të egër në vit;

b) autoriteti kompetent mund të rrisë pragjet e përcaktuara në shkronjën “a” të kësaj pike, duke siguruar që përjashtimi të zbatohet në thertoret dhe njësitë për trajtimin e gjahut më të vogla që përmbushin përkufizimin e thertores me kapacitet të ulët ose të njësisë për trajtimin e gjahut me kapacitet të ulët, dhe me kusht që prodhimi vjetor i kombinuar i këtyre njësisë të mos tejkalojë 5 % të sasisë totale të mishit të freskët të prodhuar në Republikën e Shqipërisë:

i) për speciet përkatëse;

ii) për të gjithë ungulatët së bashku;

iii) për të gjithë shpendët së bashku; ose,

iv) për të gjithë shpendët dhe lagomorfët së bashku;

c) stabilimenti përkatës ka ambiente të mjaftueshme për të ruajtur mishin me anomali veçmas nga mishi tjetër deri sa veterineri zyrtar të mund të inspektojë personalisht mishin me anomali;

ç) veterineri zyrtar i pranishëm në njësi të paktën një herë në ditë, përfshirë rregullisht gjatë aktiviteteve të therjes;

d) autoriteti kompetent ka vendosur procedurën e vlerësimit në mënyrë të rregullt të performancës së ndihmësve zyrtarë në këto njësi, duke përfshirë:

i) monitorimin e performancës individuale;

ii) verifikimin e dokumentacionit mbi gjetjet e kontrollit dhe krahasimin e tij me karkasat përkatëse;

iii) kontrollin e karkasave në dhomën e magazinimit;

dh) është kryer një analizë e rrezikut nga autoriteti kompetent, duke marrë të paktën në konsideratë elementet e mëposhtme:

i) numrin e kafshëve të therura ose të trajtuara për orë ose për ditë;

ii) speciet dhe kategoritë e kafshëve të therura ose të trajtuara;

iii) kapacitetin përpunues të njësisë;

iv) performancën historike të aktiviteteve të therjes ose të trajtimit;



v) efektivitetin e çdo mase shitesë në zinxhirin ushqimor të ndërmarrë për të garantuar sigurinë ushqimore të kafshëve të destinuara për therje;

vi) efektivitetin e procedurave të bazuara në analizën e rreziqeve dhe pikat kritike të kontrollit (HACCP);

vii) regjistrat e auditimit;

viii) regjistrat historikë të autoritetit kompetent për kontrollet para therjes (ante-mortem) dhe pas therjes (post-mortem).

2. Në zbatim të parashikimeve të nënparagrafit “i” të shkronjës “a” të pikës 1 të këtij neni, përdoren normat e konvertimit të përcaktuara në kreun III, pika 17, të udhëzimit nr. 7, datë 17.7.2013 “Për mbrojtjen e kafshëve gjatë therjes”, të ndryshuar. Megjithatë, në rastin e kafshëve dhentë dhe dhitë, si dhe drerët e vegjël (< 100 kg peshë e gjallë), përdoret norma e konvertimi prej 0,05 njësi blegtorale, ndërsa në rastin e gjahut tjetër të madh përdoret norma e konvertimit prej 0,2 njësi blegtorale.

Neni 8

Kryerja e kontrolleve pas therjes (post-mortem) nga veterineri zyrtar

1. Kontrolli pas therjes (post-mortem) kryhet nga veterineri zyrtar në rastet e mëposhtme:

a) për kafshët që i nënshtrohen therjes emergjente të përmendur në kreun II, seksioni D, pika 3 e udhëzimit nr.23, datë 25.11.2010 “Për kërkesat specifike të higjienës për mishin dhe produktet e mishit, duke përfshirë produktet e mishit, mishin e grirë dhe mishin e ndarë në mënyrë mekanike”;

b) për kafshët për të cilat dyshohet se kanë një sëmundje ose gjendje që mund të ndikojë negativisht në shëndetin e njeriut;

c) për gjedhët nga njësi të përcaktuara në nenin 4, pika 27, të ligjit nr.41/2025 “Për shëndetin e kafshëve”, të cilave nuk u është dhënë statusi “të lira nga infeksioni me kompleksin Mycobacterium tuberculosis” (M. bovis, M. caprae dhe M. tuberculosis), siç përcaktohet në pjesën II, kreu 1, seksionet 1 dhe 2, të aneksit IV të udhëzimit të ministrit për rregullat për mbikëqyrjen, programet e çrrënjësjes dhe statusin e të qenit i lirë nga sëmundja për disa nga sëmundjet e listuara dhe sëmundjet e reja në shfaqje, që transpozon rregullat e BE-së në Republikën e Shqipërisë;

ç) për gjedhët, dhentë ose dhitë nga njësi të përcaktuara në nenin 4, pika 27, të ligjit 41/2025 “Për shëndetin e kafshëve”, të cilave nuk u është dhënë statusi “të lira nga infeksioni me Brucella abortus, B. melitensis dhe B. suis pa vaksinim”, siç përcaktohet në pjesën I, kreu 1, seksionet 1 dhe 2 të aneksit IV të udhëzimit të ministrit për rregullat për mbikëqyrjen, programet e çrrënjësjes dhe statusin e të qenit i lirë nga sëmundja për disa nga sëmundjet e listuara dhe sëmundjet e reja në shfaqje që transpozon rregullat e BE-së në Republikën e Shqipërisë.

d) për kafshët që vijnë nga një zonë e kufizuar, siç përcaktohet në nenin 126, pika 1, shkronja (b) nënparagrafi (iii), të ligjit nr.41/2025 “Për shëndetin e kafshëve”, dhe që i nënshtrohen kufizimeve brenda asaj zone;

dh) kur kontrollet më të rrepta janë të nevojshme për të marrë në konsideratë sëmundjet në zhvillim ose sëmundjet e veçanta të listuara nga Organizata Botërore për Shëndetin e Kafshëve;

e) në rast përjashtimi lidhur me kohën e kryerjes së kontrollit pas therjes (post-mortem), në përputhje me udhëzimin e ministrit për vendosjen e procedurave praktike të unifikuara për kryerjen e kontrolleve zyrtare të produkteve me origjinë shtazore të destinuara për konsum njerëzor, në përputhje me ligjin për kontrollet zyrtare, që transpozon rregullat e BE-së në Republikën e Shqipërisë.

Neni 9

Kriteret dhe kushtet për kryerjen e veprimtarive të auditimit në thertore dhe në njësitë për trajtimin e gjahut

Veprimtaritë e auditimit të përmendura në nenin 18, pika 2, shkronja “d”, nënparagrafi “iii”, të ligjit nr.61/2026 “Për kontrollet zyrtare” mund të kryhen në thertore dhe në njësitë për trajtimin e gjahut nga ndihmësit zyrtarë nën përgjegjësinë e veterinerit zyrtar vetëm në lidhje me mbledhjen e informacionit mbi praktikën e mira të higjienës dhe procedurat e bazuara në HACCP, me kusht që të respektohet kreu II i aneksit të këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.



Neni 10

Kriteret dhe kushtet për kryerjen e kontrolleve zyrtare, përfshirë veprimtaritë e auditimit, në impiantet e prerjes

Kontrollet zyrtare të përmendura në nenin 18, pika 2, shkronja “d”, përfshirë veprimtaritë e auditimit, në impiantet e prerjes mund të kryhen gjithashtu nga personel tjetër i caktuar nga autoritetet kompetente, me përjashtim nga kërkesat e përcaktuara në nenin 18, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr.61/2026 “Për kontrollet zyrtare”, me kusht që autoritetet kompetente të verifikojnë rregullisht punën e këtij personeli. Kryerja e këtyre veprimtarive i nënshtrohet respektimit të kreut III të aneksit të këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Neni 11

Kontrollet zyrtare mbi Pectinidae, gastropodët detarë dhe ekinodermët, të cilët nuk janë filtrues, të cilët mbliidhen nga zona prodhimi që nuk janë klasifikuar në përputhje me pikën 6, të nenit 18, të ligjit nr.61/2026 “Për kontrollet zyrtare”

1. Me përjashtim të parashikimeve të nenit 18, pika 6, të ligjit nr.61/2026 “Për kontrollet zyrtare”, klasifikimi i zonave të prodhimit dhe të transferimit nuk kërkohet në lidhje me mbledhjen e Pectinidae, gastropodëve detarë dhe ekinodermëve, të cilët nuk janë filtrues, kur autoriteti kompetent kryen kontrolle zyrtare mbi këto kafshë në ankandet e peshkut, në qendrat e dërgimit dhe në njësitë e përpunimit.

2. Këto kontrolle zyrtare verifikojnë përputhshmërinë me:

a) standardet shëndetësore për molusqet bivalvore të gjalla të përcaktuara në kreun II të seksionit I, pika 27 të udhëzimit nr. 25 datë 25.11.2010 “Për kushtet higjienike dhe kontrollet për molusqet e gjalla bivalvore, peshkun dhe produktet e peshkimit”;

b) kërkesat specifike për Pectinidae, gastropodët detarë dhe ekinodermët që nuk janë filtrues, të cilët mbliidhen jashtë zonave të prodhimit të klasifikuara, të përcaktuara në kreun II, seksioni I, pika 35 e udhëzimit nr. 25 datë 25.11.2010 “Për kushtet higjienike dhe kontrollet për molusqet e gjalla bivalvore, peshkun dhe produktet e peshkimit”.

Neni 12

Kërkesat minimale specifike për veterinerin zyrtar, ndihmësin zyrtar dhe personelin e caktuar nga autoriteti kompetent

1. Veterinerët zyrtarë që kryejnë detyrat e parashikuara në nenin 18 të ligjit nr.61/2026 “Për kontrollet zyrtare” duhet të përmbushin kërkesat minimale specifike të përcaktuara në kreun I të aneksit të këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Me përjashtim të parashikimeve të në pikat 1 deri në 6 të kreut I të aneksit të këtij udhëzimi, ministri ka të drejtë të miratojë rregulla specifike për:

a) veterinerët zyrtarë që punojnë me kohë të pjesshme, të cilët janë përgjegjës për inspektimin e bizneseve të vogla ose kryejnë vetëm kontrolle zyrtare në prodhimin primar, në veçanti kontrolle në fermat e prodhimit të qumështit dhe kontrolle para therjes (ante-mortem) jashtë thertoreve; dhe

b) studentët e mjekësisë veterinarë që kanë kaluar me sukses një provim mbi lëndët e përmendura në pikën 3 të kreut I të aneksit të këtij udhëzimi dhe që punojnë përkohësisht në një thertore në prani të një veterineri zyrtar.

3. Veterinerët e emëruar si veterinerë zyrtarë përpara datës së fillimit të efekteve të këtij udhëzimi duhet të kenë njohuri të mjaftueshme për lëndët e përmendura në pikën 3 të Kreut I të Aneksit të këtij udhëzimi. Kur është e nevojshme, autoriteti kompetent siguron që këto njohuri të përfitohen përmes aktiviteteve të trajnimit të vazhdueshëm.

4. Ndihmësit zyrtarë që zbatojnë detyrat e parashikuara në nenin 18 të ligjit nr.61/2026 “Për kontrollet zyrtare” duhet të përmbushin kërkesat minimale specifike të përcaktuara në kreun II të aneksit të këtij udhëzimi.

5. Personeli i caktuar nga autoriteti kompetent që kryen detyrat e parashikuara në nenin 18 të ligjit nr.61/2026 “Për kontrollet zyrtare” duhet të përmbushë kërkesat minimale specifike të përcaktuara në kreun III të aneksit të këtij udhëzimi.

Neni 13

Kërkesat minimale të trajnimit për personelin e thertoreve

Personeli i thertoreve që ndihmon në kryerjen e detyrave që lidhen me kontrollet zyrtare dhe veprimtari të tjera kontrolli, në përputhje me nenin 18, pika 3, të ligjit nr.61/2026 “Për kontrollet



zyrtare”, trajnohet nëpërputhje me kërkesat e autoritetit kompetent. Ai gjithashtu duhet të përmbushë kërkesat minimale të trajnimit të përcaktuara në kreun II të aneksit të këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse tij, në masën që ato janë të zbatueshme për detyrat e tij ndihmëse.

Neni 14

Dispozita të fundit

1. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimeve në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe autoriteti kompetent për kryerjen e kontrollit zyrtar për zbatimin e këtij urdhri.

2. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 gusht 2027.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL

Andis Salla

ANEKS

KËRKESAT MINIMALE SPECIFIKE PËR VETERINERIN ZYRTAR, NDËHËMSIN ZYRTAR DHE PERSONELIN E CAKTUAR NGA AUTORITETI KOMPETENT

KREU I

1. Autoriteti kompetent ka të drejtë të emërojë si veteriner zyrtar vetëm veterinerët që kanë kaluar provimin sipas kërkesave të e përcaktuara në pikën 3 të këtij kreu.

2. Autoriteti kompetent merr masa për organizimin e provimit për kandidatët që aplikojnë për t'u emëruar si veteriner zyrtar.

3. Provimi duhet të demonstrojë njohuri mbi subjektet e mëposhtme, të orientuara në mënyrë specifike drejt detyrave të veterinerit zyrtar dhe në masën e nevojshme, në varësi të formimit dhe kualifikimeve të veterinerit, duke shmangur çdo përsëritje të provimeve mbi njohuritë dhe aftësitë e kërkuara për mjekun veterinar në përputhje me nenin për trajnimin e mjekëve veterinerë në legjislacionin për për njohjen e kualifikimeve profesionale, që për afrosh legjislacionin e Bashkimit Evropian në Republikën e Shqipërisë:

a) legjislacioni kombëtar në fuqi mbi shëndetin e njeriut, sigurinë ushqimore, shëndetin e kafshëve, mirëqenien e kafshëve dhe substancat farmaceutike;

b) parimet e politikës bujqësore, masat e tregut, rimbursimet e eksportit dhe zbulimi i mashtrimeve, përfshirë kontekstin global: Marrëveshja e Organizatës Botërore të Tregtisë për masat sanitare dhe fitosanitare, Codex Alimentarius, Organizata Botërore për Shëndetin e Kafshëve;

c) bazat e përpunimit të ushqimit dhe teknologjisë ushqimore;

ç) parimet, konceptet dhe metodat e praktikës së mirë të prodhimit dhe të menaxhimit të cilësisë;

d) menaxhimi i cilësisë para vjeljes (praktikat e mira bujqësore);

dh) promovimi dhe zbatimi i higjienës ushqimore dhe i sigurisë ushqimore (praktikat e mira të higjienës);

e) parimet, konceptet dhe metodat e analizës së rrezikut;

ë) parimet, konceptet dhe metodat e HACCP-it, si dhe përdorimi i HACCP-it përgjatë gjithë zinxhirit të prodhimit ushqimor;

f) auditimi dhe verifikimi i përputhshmërisë me kërkesat e përmendura në shkronjat “a” deri në “ë” të kësaj pike;

g) parandalimi dhe kontrolli i rreziqeve të transmetuara nga ushqimi për shëndetin e njeriut;

gj) dinamika e popullatës së infeksioneve dhe intoksikimeve;

h) epidemiologjia diagnostike;

i) sistemet e monitorimit dhe të mbikëqyrjes;

j) parimet dhe aplikimet diagnostike të metodave moderne të testimit;

k) parimet dhe aplikimet diagnostike të metodave moderne të testimit;

l) teknologjia e informacionit dhe komunikimit, kur është e përshtatshme, si mjete pune;

ll) hetimi i shpërthimeve të sëmundjeve të transmetuara nga ushqimi te njerëzit;

m) aspektet përkatëse që lidhen me encefalopatitë spongiforme të transmetueshme (TSE-të);

n) mirëqenia e kafshëve në nivelin e prodhimit, transportit dhe therjes;

nj) çështjet mjedisore të lidhura me prodhimin ushqimor (përfshirë menaxhimin e mbetjeve);

o) parimi i kujdesit dhe shqetësimet e konsumatorëve;



p) parimet e trajnimit të personelit që punon në zinxhirin e prodhimit;

q) rregullat shëndetësore lidhur me nënproduktet shtazore dhe produktet e prejardhura;

r) aspektet e mashtimit.

Kandidatët mund t'i përfitojnë njohuritë e kërkuara si pjesë e formimit të tyre bazë veterinar, ose përmes trajnimit të kryer apo përvojës profesionale të fituar pas kualifikimit si veterinerë.

Kur autoriteti kompetent konstaton se kandidati ka përfutur të gjitha njohuritë e kërkuara si pjesë e një diplomë universitare, ose përmes arsimit të vazhdueshëm që rezulton si kualifikim pasuniversitar, përvojës profesionale ose kualifikimeve të tjera, vendos që kandidati të mos i nënshtrohet provimit. Nëse kandidati ka përfutur pjesërisht njohuritë e kërkuara, autoriteti kompetent organizon provime të ndryshme nga ato të përmendura në pikën 2 të këtij kreu për të marrë në konsideratë profilin e kandidatëve.

4. Veterineri zyrtar duhet të ketë aftësi për bashkëpunim multidisiplinar.

5. Çdo veteriner zyrtar duhet të ndjekë trajnim praktik për një periudhë prove prej të paktën 200 orësh përpara se të fillojë të punojë në mënyrë të pavarur. Trajnimi përkatës gjatë studimeve veterinar mund të përfshihet në periudhën e provës. Gjatë kësaj periudhe, praktikanti punon nën mbikëqyrjen e veterinerëve zyrtarë ekzistues në thertore, në impiantet e prerjes dhe në ferma. Trajnimi duhet të përqendrohet në auditimin e Praktikave të Mira të Higjenës dhe të procedurave të bazuara në parimet e HACCP-it, në veçanti.

6. Veterineri zyrtar duhet të mbajë njohuri të përditësuara dhe të jetë në hap me zhvillimet e reja përmes aktiviteteve të rregullta të arsimit të vazhdueshëm dhe literaturës profesionale në fushat e përmendura në pikën 3 të këtij kreu. Veterineri zyrtar duhet, kur është e mundur, të marrë pjesë në aktivitete të arsimit të vazhdueshëm çdo vit.

KREU II NDIHMËSI ZYRTAR

1. Vetëm personat që kanë ndjekur trajnimin dhe kanë kaluar provimin në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 5 e këtij kreu lejohen të kryejnë detyrat e një ndihmësi zyrtar.

2. Autoriteti kompetent duhet të marri masa për organizimin e provimeve të përmendura në pikën 1

të këtij kreu. Për t'u kualifikuar për këto provime, kandidatët duhet të provojnë se kanë marrë:

a) të paktën 500 orë trajnim, përfshirë të paktën 400 orë trajnim praktik, që mbulon fushat e përmendura në pikën 5 të këtij kreu; dhe

b) çdo trajnim shtesë të nevojshëm për t'u mundësuar ndihmësve zyrtarë që të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë kompetente.

3. Trajnimi praktik i përmendur në shkronjën "a" të pikës 2 të këtij kreu duhet të zhvillohet në thertore, në njësitë për trajtimin e gjahut dhe/ose në impiantet e prerjes, nën mbikëqyrjen e një veterineri zyrtar.

4. Trajnimi dhe provimet duhet të kenë kryesisht si objekt mishin e kuq ose mishin e shpendëve. Megjithatë, personat që ndjekin trajnimin për njërën nga këto dy kategori dhe kalojnë provimin iu kërkohet të ndjekin vetëm trajnim të shkurtuar për të kaluar provimin për kategorinë tjetër. Trajnimi dhe provimet duhet të mbulojnë, sipas rastit, gjahun e egër, gjahun e rritur në fermë dhe lagomorfët.

5. Trajnimi për ndihmësit zyrtarë duhet të mbulojë, dhe provimet duhet të konfirmojnë njohuritë mbi, subjektet e mëposhtme:

5.1. në lidhje me fermat:

a) pjesa teorike:

i) njohuri bazë mbi organizimin e industrisë së blegtorisë, metodat e prodhimit dhe standardet ndërkombëtare të tregtisë për kafshët;

ii) praktikat e mira të mbarështimit të kafshëve;

iii) njohuri bazë mbi sëmundjet, në veçanti zoonozat e shkaktuara nga viruset, bakteret dhe parazitët;

iv) monitorimi i sëmundjeve, përdorimi i barnave dhe vaksinave, si dhe testimi i mbetjeve;

v) inspektimi i higjenës dhe shëndetit;

vi) mirëqenia e kafshëve në fermë dhe gjatë transportit;

vii) kërkesat mjedisore — në ndërtesa, në ferma dhe në përgjithësi;

viii) legjislacioni, rregulloret dhe dispozitat administrative përkatëse;

ix) shqetësimet e konsumatorëve dhe kontrolli i cilësisë;

b) pjesa praktike:

i) vizita në ferma të llojeve të ndryshme dhe me metoda të ndryshme rritjeje;

ii) vizita në njësi prodhimi;

iii) vëzhgimi i ngarkimit dhe shkarkimit të kafshëve;

iv) demonstrata laboratorike;

v) kontrole veterinarë;



vi) dokumentacioni;

5.2. në lidhje me thertoret, njësitë për trajtimin e gjahut dhe impiantet e prerjes:

a) pjesa teorike:

i) njohuri bazë mbi organizimin e industrisë së mishit, metodat e prodhimit dhe standardet ndërkombëtare të tregtisë për ushqimin dhe teknologjinë e therjes dhe prerjes;

ii) njohuri bazë mbi higjienën dhe praktikën e mira higjienike, në veçanti higjiena industriale, higjiena e therjes, prerjes dhe magazinimit, si dhe higjiena në punë;

iii) njohuri bazë mbi HACCP dhe auditimin e procedurave të bazuara në HACCP;

iv) mirëqenia e kafshëve gjatë shkarkimit pas transportit dhe në thertore;

v) njohuri bazë mbi anatominë dhe fiziologjinë e kafshëve të therura;

vi) njohuri bazë mbi patologjinë e kafshëve të therura;

vii) njohuri bazë mbi anatominë patologjike të kafshëve të therura;

viii) njohuri përkatëse lidhur me TSE-të dhe zoonozat e tjera të rëndësishme dhe agjentët zoonotikë, si dhe sëmundjet e rëndësishme të kafshëve;

ix) njohuri mbi metodat dhe procedurat e therjes, inspektimit, përgatitjes, mbështjelljes, paketimit dhe transportit të mishit të freskët;

x) njohuri bazë mbi mikrobiologjinë;

xi) kontrolli para therjes (ante-mortem);

xii) marrja e mostrave dhe analiza për Trichinella;

xiii) kontrolli pas therjes (post-mortem);

xiv) detyra administrative;

xv) njohuri mbi legjislacionin, rregulloret dhe dispozitat administrative përkatëse;

xvi) procedurat e marrjes së mostrave;

xvii) aspektet e mashtrimit;

b) pjesa praktike:

i) identifikimi i kafshëve;

ii) kontrolli i moshës;

iii) inspektimi dhe vlerësimi i kafshëve të therura;

iv) kontrolli para therjes (ante-mortem) në thertore;

v) kontrolli pas therjes (post-mortem) në një thertore ose në njësi për trajtimin e gjahut;

vi) marrja e mostrave dhe analiza për Trichinella;

vii) identifikimi i specieve të kafshëve duke shqyrtuar pjesë tipike të kafshës;

viii) identifikimi dhe komentimi mbi pjesët e kafshëve të therura në të cilat kanë ndodhur ndryshime;

ix) kontrolli i higjienës, përfshirë auditimin e praktikave të mira të higjienës dhe procedurave të bazuara në HACCP;

x) regjistrimi i rezultateve të kontrolleve para therjes (ante-mortem);

xi) marrja e mostrave;

xii) gjurmueshmëria e mishit;

xiii) dokumentacioni, siç është vlerësimi i informacionit të zinxhirit ushqimor dhe leximi i regjistrave.

6. Autoriteti kompetent vendos të reduktojë trajnimin dhe provimet në lidhje me:

a) pjesën teorike, nëse ndihmësi zyrtar demonstroi arsimim të mjaftueshëm mbi pikat specifike të përcaktuara në nënparagrafin “i” të shkronjës “a” ose në nënparagrafin “i” të shkronjës “b” të pikës 5 të këtij kreu;

b) pjesën praktike, nëse ndihmësi zyrtar demonstroi përvojë të mjaftueshme pune mbi pikat specifike të përcaktuara në nënparagrafin “ii” të shkronjës “a” ose në nënparagrafin “ii” të shkronjës “b” të pikës 5 të këtij kreu.

7. Ndihmësi zyrtar duhet të ketë aftësi për bashkëpunim multidisiplinar.

8. Ndihmësit zyrtarë duhet të mbajnë njohuritë e tyre të përditësuara dhe të jenë në hap me zhvillimet e reja përmes aktiviteteve të rregullta të arsimit të vazhdueshëm dhe literaturës profesionale. Ndihmësi zyrtar duhet, kur është e mundur, të ndjekë çdo vit aktivitete të trajnimit të vazhdueshëm.

9. Nëse ndihmësit zyrtarë kryejnë vetëm marrjen e mostrave dhe analizat në lidhje me ekzaminimet për Trichinella dhe kriteret mikrobiologjike, autoritetet kompetente duhet vetëm të sigurojnë që ata të marrin trajnim të përshtatshëm për këto detyra.

KREU III

PERSONELI I CAKTUAR NGA AUTORITETET KOMPETENTE

1. Autoriteti kompetent ka të drejtë të emërojë vetëm personel që ka ndjekur trajnim dhe ka kaluar një provim në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 5 të këtij kreu.

2. Autoriteti kompetent duhet të marrë masa për organizimin e provimit të përmendur në pikën 1 të



këtij kreu. Për t'u kualifikuar për këtë provim, kandidatët duhet të provojnë se kanë marrë:

a) të paktën 500 orë trajnim, përfshirë të paktën 400 orë trajnim praktik që mbulon fushat e përmendura në pikën 5 të këtij kreu; dhe

b) çdo trajnim shtesë të nevojshëm për t'u mundësuar personelit të caktuar nga autoriteti kompetent që të kryejë detyrat e tij në mënyrë kompetente.

3. Trajnimi praktik i përmendur shkronjën “a” të pikës 2 të këtij kreu duhet të zhvillohet në impiantet e prerjes, nën mbikëqyrjen e një veterineri zyrtar.

4. Trajnimi dhe provimet duhet të kenë kryesisht si objekt mishin e kuq ose mishin e shpendëve. Megjithatë, personat që ndjekin trajnimin për njërën nga këto dy kategori dhe kalojnë provimin duhet të kërkohej të ndjekin vetëm trajnim të shkurtuar për të kaluar provimin për kategorinë tjetër. Trajnimi dhe provimet duhet të mbulojnë, sipas rastit, gjahun e egër, gjahun e rritur në fermë dhe lagomorfët.

5. Trajnimi për personelin e caktuar nga autoriteti kompetent duhet të përfshijë, dhe provimet duhet të konfirmojnë njohuritë mbi, subjektet e mëposhtme në lidhje me impiantet e prerjes:

a) pjesa teorike:

i) njohuri mbi organizimin e industrisë së mishit, metodat e prodhimit, standardet ndërkombëtare të tregtisë për ushqimin dhe teknologjinë e prerjes;

ii) njohuri të thella mbi higjienën dhe praktikën e mira higjienike, dhe në veçanti higjiena industriale, higjiena e prerjes dhe magazinimit, higjiena në punë;

iii) njohuri të thella mbi HACCP dhe auditimin e procedurave të bazuara në HACCP;

iv) njohuri përkatëse lidhur me TSE-të dhe zoonozat e tjera të rëndësishme dhe agjentët zoonotikë;

v) njohuri mbi metodat dhe procedurat për përgatitjen, mbështjelljen, paketimin dhe transportin e mishit të freskët;

vi) njohuri bazë mbi mikrobiologjinë;

vii) detyra administrative;

viii) njohuri mbi legjislacionin, rregulloret dhe dispozitat administrative përkatëse;

ix) procedurat e marrjes së mostrave;

x) aspektet e mashtimit;

b) pjesa praktike:

i) inspektimi dhe vlerësimi i kafshëve të therura;

ii) kontrolli i higjienës, përfshirë auditimin e praktikave të mira të higjienës dhe procedurave të bazuara në HACCP;

iii) marrja e mostrave;

iv) gjurmueshmëria e mishit;

v) dokumentacioni.

6. Autoriteti kompetent ka të drejtë të vendosë të reduktojë trajnimin dhe provimet në lidhje me:

a) pjesën teorike, nëse personeli i caktuar nga autoritetet kompetente demonstroi arsimim të mjaftueshëm mbi pikat specifike të përcaktuara në nënparagrafin “i” të pikës 5 të këtij Kreu;

b) pjesën praktike, nëse personeli i caktuar nga autoritetet kompetente demonstroi përvojë të mjaftueshme pune mbi pikat specifike të përcaktuara në nënparagrafin “ii” të pikës 5 të këtij kreu.

7. Personeli i caktuar nga autoriteti kompetent duhet të mbajë njohuritë e përditësuara dhe të jetë në hap me zhvillimet e reja përmes aktiviteteve të rregullta të arsimit të vazhdueshëm dhe literaturës profesionale. Personeli i caktuar nga autoritetet kompetente duhet, kur është e mundur, të ndjekë çdo vit aktivitete të trajnimit të vazhdueshëm.

UDHEZIM

Nr.20, datë 4.8.2026

PËR PËRCAKTIMIN E KONTROLLEVE TË VEÇANTA SHËNDETËSORE PËR MBLEDHJEN DHE PËRPUNIMIN E DISA MOLUSQEVE BIVALVORE ME NJË NIVEL TË TOKSINËS AMNESIKE TË MOLUSQEVE (ASP), QË TEJKBALON KUFIRIN 20 mg/kg²

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe pikave 1, 2, 3 dhe 4, të nenit 23, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

Neni 1

1.1 Ky udhëzim ka si objekt përcaktimin e kontrolleve të veçanta shëndetësore për mbledhjen dhe përpunimin e molusqeve bivalvore me një nivel

²Ky udhëzim përaftron plotësisht Vendimin e Komisionit 2002/226/KE, datë 15 mars 2002, “Për vendosjen e kontrolleve të veçanta shëndetësore për mbledhjen dhe përpunimin e disa molusqeve bivalvore me një nivel të toksinës amnezike të molusqeve (ASP), që tejkalon kufirin e

Faqe | 17936

përcaktuar në direktivën e Këshillit 91/492/KEE”, botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian L 75, datë 16.3.2002, f. 65–66, CELEX 32002D0226.



të toksinës amnesike të molusqeve (ASP), që tejkalon kufirin 20 mg/kg.

Neni 2

2.1. Autoriteti kompetent autorizon mbledhjen e molusqeve bivalvore, që i përkasin specieve *Pecten maximus* dhe *Pecten jacobaeus*, me një përqendrim të acidit domoik (DA) në të gjithë trupin, që kalon 20 mg/kg, por është më i ulët se 250 mg/kg, të cilat plotë-sojnë kërkesat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

2.2. Kërkesat e referuara në pikën 1 të këtij neni janë, si më poshtë:

a) molusqet u nënshtrohen kushteve të mbledhjes të përcaktuara në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, dhe që është pjesë përbërëse e tij;

b) ato transportohen në kontejnerë të vulosur ose automjete të vulosura, nën mbikëqyrjen e autoritetit kompetent, dhe dërgohen drejtëpërdrejtëngaz zonat e prodhimit në një stabiliment të miratuar, të autorizuar për kryerjen e përgatitjeve të veçanta të këtyre molusqeve, që përfshin heqjen e hepatopankreasit, indeve të buta ose çdo pjesë tjetër të kontaminuar që nuk është në përputhje me pikën 2, të shtojcës 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Një listë e stabilimenteve të autorizuar i dërgohet Ministrisë nga autoriteti kompetent;

c) shoqërohen me një dokument regjistrimi, të lëshuar nga autoriteti kompetent, për çdo ngarkesë që specifikon kërkesat e parashikuara në kreun II, seksioni I, pika 8 shkronja “a”, 9, 10, 11 dhe 12 të udhëzimit nr. 25, datë 25.11.2010 “Për kushtet higjienike dhe kontrollet për molusqet e gjalla bivalvore, peshkun dhe produktet e peshkimit”, të ndryshuar, si dhe pjesën ose pjesët anatomike që mund të përpunohen për konsum njerëzor. Autorizimi i përhershëm i transportit, i dhënë nga autoriteti kompetent, nuk është i pranueshëm;

ç) pas heqjes së plotë të hepatopankreasit, indeve të buta dhe çdo pjesë tjetër të kontaminuar, muskuli aduktor dhe/ose gonadet e destinuar për konsum njerëzor nuk duhet të përmbajnë një nivel të ASP-së të përcaktuara nga teknikat HPLC, që tejkalon 20 mg/kg të DA.

Neni 3

3.1. Çdo lot i produktit përfundimtar nënshtrohet testimit nga stabilimenti i autorizuar

posaçërisht. Nëse një mostër, siç përcaktohet në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi, përmban më shumë se 20 mg/kg DA, i gjithë loti asgjësohet nën mbikëqyrjen e autoritetit kompetent.

3.2. Hepatopankreasi, indet e buta dhe çdo pjesë tjetër e kontaminuar, që tejkalon kufijtë e përcaktuar në pikën 2 të Shtojcës 1 bashkëlidhur (përfshirë produktin përfundimtar që tejkalon kufirin prej 20 mg/kg DA), asgjësohet nën mbikëqyrjen e autoritetit kompetent.

3.3. Autoriteti kompetent siguron që sistemi i vetkontrollit, HACCP, i parashikuar në kreun I, pika 2, 3, 4 dhe 5 të udhëzimit nr. 20, datë 25.11.2010 “Për zbatimin e programeve paraprake, të praktikave të mira të higjienës, praktikave të mira të prodhimit dhe procedurave të bazuara në analizën e rreziqeve dhe pikave kritike të kontrollit (HACCP) në stabilimente ushqimore”, aplikohet gjatë përgatitjes së produkteve, siç përcaktohet në shkronjën “b”, pika 2, e nenit 2 të këtij udhëzimi. Prodhuesi njofton autoritetin kompetent për çdo rezultat që lidhet me produktin përfundimtar që nuk është në përputhje me kreun II, seksioni I, pika 27 shkronja b) (ii), të udhëzimit nr. 25, datë 25.11.2010 “Për kushtet higjienike dhe kontrollet për molusqet e gjalla bivalvore, peshkun dhe produktet e peshkimit”, të ndryshuar.

Neni 4

4.1. Udhëzimi nr. 26, datë 29.8.2025 “Për përcaktimin e kushteve për vendosjen e kontrolleve të veçanta shëndetësore për mbledhjen dhe përpunimin e disa molusqeve bivalvore me një nivel të toksinës amnezike të molusqeve (ASP), që tejkalon kufirin 20 mg/kg”, shfuqizohet me fillimin e shtrirjes së efekteve të këtij udhëzimi.

4.2. Për zbatimin e këtij udhëzimi, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

4.3. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare, dhe i fillon efektet më 1 shtator 2026.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

**SHTOJCA 1**

1. Nuk lejohet mbledhja e molusqeve bivalve të specieve *Pecten maximus* dhe *Pecten jacobaeus* gjatë shfaqjes së një episodi toksik aktiv të ASP-së në ujërat e zonave të prodhimit të tyre, siç përcaktohet në kreun III, seksioni I, pikat nga 8 deri në 16 të udhëzimit nr. 25, datë 25.11.2010, “Për kushtet higjienike dhe kontrollet për molusqet e gjalla bivalvore, peshkun dhe produktet e peshkimit”, të ndryshuar.

2. Një regjim i kufizuar i mbledhjes së molusqeve me përqendrim të **DA-së**, në të gjithë trupin, më të lartë se 20 mg/kg mund të fillohet nëse dy analiza të njëpasnjëshme të mostrave, të marra midis një dhe jo më shumë se shtatë ditëve, tregojnë se përqendrimi i DA në molusqet e plota është më i ulët se 250 mg/kg dhe se përqendrimi i DA në pjesët e destinuara për konsum njerëzor, të cilat duhet të analizohen veçmas, është më e ulët se 4,6 mg/kg. Analiza e trupit të plotë kryhet mbi një mostër të homogjenizuar të përgatitur prej 10 molusqesh. Analiza e pjesëve të ngrënshme kryhet mbi një mostër të homogjenizuar të përgatitur prej 10 pjesësh individuale.

3. Pikat e marrjes së mostrave do të vendosen nga autoriteti kompetent për të siguruar që produkti përmbush parametrat e përmendur në pikën 2 të kësaj shtojce. Pasi të lejohet mbledhja, frekuenca e marrjes së mostrave për analizën e DA në molusqe (i gjithë trupi dhe muskujt aduktorë dhe gonadat veçmas) do të jetë minimumi një herë në javë. Mbledhja mund të vazhdojë nëse rezultatet janë në përputhje me kushtet e listuara në pikën 2 të kësaj shtojce.

UDHËZIM**Nr.6, datë 3.8.2026**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 5627, DATË
18.11.2016, “PËR PËRCAKTIMIN E
KRITEREVE, RREGULLAVE DHE
DOKUMENTACIONIT PËR LËSHIMIN
E LICENCAVE DHE CERTIFIKATAVE
PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË
TRANSPORTIN RRUGOR TË
UDHËTARËVE BRENDA VENDIT”, TË
NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 5 dhe 17, të ligjit

nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar; nenit 82, pika 1, nenit 83, pika 3, nenit 84, pika 4 dhe nenit 86, pika 5, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 325, datë 19.3.2008 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e subjektit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta subjekte”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 3, pas përkufizimit “Regjistri Elektronik Kombëtar”, të shtohet përkufizimi me këtë përmbajtje:

“**“Sistemi elektronik e-Transport”** është sistemi elektronik i dedikuar për administrimin e procedurave dhe të të dhënave që lidhen me ofrimin e shërbimeve në fushën e transportit ndërqytetës të udhëtarëve, i cili ndërvepron me portalin unik qeveritar e-Albania.”.

Neni 2

Në nenin 5, shtohet pika 6, me përmbajtje si më poshtë:

“6. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, në cilësinë e administruesit të Regjistrat Elektronik Kombëtar (REK), më kërkesë të interesuarve lëshon, për të dhënat e administruara në këtë regjistër, vërtetime në formë elektronike mbi gjendjen dhe plotësimin e kushteve të regjistruara për subjektet e transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve. Këto vërtetime kanë karakter informues dhe verifikues dhe nuk zëvendësojnë licencën, certifikatën e operimit apo autorizimet e parashikuara në legjislacionin në fuqi. Drejtori i Përgjithshëm Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor miraton modelin e vërtetimit.”.



Neni 3

Në nenin 6, në pikën 2, përpara fjalës “10 vjet” dhe “5 vjet” shtohet togfjalëshi “deri në”.

Neni 4

Në nenin 9, pika 1, ndryshon si më poshtë:

“1. Për marrjen e licencës në shërbimet e rregullta (qytetës dhe rrethqytetës), të rregullta të specializuara dhe vajtje-ardhje të transportit të udhëtarëve brenda vendit, aplikanti paraqitet pranë autoritetit përkatës të licencimit dhe, për shërbimin e rregullt në transportin ndërqytetës të udhëtarëve, aplikimi kryhet nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania, bazuar në vendimin nr. 252, datë 29.4.2022 të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbimofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”, me dokumentacionin shoqërues të mëposhtëm.”

Neni 5

1. Në nenin 9, në pikën 1.2, të shtohet shkronja “ë” me këtë përmbajtje:

“ë) Dokument të lëshuar nga subjekti i licencuar, që vërteton instalimin e pajisjes GPS (Sistemi Global i Pozicionimit), e cila është një pajisje elektronike që merr sinjale nga satelitët për të përcaktuar me saktësi vendndodhjen, shpejtësinë e lëvizjes dhe kohën e udhëtimit të autobusit, si dhe gjeneron dhe transmeton pandërprerë të dhëna të vendndodhjes së autobusit, në sistemin elektronik të monitorimit të autoritetit kompetent.”

2. Në nenin 9, pas pikës 1.5, shtohet pika 1.6 me këtë përmbajtje:

“1.6. Rregulloren e udhëtimit, të hartuar nga subjekti transportues, në përputhje me udhëzimin nr. 1649, datë 16.08.1999, “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar, në të cilën përfshihen edhe dispozitat për të drejtat dhe detyrimet e udhëtarëve”.

Neni 6

Në nenin 14, pas pikës 2, shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1 Subjekti transportues zbaton rregulloren e udhëtimit, e cila duhet të jetë e aksesueshme për udhëtarët në agjencitë e transportit, terminalët, në faqen zyrtare të internetit të subjektit dhe elemente të saj të rëndësishëm afishohen dukshëm brenda në autobus.”.

Neni 7

1. Subjektet e pajisura, me licencë dhe certifikata, para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, përmbushin kërkesën e përcaktuar në shkronjën “ë” të pikës 1.2 të nenit 9, brenda datës 30 shtator 2026.

2. Kërkesat e përcaktuara në pikën 1.6 të nenit 9 dhe në pikën 2/1 të nenit 14, të këtij udhëzimi, përmbushen në momentin e rinovimit të licencës ose të certifikatës përkatëse.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Enea Karakaçi

UDHËZIM

Nr. 7, datë 3.8.2026

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 1649, DATË
16.8.1999, “MBI PLOTËSIMIN E DISA
KUSHTEVE TË VEÇANTA NË
TRANSPORTIN RRUGOR TË
UDHËTARËVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 9, 36, 38 dhe 83, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. Në udhëzimin nr. 1649, datë 16.8.1999, “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Paragrafi “Hyrje” ndryshon si më poshtë:

“Mjetet motorike të transportit rrugor të udhëtarëve janë të detyruar të kryejnë në kohë dhe me rezultat pozitiv kontrollin teknik të detyrueshëm, në përputhje me udhëzimin përkatës mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore. Gjithashtu, këto mjete



rrugore, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, duhet të plotësojnë dhe kushtet e tjera, që lidhen me sigurinë e udhëtarëve dhe komoditetin e udhëtimit të tyre, si më poshtë:”.

2. Në kapitullin I, “Sigurimi i udhëtarëve dhe komoditeti gjatë udhëtimit me autobus”, bëhen ndryshimet dhe shtesat si vijon:

a) Emërtimi i titullit “Sigurimi i udhëtarëve dhe komoditeti gjatë udhëtimit me autobus”, zëvendësohet me emërtimin “Sigurimi i udhëtarëve dhe komoditeti gjatë udhëtimit me autobus, si dhe kushtet teknike të veçanta, dhe komoditeti për mjetet me destinacion apo përdorim “Autoshkollë.”;

b) Pika 11, e shkronjës “A”, “Sigurimi i udhëtimit”, riformulohet si më poshtë:

“11. Të jenë të pajisur në çdo kohë me kompletin e pajisjeve për situata emergjente (fikse zjarri, çekiq për thyerje xhamash dhe prerje rripi sigurimi, etj.).”;

c) Paragrafi i parë, i pikës 8.a i shkronjës “B”, “Komoditeti i udhëtimit”, ndryshon si më poshtë:

“8.a Aktivlerësimi për plotësimin e kushteve të komoditetit të autobusëve në transportin e udhëtarëve brenda vendit lëshohet çdo vit, pasi autobusi ka kryer me rezultat pozitiv kontrollin teknik, të detyrueshëm, në qendrën e kontrollit teknik, të miratuar nga ministri përgjegjës për transportin dhe është i pajisur me një certifikatë të vlefshme të kontrollit teknik, në përputhje me udhëzimin përkatës mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore.”;

d) Pika 9 e shkronjës “B”, “Komoditeti i udhëtimit”, riformulohet si më poshtë:

“9. Autobusët e transportit ndërkombëtar dhe brenda vendit të udhëtarëve, në linja të rregullta, si dhe në shërbimet e transportit të rastit/turistik të udhëtarëve, duhet të jenë të pajisur me sistem kondicionimi dhe qendër zëri, në përputhje me tipin e miratuar. Çdo ndenjësë e autobusit, duhet të jetë e pajisur me rripin e sigurimit. Autobusët e transportit ndërkombëtar të udhëtarëve në linja të rregullta, duhet të kenë dhe tualet (WC, lavaman të vogël dhe solucion pastrimi), në përputhje me tipin e miratuar, si dhe të jenë në gjendje funksionale. Aktivlerësimi për plotësimin e kushteve të komoditetit të autobusëve në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve, lëshohet çdo vit, pasi autobusi ka kryer me rezultat pozitiv kontrollin teknik të detyrueshëm, në qendrën e kontrollit teknik të miratuar nga ministri përgjegjës për transportin dhe është i pajisur

me një certifikatë të vlefshme të kontrollit teknik, në përputhje me udhëzimin përkatës mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore. Autobusët e subjekteve të pajisur me licencë për transportin ndërqytetës të udhëtarëve duhet të kenë të vendosur dhe funksional një pajisje GPS-i.”;

e) Pas shkronjës “B”, shtohet shkronja “C”, me përmbajtje, si më poshtë:

“C. Aktivlerësimi teknik për plotësimin e kushteve të komoditetit për mjetin me destinacion apo përdorim “Autoshkollë”

Mjeti me destinacion apo përdorim “Autoshkollë” (të shënuar në lejen e qarkullimit), për përdorimin e tij sipas destinacionit duhet të kryejë vlerësimin e kushteve teknike të veçanta dhe kushteve të komoditetit. Kur mjeti me destinacion apo përdorim “Autoshkollë” i plotëson kushtet teknike të veçanta dhe kushtet e komoditetit i lëshohet dokumenti “Aktivlerësimi teknik për plotësimin e kushteve të komoditetit”. Ky dokument lëshohet nga strukturat e varësisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), pas kryerjes së kontrollit të mjetit (me paraqitjen e mjetit pranë QKT-ve) me destinacion apo përdorim “Autoshkollë” dhe vlerësimin se mjeti i plotëson kushtet teknike të veçanta dhe kushtet e komoditetit sipas kritereve të përcaktuara në këtë udhëzim.

Modeli, pamja grafike, elementet identifikuese të institucionit lëshues, elementet e sigurisë dhe të dhënat që duhet të përmbajë dokumenti “Aktivlerësimi teknik për plotësimin e kushteve të komoditetit” për mjetin me destinacion apo përdorim “Autoshkollë”, miratohen me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të DPSHTRR-së.

Dokumenti i Aktivlerësimi për plotësimin e kushteve të komoditetit për mjetin me destinacion apo përdorim “Autoshkollë” lëshohet me afat vlefshmërie 1 (një) vit. Në rastet kur nuk plotësohen kushtet (elementet) e vlerësimin (mjeti rezulton me mangësi), ai duhet të riparohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike me kushte të plotësuar, duke kryer pagesën përkatëse të rivlerësimit. Mosplotësimi i kushteve ndalon përdorimin e mjetit në aktivitetet e autoshkollës dhe lejon qarkullimin e tij vetëm për në destinacionin e riparimit. Në rast të tejkalimit të afatit, mjeti do t'i nënshtrohet procedurës së vlerësimin nga e para për pajisje me Aktivlerësimi për plotësimin e kushteve të komoditetit, kundrejt kryerjes së pagesës së plotë.



Vlerësimi për mjetet me destinacion apo përdorim “Autoshkollë” kryhet përpara pajisjes së këtyre mjeteve me “Autorizim për t’u ushtruar në drejtimin e mjetit dhe për provën e praktikës” (sipas modelit të miratuar nga DPSHTRR-ja). Autorizimi për t’u ushtruar në drejtimin e mjetit dhe për provën e praktikës ka afat vlefshmërie të njëjtë me aktivlerësimin teknik për plotësimin e kushteve të komoditetit.

Mjeti me destinacion apo përdorim “Autoshkollë”, për vlerësimin nëse i plotëson kushtet teknike të veçanta dhe kushtet e komoditetit, i nënshtrohet kontrollit pranë qendrave të kontrollit teknik të Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR), përkatëse ku është e regjistruar autoshkolla, në pronësi të së cilës ndodhet mjeti që vlerësohet për plotësim të kushteve të sigurisë dhe komoditetit. Kontrolli do të kryhet nga përgjegjësi i degës së kontrollit teknik dhe një specialist i kontrollit teknik, sipas fushave përkatëse dhe llojit të mjetit, të përcaktuara në raportin e kontrollit të sigurisë dhe komoditetit për mjetet me destinacion apo përdorim “Autoshkollë”.

Kriteret vlerësuese për mjetet me destinacion apo përdorim “Autoshkollë” janë si më poshtë:

1. Verifikimin e kushteve teknike të veçanta

a) Mjeti me destinacion apo përdorim “Autoshkollë” duhet të jetë në gjendje të mirë teknike dhe me të gjitha aparaturat dhe instrumentet funksionale (treguesi i kilometrazhit, sinjalet + drita, frenat e parkimit, rripat e sigurimit etj.);

b) Të jetë i pajisur me pedalet e dyfishta funksionale, përveç atyre të kategorisë “L” (sipas klasifikimit të mjeteve në nenin 47, pika 2, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, (në vijim “Kodi Rrugor”) për përshpejtim, shkëputje dhe frenim (gaz, friksion, frena) për mjetin rrugor mësimor me kuti shpejtësie manuale dhe për përshpejtim, dhe frenim (gaz, frena) për mjetin me destinacion apo përdorim “Autoshkollë” me kuti shpejtësie automatike;

c) Të jetë i pajisur me pasqyrë të brendshme për kandidatin dhe pasqyra të brendshme të përshtatura për instruktorin, përveç atyre të kategorisë “L” (sipas klasifikimit të mjeteve në nenin 47, pika 2, të Kodit Rrugor);

d) Të jetë i pajisur me pasqyra anësore të jashtme majtas dhe djathtas, të rregulluara për përdorim nga kandidati dhe pasqyra anësore shtesë të jashtme

majtas dhe djathtas për përdorim nga instruktori, përveç atyre të kategorisë “L” (sipas klasifikimit të mjeteve në nenin 47, pika 2, të Kodit Rrugor).

2. Verifikimi i kushteve të komoditetit

a) Të ketë sedilje komode, me sistem rregullimi, me pajisje bllokuese funksionale dhe me rripa sigurie funksionale;

b) Të jetë me numër ndenjësesh dhe kapacitet maksimal sipas lejes së qarkullimit;

c) Të ketë pamje të jashtme të pastër, të rregullt, pa dëmtime apo deformime dhe me ngjyrën sipas lejes së qarkullimit, si dhe hapësirë të brendshme të pastër nga ana higjienike (për mjetet me hapësirë të brendshme);

d) Dritaret dhe dyert të jenë funksionale, me xhama origjinale (për mjetet e kategorisë L6 me kabinë të mbyllur, automjetet e kategorisë M1, M2, M3, N1, N2, N3 sipas klasifikimit të nenit 47, pika 2, të Kodit Rrugor);

e) Dyshemeja, tavani dhe paretet anësore të jenë të veshura, në gjendje të mirë për të siguruar hermeticitetin e nevojshëm nga faktorët e jashtëm (për mjetet e kategorisë L6 me kabinë të mbyllur, automjetet e kategorisë M1, M2, M3, N1, N2, N3, sipas klasifikimit të mjeteve në nenin 47, pika 2, të Kodit Rrugor);

f) Sistemi i ngrohjes, ventilimit dhe ajrit të kondicionuar, nëse ka të instaluar, sipas konstruksionit të firmës prodhuese të jenë në gjendje funksionale (për mjetet e kategorisë L6 me kabinë të mbyllur, automjetet e kategorisë M1, M2, M3, N1, N2, N3 sipas klasifikimit të nenit 47, pika 2, të Kodit Rrugor);

g) Të jetë i pajisur me trekëndëshin e sigurisë për sinjalizimin në rrugë, në rast defekti (për mjetet e kategorisë M dhe N);

h) Të jetë i pajisur me një fikse zjarri, me afat të vlefshëm përdorimi (kolaudimi) (për mjetet e kategorisë L6 me kabinë të mbyllur, automjetet e kategorisë M1, M2, M3, N1, N2, N3 sipas klasifikimit të nenit 47, pika 2, të Kodit Rrugor);

i) Të jetë i pajisur me kutinë e ndihmës së shpejtë (për mjetet e kategorisë L6 me kabinë të mbyllur, automjetet e kategorisë M1, M2, M3, N1, N2, N3 sipas klasifikimit të nenit 47, pika 2, të Kodit Rrugor);

j) Të jetë i pajisur me çekiç për thyerjen e xhamave, që shërben njëkohësisht edhe për prerjen e rripit të sigurimit në raste emergjence (për automjetet e kategorisë M2 dhe M3).



3. Verifikimi i informacionit në mjet (shenjave dalluese)

a) Të jetë i pajisur me shenjën dalluese (tabelën) “Autoshkollë”, sipas nenit 312, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000, “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, (në vijim “VKM-ja nr. 153, datë 7.4.2000”). Përmasa dhe lloji i shkrimit janë sipas figurës IV.1 (për mjetet e kategorisë M1) dhe figurës IV. 2 (për mjetet e kategorisë M2, M3, N2, N3 dhe O3, O4), të nenit 312, të VKM-së nr. 153, datë 7.4.2000.

b) Në pjesët anësore të mjetit të shkruhen fjalët: autoshkolla dhe emri i subjektit (ose emri tregtar i subjektit), sipas përcaktimit të shkronjave “c” dhe “ç”, të pikës 3, të nenit 56, të VKM-së nr. 153, datë 7.4.2000.”.

3. Në kapitullin II, “Kriteret bazë për hartimin e rregullores së udhëtimit”, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë:

a) Pika 15, ndryshon si vijon: “15. Në autobus shënohet në sipërfaqen ballore emërtimi i linjës dhe numri i autobusit në linjë. Forma dhe skica e paraqitjes miratohet nga Autoriteti Licencues.”.

b) Pika 20, riformulohet si më poshtë:

“20. Rregullorja e udhëtimit për transportin qytetës/rrethqytetës/ndërqytetës mund të përpunohet dhe të përmbajë kërkesa dhe kushte të tjera përveç sa përmendëm në këtë udhëzim sipas marrëveshjes së transportuesit me organet e Autoritetit Licencues.”;

c) Pas pikës 24, shtohet pika 25 me përmbajtje si më poshtë:

“25. Autobusët e certifikuar për operim në transportin rrugor duhet të kenë të instaluar pajisjen e takografit digjital, të shoqëruar me formularin e instalimit të pajisjes. Për mjetet që kryejnë transportin e udhëtarëve mjetet duhet të jenë të pajisura me pajisjet e transaksionit digjital të biletimit. Këto pajisje janë objekt verifikimi nga Komisioni për sa i përket gjendjes fizike, numrit të identifikimit dhe elementeve të tjera të përcaktuara në formularin e instalimit të tyre. Mungesa e pajisjeve në mjetet e certikuara, dëmtimi fizik i tyre, mospërputhja midis numrit të identifikimit të pajisjes dhe targës së mjetit, si dhe të dhënave të tjera të përcaktuara në formularin e instalimit përbën shkak për refuzimin e lëshimit të aktvlerësimit për plotësimin e kushteve të komoditetit.”.

4. Në kapitullin III, “Mbi kushtet dhe rregullat e kryerjes së transportit të udhëtarëve me taksì”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

a) Në pikën 1, numri “3.16” zëvendësohet me numrin “3.6”.

b) Paragrafi i pestë, i pikës 4, riformulohet si më poshtë:

“Shërbimi taksì jashtë territorit të njësisë administrative kryhet nga çdo mjet i licencuar pjesë ose jo e agjencive për transport udhëtarësh, në përputhje me udhëzimin e licencimit.”;

c) Shkronja “c”, e pikës 5 riformulohet si më poshtë:

“c) Të sigurojë “Dëshminë e taksistit” nëpërmjet zyrave të shërbimit të DPSHTRR-së mbasi të ketë ndjekur një kurs formimi për taksistë, me kohëzgjatje 12 orë dhe të jetë shpallur fitues i një testimi ku të demonstrojë aftësitë e tij në.”;

ç) Paragrafi i parë, i pikës 7 ndryshon si më poshtë vijon:

“Dëshmia e Taksistit është dokument që vërteton se drejtuesi zotëron njohuri të mjaftueshme për kryerjen e shërbimit me mjete taksì dhe është pjesë përbërëse e dokumenteve për efekt licencimi në transportin e udhëtarëve me taksì. DPSHTRR-ja do të shërbejë si qendër trajnimi për kandidatë që kërkojnë të pajisen me Dëshmi Taksisti. Për marrjen e Dëshmisë, drejtuesi i autoveturës taksì duhet të ndjekë programin e trajnimit të detyruar, sipas aneksit 3, dhe t’i nënshtrohen një provimi. Testimi i njohurive teorike realizohet pranë DRSHTRR-ve, me kompjuter në programin elektronik të testimit për Dëshmi Taksisti. Testi i provimit gjenerohet nga kompjuteri për çdo provë në mënyrë të rastësishme dhe përbëhet nga 30 pyetje të formuluar rreth temave të programit. Për t’u shpallur fitues i provimit, aplikanti duhet të ketë dhënë të paktën 27 përgjigje korrekte nga 30 gjithsej. Kohëzgjatja e testimit të njohurive është 30 minuta.”;

d) Paragrafi i fundit, i pikës 7 ndryshon si më poshtë:

“7. Afati i vlefshmërisë së Dëshmisë së Taksistit është pesë vjet. Në këtë rast, DPSHTRR-ja, para regjistrimit për kursin e formimit për taksistë për lëshimin, për herë të parë ose rinovimin e dëshmisë, i kërkon drejtuesit të automjetit taksì certifikatën mjekësore që vërteton që është i aftë nga pikëpamja mjekësore dhe psikologjike për kryerjen e veprimtarisë përkatëse, dëshminë e penaltetit, si dhe të mos ketë masë administrative aktive për pezullim



apo heqje të leje drejtimit. Dëshmia e Taksistit është prej polikarbionati dhe modeli i saj tregohet në aneksin 3, pamja grafike, elementet identifikuese, elementet e sigurisë dhe mënyra e personalizimit, miratohen me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të DPSHTRR-së.”;

e) Në pikën 7 shtohet fjalia si më poshtë:

“Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor merr masat për hartimin e procedurave, në zbatim të pikës 7 të këtij kapitulli.”;

f) Paragrafi i parë, i pikës 8, ndryshon si më poshtë:

“8. Drejtuesit e mjeteve “Taksi” duhet të jenë pajisur me leje drejtimi të vlefshme të njëres prej kategorive D1, D1E, D dhe DE, sipas dispozitave të Kodit Rrugor për këtë lloj shërbimi dhe.”.

5. Në kapitullin IV, “Kushtet e veçanta të automjetit “taksi””, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

a) Emërtimi i kapitullit “Kushtet e veçanta të automjetit “taksi””, zëvendësohet me emërtimin “Kushtet e veçanta të automjetit në shërbimin taksi”;

b) Pika 1, riformulohet si më poshtë:

“1. Të ketë taksimetër në gjendje pune, të regjistruar, të plumbosur dhe të kolauduar nga autoriteti përkatës, vërtetuar me paraqitjen e librit në origjinal, i cili përmban datat, firmën dhe vulën përkatëse.”;

c) Pika 4, ndryshon si më poshtë:

“4. Mbi pjesën e sipërme të automjetit vendoset një tabelë e ndriçuar me mbishkrimin “TAKSI”. Nuk lejohet fiksimi magnetik ose pneumatik i tabelës.”;

ç) Në pikën 9, shfuqizohen shkronja “ç”, “9/1” dhe “9/2”.

d) Pas pikës 11 shtohen pikat 12, 13, 14, 15 dhe 16, me përmbajtje si më poshtë:

“12. Automjeti në shërbimin taksi duhet të jetë i pajisur me targat përkatëse të mjetit në shërbim taksi, sipas legjislacionit në fuqi.

13. Për ofrimin e një udhëtimi komod dhe të sigurt, automjeti në shërbimin taksi duhet të jetë i pajisur në çdo kohë me:

a) bombol për fikjen e zjarrit, 1–2 kg, e cila duhet të jetë funksionale dhe brenda afatit të vlefshmërisë;

b) çekiç për thyerjen e xhamave që shërben njëkohësisht edhe për prerjen e rripit të sigurimit në raste emergjence.

14. Të ketë sedilje komode me rripa sigurie funksionale, të pajisura me sistem rregullimi dhe me pajisje bllokuese funksionale.

15. Të jetë i pajisur në çdo kohë me gomë rezervë funksionale, të vendosur brenda mjetit dhe të gatshme për përdorim në rast zëvendësimi.

16. Tek autoveturat për transport udhëtarësh me mbi 4+1 deri në 8+1 vende duhet të jenë të vendosura në vende të dukshme, lehtësisht të dallueshme dhe të lexueshme, tabela dhe shenja informuese:

- Ndalohet duhani;

- Mos i fol drejtuesit të mjetit;

- Numri i vendeve ulur, numri i vendeve në këmbë, numri i vendeve në total;

- Emërtimi linjës, kodi i linjës dhe numri i autobusit;

- Shkrimi “HYRJE” dhe “DALJE” në dyert e autobusit sipas funksionalitetit përkatës;

- Stacionet e linjës sipas një harte apo diagrame qartësisht të lexueshme.”.

6. Në kapitullin IV/a, pika 1, ndryshon si më poshtë:

“1. Licencat për autoveturat në shërbimin taksi shtypen dhe emetohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Shpërndarja do të kryhet në përputhje me udhëzimin e ministrit përgjegjës për transportin rrugor. Modeli, pamja grafike, elementet identifikuese të institucionit lëshues, elementet e sigurisë dhe të dhënat që duhet të përmbajë licenca për mjetin në shërbimin taksi, përcaktohen dhe miratohen me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të DPSHTRR-së.”.

7. Në kapitullin VI, “Të tjera”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

a) Pika 1, ndryshon si më poshtë:

“1. Tarifat për kontrollin teknik të mjeteve të transportit publik të udhëtarëve, miratohen nga ministri përgjegjës për transportin rrugor.”;

b) Pas pikës 3, shtohen pikat 4 dhe 5 me përmbajtje si më poshtë:

“4. Në momentin e paraqitjes së palës së interesuar për pajisje me Aktvlerësim, mjeti duhet të ketë kontroll teknik të vlefshëm dhe për të janë të shlyera detyrimet përkatëse pranë DPSHTRR-së.

5. Automjetet që përdoren në transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional, parauniversitar dhe të studentëve, për ofrimin e shërbimit duhet të zbatohen kushtet në zbatim të akteve ligjore për miratimin e kushteve dhe



përcaktimin e rregullave për transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe të studentëve.”.

8. Pas kapitullit VI, shtohet kapitulli VII, “Vlerësimi i mjetit” me përmbajtje si më poshtë:

“Mjeti paraqitet për vlerësim pranë qendrës së kontrollit teknik dhe në përfundim të tij lëshohet dokumenti:

1. Aktivlerësim për plotësimin e kushteve të komoditetit, për rastet kur mjeti plotëson kushtet e përcaktuara (kalues).

2. Raport Vlerësimi, për rastet kur mjeti nuk plotëson kriteret e përcaktuara (mjeti rezulton me mangësi). Ky raport vlerësimi i shërben subjektit për njohjen me kushtet që duhet të përmbushë në zbatim të legjislacionit në fuqi për pajisjen me aktivlerësim për plotësimin e kushteve të komoditetit. Mosplotësimi i kushteve ndalon përdorimin e tij në shërbimin e transportit të udhëtarëve dhe lejon qarkullimin e tij vetëm për në destinacionin e riparimit të mjetit. Mjeti me raport vlerësimi “mjeti rezulton me mangësi”, duhet të riparaqitet brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike me kushte të plotësuar, duke kryer pagesën përkatëse të rivlerësimit. Në rast të tejkalimit të afatit, mjeti do t’i nënshtrohet procedurës së vlerësimit nga e para për pajisje me aktivlerësim për plotësimin e kushteve të komoditetit, kundrejt kryerjes së pagesës së plotë.”.

9. Pas kapitullit VII, shtohet kapitulli VIII “Dokumenti i aktivlerësimit për plotësimin e kushteve të komoditetit”, me përmbajtje si më poshtë:

“Dokumenti i Aktivlerësimit për plotësimin e kushteve të komoditetit lëshohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor pranë sporteleve të shërbimit të qendrave të kontrollit teknik në varësi të saj. Aktivlerësimi për plotësimin e kushteve të komoditetit në transportin rrugor të udhëtarëve lëshohet:

a) për mjetin autoveturë në shërbimin taksi me emërtimin: “Aktvlerësim për plotësimin e kushteve të komoditetit për mjetin autoveturë në shërbimin taksi”;

b) për mjetin autoveturë për transport udhëtarësh me më shumë se 4+1 deri në 8+1 vende me emërtimin: “Aktvlerësim për plotësimin e kushteve të komoditetit për mjetin autoveturë për transport udhëtarësh me më shumë se 4+1 deri në 8+1”;

c) për mjetin autobus në transportin brenda vendit me emërtimin: “Aktvlerësim për plotësimin e kushteve të komoditetit për mjetin autobus në transportin rrugor brenda vendit të udhëtarëve”;

d) për mjetin autobus në transportin ndërkombëtar me emërtimin: “Aktvlerësim për plotësimin e kushteve të komoditetit për mjetin autobus në transportin rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve”;

e) për mjetin në transportin e nxënësve të arsimit parashkollor, profesional, parauniversitar dhe të studentëve me emërtimin: “Aktvlerësim për plotësimin e kushteve të komoditetit për mjetin në transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional, parauniversitar dhe të studentëve”;

f) për mjetin me destinacion “Autoshkollë” me emërtimin: “Aktvlerësim teknik për plotësimin e kushteve të komoditetit për mjetin me destinacion apo përdorim “Autoshkollë”.

Ky dokument ka afat vlefshmërie 1-vjeçar (njëvjeçar) dhe përmban të dhëna të dokumentit, të dhëna identifikuese të subjektit dhe mjetit për të cilin lëshohet. Modeli, pamja grafike, elementet identifikuese të institucionit lëshues, elementet e sigurisë dhe të dhënat që duhet të përmbajë, miratohen me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të DPSHTRR-së.

10. Pas kapitullit VIII, shtohet kapitulli IX “Dublikata”, me përmbajtje si më poshtë:

“Dublikata e aktivlerësimit për plotësimin e kushteve të komoditetit mund të lëshohet me kërkesë të pronarit apo përdoruesit të mjetit (referuar lejes së qarkullimit dhe të dhënave në sistemin informatik të DPSHTRR-së) në rast humbjeje, vjedhjeje ose shkatërrimi të dokumentit origjinal, me afat vlefshmërie të njëjtë me dokumentin e lëshuar më parë.”.

11. Në paragrafin “Dispozita kalimtare”, pas pikës 4, shtohen pikat 5 dhe 6 me përmbajtje si më poshtë:

“5. Dokumentet e lëshuara përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi janë të vlefshme deri në momentin e përfundimit të afatit të vlefshmërisë së tyre.

6. DPSHTRR-ja merr masat e nevojshme nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi për përditësimin e procedurave tekniko-administrative dhe sistemeve informatike për ofrimin e shërbimit të aktivlerësimit

për plotësimin e kushteve të komoditetit, brenda muajit janar 2027.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.



**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Enea Karakaçi**

ANEKS 3

PROGRAMI

Moduli	Orë	Temat e detajuara
Hyrje në profesion	1	-Historia e shërbimit me taksi; -Roli dhe përgjegjësitë e taksistëve.
Rregulloret dhe licencat	2	- Kriteret ligjore për t'u pajisur me dëshmi taksisti, afatet dhe vlefshmëria; - Procedurat për marrjen e licencës, afatet dhe vlefshmëria; - Rregulloret lokale mbi shërbimin e taksisë.
Siguria rrugore dhe emergjencat	2	- Sinjalet rrugore treguese dhe drejtimi i sigurt i mjetit taksi; - Mënyra e veprimit në rast aksidenti; - Përdorimi i pajisjeve të sigurisë.
Shërbimi ndaj klientëve	1	-Teknikat e komunikimit efektiv; -Menaxhimi i ankesave dhe konflikteve në mënyrë profesionale; -Shërbimi me etikë dhe respekt.
Gjeografia dhe navigimi	1	-Njohuri mbi rrugët dhe pikat e interesit -Përdorimi i GPS-it dhe hartave; -Planifikimi i itinerarit më të përshtatshëm.
Menaxhimi i mjetit	2	-Kushtet e veçanta që duhet të plotësojnë automjetet e shërbimit taksi; -Mirëmbajtja e mjetit; -Kontrolli i sigurisë së mjetit; -Rregulloret për transportin e pasagjerëve.
Aspektet ekonomike dhe fiskale	2	- Llogaritja e tarifave dhe procedurat e pagesës; - Menaxhimi i financave dhe shpenzimeve; - Rregulloret fiskale për taksistët.
Etika profesionale	1	-Sjelljet etike në punë; -Respekti për privatësinë e klientit.
Totali	12	

Modeli i dëshmisë së taksistit



**URDHËR**
Nr. 798, datë 4.8.2026**PËR DELEGIM TË KOMPETENCAVE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për periudhën 5.8.2026–21.8.2026, të zëvendësministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, znj. Tana Kika.

2. Zëvendësministri ndalohet të nëndelegojë te një organ i tretë kompetencat e përfituara përmes këtij akti delegimi.

3. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri, znj. Kika.

4. Me njohjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë nëpunësit/punonjësit e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

5. Ky urdhër hartohet në 3 (tre) kopje të njëjta, 1 (një) për arkiv/protokollin, 1 (një) për Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe 1 (një) për zëvendësministrin sipas pikës 1.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

NJOFTIM
Nr. 11748, datë 5.8.2026**MBI HYRJEN NË FUQI TË
MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE**

“Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, që vepron ndërmjet Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri, për Projektin e Vlerësimit të

Faqe | 17946

Dëmeve në Ndërtesa, një fazë e vetme, 2025–2029”, nënshkruar në Tiranë, më 19.5.2026, ka hyrë në fuqi në datën 22 korrik 2026.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË PËR EVROPËN DHE
PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

VENDIM
Nr. 77, datë 23.6.2026**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	kryetare;
Marsida	anëtare;
Xhaferllari,	
Sandër Beci,	anëtar;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahim,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 23.6.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 28 (F) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Fondacioni Shqiptaro-Amerikan “Harry T. Fultz”, përfaqësuar nga avokatja Evelina Qirjako, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Genci Beqiri, përfaqësuar nga avokati Erjon Syziu, me prokurë.

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm Engjëll Agaçi.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë-Veri, përfaqësuar nga drejtori Ergyst Skënderi.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-2121, datë 27.5.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 5, 16, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134 pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e



Njeriut (KEDNJ) dhe neni 1, i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 27 e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuarit, Fondacionit Shqiptaro-Amerikan “Harry T. Fultz” (*Fondacioni ose kërkesa*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Genci Beqiri, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Këshillit të Ministrave dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë-Veri (*ASHK*), që kanë kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i interesuar Genci Beqiri (*paditësi në procesin gjyqësor*), në cilësinë e trashëgimtarit të të ndjerit O. B., është bashkëpronar në pasurinë e paluajtshme të llojit truall, me nr. 8/409, zona kadastrale 8330, me sipërfaqe 1804 m², të ndodhur në qytetin e Tiranës, që rrjedh nga vendimi nr. 157, datë 4.7.1995 (*vendimi nr. 157/1995*) i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP), Tiranë, me të cilin kjo sipërfaqe është kthyer fizikisht. Ky vendim është regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP), Tiranë me nr. hipotekar 3188, datë 27.7.1995.

2. Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 207, datë 29.4.2000, “Për miratimin e pjesëmarrjes në fondacionin shqiptaro-amerikan “Harry T. Fultz”” (*VKM nr. 207/2000*) është vendosur: “1. *Miratimi i pjesëmarrjes së qeverisë së Republikës së Shqipërisë në krijimin e fondacionit shqiptaro-amerikan “Harry T. Fultz” së bashku me fondacionin shqiptaro-amerikan të arsimit “Harry T. Fultz” të shtetit të Virxhinias në SHBA. 2. Kontributi i qeverisë shqiptare të jenë pronat e paluajtshme, trualli dhe ndërtesat e identifikuar në planimetrinë që i bashkëlidhet vendimit, me numrat 8/115, 8/116, 8/117 dhe 8/118, të vendosura nga ZRRPP në Tiranë, duke*

përfshirë shkollën elektrike dhe godinën e saj dhe dhomat sportive të shkollës teknike “Harry T. Fultz”, pasuri kjo e regjistruar në hipotekë me nr. 644, datë 23.11.2000.”.

3. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP), me vendimin nr. 160, datë 24.4.2009 (*vendimi nr. 160/2009*), ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 157/1995, të KKKP-së, Tiranë. Ky vendim është kundërshtuar në gjykatë dhe me vendimin nr. 1811, datë 28.2.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pavlefshmërinë absolute të vendimit nr. 160/2009, të AKKP-së, Tiranë. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 2841, datë 4.12.2012.

4. Në vitin 2013 pjesa prej 1804 m² është regjistruar në emër të Fondacionit. Në vitin 2014 subjekti i interesuar Genci Beqiri ka aplikuar pranë ZVRPP-së, Tiranë për regjistrimin e vendimit nr. 2841, datë 4.12.2012, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe ZVRPP-ja, Tiranë ka regjistruar këtë pasuri me nr. 8/409, sipas titullit të pronësisë, vendimit nr. 157/1995, të KKKP-së, Tiranë. Në vijim shtetasi Genci Beqiri është pajisur me certifikatë pronësie. Në vijim, ZVRPP-ja, Tiranë, me urdhrin e kufizimit nr. 3503, datë 30.12.2014, ka vendosur anulimin e veprimit për pajisjen me certifikatën e pronësisë të subjektit të interesuar Genci Beqiri dhe kthimin e pasurive në gjendjen e mëparshme me status “mbivendosje”, për shkak se mbivendosej me titullin e pronësisë së kërkuarit sipas VKM-së nr. 207/2000.

5. Në datën 17.12.2018, trashëgimtarët Beqiri i janë drejtuar gjykatës së shkallës së parë me padi me të paditur Këshillin e Ministrave dhe person të tretë Fondacionin, me objekt konstatimin pjesërisht absolutisht të pavlefshme të VKM-së nr. 207/2000, vetëm për pjesën që ka cenuar pasurinë truall me sipërfaqe 1804 m², detyrimin e ZVRPP-së, Tiranë për heqjen e masës së kufizimit në pasurinë e paditësve nr. 8/409, me sipërfaqe 1804 m² dhe pajisjen e tyre me dokumentacion të vlefshëm hipotekar për këtë pasuri. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 60 (80-2019-77), datë 21.1.2029, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes për shkak të heqjes dorë nga paditësit.

6. Në datën 14.1.2019, subjekti i interesuar Genci Beqiri i është drejtuar gjykatës me padi me objekt konstatimin si pjesërisht absolutisht të pavlefshme të VKM-së nr. 207/2000, për pjesën që ka cenuar



pasurinë truall me sipërfaqe 1804 m², të regjistruar në ZVRPP-në, Tiranë në favor të bashkëpronarëve të familjes Beqiri, si dhe detyrimin e ZVRPP-së, Tiranë të kryejë veprimin administrativ të heqjes së masës së kufizimit në pasurinë e paditësit me nr. 8/409, me sipërfaqe 1804 m², si dhe të fshijë nga regjistri hipotekar çdo regjistrim tjetër që rrjedh nga VKM-ja. Si palë e paditur në gjykim është thirrur Këshilli i Ministrave dhe ASHK-ja, kurse si person i tretë kërkuesi, Fondacioni.

7. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 687, datë 27.2.2020, ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova, duke vlerësuar se nga Këshilli i Ministrave nuk është tejkualuar kompetenca në nxjerrjen e VKM-së nr. 207/2000. Lidhur me pretendimet për vlefshmërinë e titujve të pronësisë, ajo gjykatë ka vlerësuar se nuk janë objekt i këtij gjykimi, por palët mund t'i drejtohen gjykatës civile. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka gjetur të pabazuar edhe kërkimin për detyrimin e ZVRPP-së, Tiranë që të heqë masën e kufizimit, në kushtet kur ka dy tituj pronësie mbi të njëjtën pasuri, të cilët mbivendosen. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim paditësi.

8. Përpara Gjykatës Administrative të Apelit kërkuesi, në cilësinë e personit të tretë, ka kërkuar pezullimin e gjykimit të kësaj çështjeje deri në përfundimin me vendim gjyqësor të formës së prerë të çështjes civile të vënë në lëvizje prej tij me padinë e datës 26.2.2024, me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 157/1995 të KKKP-së, Tiranë, në pjesën që ka disponuar kthimin ish-pronarit të pasurisë së paluajtshme nr. 8/409. Gjykata e apelit ka vendosur rrëzimin e kësaj kërkesë, me arsyetimin se nuk janë kushtet e nenit 297/a të Kodit të Procedurës Civile (KPC), pasi, pavarësisht lidhjes midis dy gjykimeve, nuk është rasti që çështja administrative nuk mund të zgjidhet pa përfunduar gjykimi i çështjes civile, për sa kohë që vlerësimi nëse VKM-ja nr. 207/2000 është ose jo një akt administrativ pjesërisht absolutisht i pavlefshëm nuk varet nga përfundimi i gjykimit civil të vënë në lëvizje nga personi i tretë.

9. Në përfundim të gjykimit, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.1682 (86-2024-1808), datë 10.10.2024, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vendosur: pranimin e padisë; konstatimin pjesërisht absolutisht të pavlefshme të VKM-në nr. 207/2000, për sa i

përket pikës 2 të saj, për disponimin e pasurisë së paluajtshme nr. 8/118, për sipërfaqen 1804 m² që i korrespondon pasurisë së paluajtshme nr. 8/409; detyrimin e ASHK-së të heqë kufizimin e datës 21.3.2013, mbi këtë pasuri, të fshijë shënimin “mbivendosje” në kartelën e pasurisë, si dhe ta regjistrojë pasurinë sipas titullit të pronësisë, vendimit nr. 157/1995, të KKKP-së, Tiranë. Sipas asaj gjykate, pasuria e paluajtshme nr. 8/409, me sipërfaqe 1804 m², është disponuar në favor të Fondacionit me VKM-në nr. 207/2000, pika 2 e saj, si pjesë e pasurisë nr. 8/118 ndërkohë që Këshilli i Ministrave nuk ka pasur kompetencë të disponojë këtë pasuri pasi në atë kohë pronar nuk ka qenë shteti shqiptar, por paditësi dhe bashkëpronarët e tjerë sipas vendimit nr. 157/1995, të KKKP-së, Tiranë. Gjykata e apelit ka gjetur të drejtë edhe kërkimin për heqjen e masës së kufizimit mbi pasurinë, duke vlerësuar se ai zgjat 30 ditë kalendarike, afat që ka kaluar në kohën e ngritjes së padisë. Kundër vendimit ka paraqitur rekurs kërkuesi dhe Avokatura e Shtetit.

10. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-2121, datë 27.5.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 58, i ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*), që bën të mundur pretendimin për cenimin në thelb të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

Procese gjyqësore të lidhura

11. Kërkuesi rezulton t'i jetë drejtuar gjykatës me padi, me të kundërpaditur trashëgimtarët Beqiri dhe me objekt shfuqizimin pjesërisht të vendimit nr. 157/1995, të KKKP-së, Tiranë për sa i përket pikës 1 të këtij vendimi me të cilin i është kthyer të paditurve si truall i lirë sipërfaqja 4659 m², e regjistruar në pasuritë nr. 8/132, nr. 8/142 dhe nr. 8/143, që ndodhet brenda sipërfaqes së pronës së Fondacionit, si dhe detyrimin e së paditurës, ASHK-së, të fshijë nga regjistri i pasurive të paluajtshme pasurinë në emër të të paditurve e regjistrimin e saj në emër të paditësit.

12. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 3167, datë 23.5.2024, ka vendosur kthimin e padisë dhe akteve. Mbi ankimin e paditësit (kërkuesit) Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr.



1100, datë 2.6.2026, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

13. Po kështu, rezulton se edhe fondacioni “Zonja e Këshillit të Mirë” i është drejtuar gjykatës me padi kundërdrejtuar trashëgimtarëve Beqiri, përfshirë kërkuësin, me objekt anulimin e vendimit nr. 157/1995, për pasuritë nr. 8/399 dhe 8/403, detyrimin e të paditurve ta njohin pronar, si dhe detyrimin e ASHK-së të lëshojë certifikatën e pronësisë në emër të paditësit për këto pasuri. Të paditurit kanë ngritur kundërpadi me objekt detyrimin e paditësit, fondacionit “Zonja e Këshillit të Mirë”, të njohë pronarë trashëgimtarët e Y. B. dhe S. B. për pronën e njohur dhe kthyer në natyrë me vendimin nr. 157/1995, të KKKP-së, Tiranë dhe urdhërimin e ZVRPP-së, Tiranë të fshijë nga regjistrat hipotekarë truallin e regjistruar në emër të paditësit për pjesën që ka krijuar mbivendosje me pronën e të paditurve, si dhe pajisjen e tyre me dokumentacion të vlefshëm hipotekar.

14. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 7445, datë 5.11.2019, ka vendosur pranimin e kërkesëpadiës, anulimin pjesërisht të vendimit nr. 157/1995 të KKKP-së, për sa u përket pasurive nr. 8/399, me sipërfaqe 1084 m² dhe nr. 8/403, me sipërfaqe 113 m², të ndodhura në rrugën “Mine Peza”, Tiranë, detyrimin e të paditurve kundërpadiës të njohin paditësin e kundërpaditur pronar të ligjshëm të këtyre pasurive, detyrimin e ASHK-së të lëshojë certifikatën e pronësisë në emër të paditësit të kundërpaditur për këto pasuri, si dhe rrëzimin e kundërpadiës të të paditurve/kundërpadiës. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim të paditurit kundërpadiës.

15. Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 468 (30-2024-4061), datë 22.5.2024, ka vendosur pushimin e shqyrtimit të çështjes në shkallë të dytë, pra vendimi i gjykatës së shkallës së parë ka mbetur i pacenuar, për shkak të heqjes dorë të palëve nga ankimi.

16. Në datën 11.9.2025, kërkuësi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata) sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të nenit 27, të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 17.9.2025. Kolegji i Gjykatës në datën 10.11.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

17. Në mbështetje të parashikimeve të nenit 36, pika 1, të Ligjit Organik dhe nenit 18, pika 1, të

Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, me vendimin e datës 18.6.2026, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur pranimin e kërkesës së një gjyqtari për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes, kurse me vendimin e datës 22.6.2026, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së një gjyqtari tjetër për heqjen dorë nga shqyrtimi i kësaj çështjeje.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

18. **Kërkuësi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar:

18.1 *Cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor*, në drejtim të:

18.1.1 *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative (KPA) dhe ligjit nr. 49/2012, si dhe praktikën e Gjykatës së Lartë, pavarësisht mënyrës së formulimit të objektit të padisë, për pasojat që ajo sjell, në thelb, nuk është një çështje që përbën lëndë administrative, por civile ndaj duhej të gjykohej nga Kolegji Civil. VKM-ja nr. 207/2000, nuk ka transferuar të drejta pronësie në favor të kërkuësit, por ka shprehur vullnetin që në të ardhmen të krijonte dhe të merrte pjesë si bashkëthemelues i një personi juridik privat. VKM-ja ka dalë në bazë të nenit 54 e vijues të Kodit Civil dhe jo të ndonjë ligji të posaçëm të së drejtës publike. Çështja e kompetencës lëndore duhej të ishte vlerësuar edhe kryesisht nga Gjykata e Lartë.

18.1.2 *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi kryesuesja e trupit gjykuës në Kolegjin Administrativ, gjyqtarja E. M.(S.), ka marrë pjesë në gjykimin e së njëjtës çështje në gjykatën e apelit, ku ka marrë vendimin e datës 27.3.2023 “Për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve”, kurse me vendimin nr. 00-2024-5206, datë 18.12.2024, është shprehur për kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit.

18.1.3 *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, si pasojë e mosformimit të drejtë të ndërgjyqësisë, për shkak se kërkuësi është thirrur në gjykim në cilësinë e personit të tretë dhe jo të të paditurit, në kundërshtim me nenet 192, 193, 161, 162 dhe 467 të KPC-së. Për rrjedhojë, ai ka pasur mjete procedurale jo të barabarta dhe të kufizuara në krahasim me palët e tjera në gjykim. Kjo sjell cenimin edhe të parimit të barazisë në të drejta.



18.1.4 *Së drejtës së aksesit substancial*, pasi Kolegji Administrativ nuk ka shqyrtuar kryesisht çështjet ligjore që duhen shqyrtuar kryesisht nga gjykata si parakushte procedurale në çdo fazë gjykimi. Kolegji Administrativ nuk ka shqyrtuar dhe nuk i ka dhënë përgjigje asnjë prej shkaqeve të ngritura në rekurs.

18.1.5 *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Kolegji Administrativ nuk ka arsyetuar dhe nuk ka bërë analizë ligjore se përse shkaqet e rekursit ishin të pabazuara. Ai nuk ka shqyrtuar çështjet ligjore që duhen shqyrtuar kryesisht, konkretisht për kompetencën e gjykatave dhe pjesëmarrjen e kërkuarit në gjykim në cilësinë e personit të tretë. Vendimi është kontradiktor, alogjik dhe i pakuptueshëm. Për rrjedhojë, është cenuar edhe *parimi i sigurisë juridike i lidhur me pritshmëritë e ligjshme*, pasi Kolegji Administrativ nuk ka zbatuar normën ligjore detyruese për shqyrtimin kryesisht të kompetencës lëndore të gjykatave.

18.2 *Së drejtës së pronës private*, për shkak të shkeljes nga gjykatat të së drejtës për një proces të rregullt. Vendimi objekt ankimi ka përkeqësuar situatën pasurore dhe financiare të kërkuarit, duke e zhveshur atë nga pronësia mbi pasurinë në të cilën zhvillon prej dekadash aktivitetin arsimor në mënyrë të ligjshme dhe legjitime, pasuri e destinuar në funksion të së mirës publike.

19. **Subjekti i interesuar, Genci Beqiri**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar:

19.1 Pretendimi për cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* është i pabazuar, pasi në procesin gjyqësor kërkuari ka marrë pjesë, ka paraqitur prova dhe ka debatuar mbi to, ka paraqitur prapësime etj. Të gjitha kërkimet e padisë, lidhen me fushën e zgjidhjes së një konflikti me natyrë administrative, megjithatë ky pretendim nuk përbën lëndë për t'u shqyrtuar nga Gjykata.

19.2 I pabazuar është edhe *pretendimi për të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi në gjykatën e apelit gjyqtarja E. M. (S.) nuk ka zhvilluar asnjë seancë gjyqësore, nuk ka bërë vlerësim të çështjes, nuk është shprehur për provat, themelin dhe procedurën gjyqësore. Edhe pse është njohur me përbërjen e trupit gjykues në Gjykatën e Lartë, kërkuari nuk ka paraqitur asnjë pretendim në këtë drejtim.

19.3 Për pretendimin për *cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit* referuar mosformimit të drejtë të ndërgjyqësisë, gjatë procesit gjyqësor Fondacioni ka marrë pjesë në

seancat gjyqësore, duke ushtruar të gjitha të drejtat e palëve në gjykim dhe duke marrë pjesë aktive në debatin gjyqësor. Po ashtu, ai ka ushtruar të drejtën e rekursit në Gjykatën e Lartë, i cili u vlerësua nga ajo gjykatë, si dhe ka mbajtur qëndrim për çështjen nëpërmjet parashtrimeve, analizës së provave etj.

19.4 I pabazuar është edhe *pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit, si dhe parimit të sigurisë juridike*, pasi kërkuari i është siguruar akses formal dhe substancial dhe Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me jurisprudencën kushtetuese, me ligjin dhe kompetencën e asaj gjykate.

19.5 I pabazuar është edhe pretendimi për *cenimin e së drejtës së pronës private*. Kërkuari ka kërkuar të ndërhyjë në tagrat e ligjshëm të pronës së paditësit dhe faktet provojnë se janë gjetur shkelje të natyrës administrative nga të paditurit, duke penguar përkohësisht disa nga të drejtat e pronarit. Veprimet e paligjshme të organeve të administratës publike janë korrigjuar nga vendimi i gjykatës, kurse për çdo pretendim që mund të ketë në të ardhmen, kërkuari ka mjete ligjore për paraqitjen e tyre përpara gjykatës. Paditësi i ka fituar të drejtat me vendim të KKKP-së, Tiranë të formës së prerë, kur Fondacioni nuk ekzistonte si entitet dhe ky i fundit nuk ka fituar asnjëherë të drejta të ligjshme mbi pasurinë. Ai përfaqëson një fondacion të krijuar me qëllim arsimor dhe nuk ka asnjë të drejtë që konkurron me ato të fituara me vendim të KKKP-së.

20. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar:

20.1 Pretendimi për *cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* është i bazuar, pasi referuar shkakut të padisë dhe pretendimeve për pavlefshmërinë e aktit, ato janë të natyrës civile. Në kuptim të legjislacionit të posaçëm në fuqi në kohën e daljes së vendimit, nenit 105 të KPA-së, nenit 2, të ligjit nr. 49/2012 dhe vendimit unifikues nr. 3, të vitit 2012 të Gjykatës së Lartë, VKM-ja nr. 207/2000, nuk përbën akt administrativ individual. Çështja e kompetencës lëndore duhej të ishte shqyrtuar kryesisht nga çdo gjykatë.

20.2 Pretendimi për *cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme* është i bazuar, pasi kryesuesja e trupit gjykues të Kolegjit Administrativ, e cila ka marrë pjesë në gjykimin e së njëjtës çështje në apel, edhe pse në prani të këtij fakti, nuk ka kërkuar dorëheqjen nga gjykimi i çështjes.



20.3 I bazuar është edhe pretendimi për *cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi Fondacioni është thirrur në gjykim në cilësinë e personit të tretë, shkak për të cilin ka pasur në dispozicion mjete procedurale të kufizuara për të kundërshtuar titullin e pronësisë së paditësit dhe për të provuar ligjshmërinë e titullit (nuk ka pasur të drejtën të paraqesë kundërpadi). Edhe pse kërkuesi ka kundërshtuar gjyqësisht në rrugë civile titullin e pronësisë, Gjykata Administrative e Apelit ka rrëzuar kërkesën për pezullimin e gjykimit administrativ, me arsyetimin se nuk janë kushtet e nenit 297 të KPC-së, ndërkohë që kjo çështje nuk mund të zgjidhet pa përfunduar gjykimi i çështjes civile. Kolegji Administrativ nuk ka konstatuar mosformimin e drejtë të ndërgjyqësisë edhe pse pasojat ishin të drejtpërdrejta për kërkuесin, gjë që sjell pavlefshmërinë e procesit.

20.4 Edhe pretendimi për *cenimin e së drejtës së aksesit substancial* të lidhur me *standardin e arsytimit të vendimit* është i bazuar, pasi Kolegji Administrativ jo vetëm që nuk ka shqyrtuar kryesisht çështjet ligjore, por as parakushtet procedurale që shqyrtohen në çdo fazë dhe shkallë gjykimi, të tilla si kompetenca lëndore, identifikimi i shkakut ligjor të padisë në funksion të përcaktimit të kompetencës lëndore dhe formimi i drejtë i ndërgjyqësisë.

20.5 Në drejtim të pretendimit për *cenimin e parimit të sigurisë juridike*, ai cenohet kur gjykata: nuk ka zbatuar normën ligjore detyruese për shqyrtimin kryesisht të kompetencës lëndore; nuk ka identifikuar shkakun ligjor të padisë në funksion të përcaktimit të kompetencës lëndore; nuk ka analizuar normën ligjore për formimin e drejtë të ndërgjyqësisë. Vendimi i kundërshtuar ka cenuar këtë parim edhe në drejtim të pritshmërive të ligjshme, ashtu edhe parimin e barazisë në të drejta për shkak të moszbatimit të normave ligjore detyruese dhe sepse e njëjta trupë, për çështje analoge, ka mbajtur qëndrime të ndryshme për formimin e ndërgjyqësisë.

21. **Subjekti i interesuar, ASHK-ja**, në mënyrë të përmblodhur, ka parashtruar:

21.1 Vendimi i Kolegjit Administrativ bie ndesh me nenet 42 dhe 43 të Kushtetutës. Mospranimi i rekursit e ka shndërruar këtë mjet ankimi në një mjet formal dhe jo efektiv. I vetmi arsyetim i Kolegjit Administrativ përmbledhet në një paragraf, sipas të cilit në përmbajtje të rekursit nuk përcaktohet asnjë prej rasteve të nenit 58, të ligjit nr. 49/2012. Vendimi

që ka mbyllur në mënyrë përfundimtare çështjen është i mangët kundrejt standardit kushtetues të domosdoshmërisë së vendimit të arsyetuar gjyqësor.

21.2 Shkeljet e nenit 42 të Kushtetutës kanë të bëjnë me: i. mungesën e paanshmërisë së gjykatës, pasi një gjykatë që ka një interes të drejtpërdrejtë ose një lidhje të ngushtë me njërën nga palët mund të ndikojë në vendimin përfundimtar; ii. mungesën e mundësisë për mbrojtje të plotë ligjore, pasi nëse një palë nuk ka mundësi të paraqesë argumentet ose provat e saj në mënyrë të barabartë, kjo mund të rezultojë në një proces të padrejtë. ASHK-ja ka qenë palë edhe e proceseve civile për ligjshmërinë e titullit të pronësisë nga bashkëpronarët Beqiri dhe ato mund të sjellin zhvillime të reja. Më tej akoma, përfaqësimi i pamjaftueshëm ose i dobët ligjor i palës që direkt i preken interesat pronësorë, pra Fondacionit, duke qenë se në procesin administrativ ka qenë në cilësinë e palës së tretë, sjell mungesën e barazisë në mjetet e mbrojtjes.

21.3 Në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës, e drejta e ankimit është ushtruar, por vetëm formalisht dhe Gjykata e Lartë ka dhënë një vendim të paarsyetuar dhe totalisht formal, duke sjellë si argument të mospranimit të rekursit vetëm nenin 58, të ligjit nr. 49/2012.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuесit

22. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.



23. Duke pasur parasysh natyrën kumulative të kriterëve të legjitimitit dhe jurisprudencën e saj, Gjykata vëren se kriteret *ratione personae* dhe *ratione temporis* janë të përmbushura. Në lidhje me to nuk rezulton të ketë çështje që kërkojnë analizë të mëtejshme, ndërsa as subjektet e interesuara nuk kanë ngritur ndonjë prapësim.

24. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, i cili nënkupton edhe që të gjitha pretendimet që ngrihen në ankimin kushtetues individual të jenë paraqitur më parë në gjykatat e zakonshme, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 40, datë 14.5.2024; nr. 38, datë 12.7.2023; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*), Gjykata vëren se kërkuksi formalisht i është drejtuar asaj pas përfundimit të procesit gjyqësor në të gjitha shkallët e juridiksionit të zakonshëm gjyqësor. Për sa u përket pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues dhe argumenteve mbi të cilat janë mbështetur ato, rezulton se pretendimin për të drejtën e pronës private, i cili lidhet, në thelb, me vendimmarrjen e gjykatës së apelit, kërkuksi nuk e ka parashtruar në rekurs dhe në parashtrimet drejtuar Gjykatës së Lartë, ndërkohë që ai ka ngritur pretendime përpara asaj gjykatë për provueshmërinë e pronësisë (ligjshmërinë e titullit) nga paditësi në procesin gjyqësor. Kurse në ankimin kushtetues ky pretendim është parashtruar i lidhur me *cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor*, duke pretenduar kërkuksi se për shkak të mënyrës sesi ato kanë vepruar, gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë kanë cenuar, në thelb, edhe të drejtën e pronës private.

25. Kërkuksi ka pretenduar edhe cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit* dhe lidhur me të edhe të *parimit të barazisë në të drejta*, si pasojë e mosformimit të drejtë të ndërgjyqësisë, për shkak se ai, duke u thirrur në gjykim në cilësinë e personit të tretë, ka pasur mjete procedurale jo të barabarta dhe të kufizuara në krahasim me palën tjetër.

26. Në lidhje me këtë pretendim të kërkuksit, pas shqyrtimit të plotësisht të këtij kriteri, në përfundim të diskutimeve, vlerësimet e gjyqtarëve u ndanë dhe Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje në lidhje me të, sipas parashikimeve

të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës.

27. Sipas njërit qëndrim³, u vlerësua se kërkuksi nuk e ka ngritur më parë në Gjykatën e Lartë, në formë ose substancë, pretendimin për mosformimin e drejtë të ndërgjyqësisë në procesin gjyqësor. Po kështu, edhe referuar përmbajtjes së vendimeve gjyqësore dhe vetë ankimit kushtetues individual, nuk rezulton që kërkuksi të ketë ngritur pretendime në lidhje me pozitën e tij procedurale gjatë procesit gjyqësor të kundërshtuar, ose që të mos ketë pasur mundësinë të ushtrojë të drejtat e tij apo të parashtojë pretendimet e tij gjatë atij gjykimi. Për rrjedhojë, sipas këtij qëndrimi, konsiderohet se në lidhje me pretendimin për cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit* dhe lidhur me të edhe të *parimit të barazisë në të drejta*, kërkuksi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

28. Sipas qëndrimit tjetër⁴, ndonëse ky pretendim nuk është formuluar shprehimisht në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, ai rezulton të jetë parashtruar në substancë, si argument i lidhur ngushtësisht me procesin civil për kundërshtimin e vendimit nr. 157/1995 të KKKP-së, Tiranë, i cili është ngritur si shkak edhe në rekurs. Në këtë kuptim, argumentet e paraqitura në rekurs kanë vënë në diskutim, në thelb, pamundësinë e kërkuksit për të ushtuar të njëjtat mjete procedurale si palët e tjera në gjykim për mbrojtjen e të drejtave që ai pretendon se i janë cenuar. Për rrjedhojë, sipas këtij qëndrimi, pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, si dhe të *parimit të barazisë në të drejta*, duhet të konsiderohet se është ngritur në substancë përpara Gjykatës së Lartë, ndaj kërkuksi ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion të tij.

29. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, sipas kërkuksit, pavarësisht formulimit të objektit të padisë, në thelb, për pasojat që sjell, kjo çështje nuk përbën lëndë administrative, por civile. Gjykata, referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, vëren se në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, sikundër edhe në parashtrimet e datës 20.5.2025, të paraqitura në atë gjykatë, kërkuksi nuk e ka ngritur këtë pretendim në

³ Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Sonila Bejtja, Sandër Beci dhe Genti Ibrahim.

⁴ Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska dhe Marjana Semini.



formën që parashtrohet në ankimin kushtetues individual. Kërkuesi ka kundërshtuar arsyetimin e gjykatës së apelit që lidhet me ligjshmërinë e titullit të tij të pronësisë, duke pretenduar se çështja e titullit të pronësisë nuk është objekt i këtij gjykimi, por i përket juridiksionit civil dhe ky titull është duke u shqyrtuar në një proces tjetër civil, me status “në gjykim”. Kërkuesi përpara Gjykatës së Lartë ka pretenduar se arsyetimi dhe argumentet e gjykatës së apelit përbëjnë interpretim përtej objektit të kërimit në padi, në keqinterpretim të elementit civil në një gjykim administrativ, duke sqaruar përpara asaj gjykate edhe çështjen e pronësisë, bazuar në aktet përkatëse provuese. Në parashtrimet e datës 20.5.2025, drejtuar Gjykatës së Lartë kërkuesi ka kundërshtuar argumentimin dhe pranimin e paditësit Genci Beqiri si pronar, duke u interpretuar në mënyrë arbitrare elemente civile në shkelje të kompetencave lëndore të gjykatave administrative sipas nenit 7, të ligjit nr. 49/2012. Për rrjedhojë, edhe pse kërkuesi nuk rezulton që formalisht të ketë pretenduar cenimin e *së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, Gjykata, referuar argumenteve të parashtruara në mbështetje të këtij pretendimi, vlerëson se ai është ngritur në substancë përpara Gjykatës së Lartë, ndaj konsiderohet i shteruar.

30. Kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *parimit të paanshmërisë në gjykim*, pasi kryesuesja e trupit gjykues në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, gjyqtarja E. M.(S.), ka marrë pjesë në gjykimin e së njëjtës çështje edhe në Gjykatën Administrative të Apelit, ku ka dhënë vendimin e datës 27.3.2023, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve dhe vendimin e datës 18.12.2024, për kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit. Gjykata, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore të administruar vëren, fillimisht, se gjykimi në gjykatat e faktit është bërë në seancë gjyqësore dhe kërkuesi, në cilësinë e personit të tretë, ka marrë pjesë në atë gjykim përmes përfaqësuesit të tij. Kërkuesi është pala që ka vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë me rekurs, i cili është regjistruar në atë gjykatë në datën 7.2.2025. Referuar të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, trupi gjykues i caktuar për shqyrtimin e çështjes së kërkuesit, ku bënte pjesë edhe gjyqtarja E. M.(S.), është shpallur në datën 21.5.2025. Kërkuesi, edhe pse ka qenë në dijeni të ekzistencës së shkakut të pretenduar për paanshmërinë e gjyqtarës dhe kishte të gjitha mundësitë procedurale që ofron legjislacioni për të

kërkuar përjashtimin e saj, nuk rezulton që t’i ketë përdorur ato. Po kështu, në ankimin kushtetues individual kërkuesi nuk ka parashtruar se kur ka marrë dijeni efektivisht për përbërjen e trupit gjykues në Gjykatën e Lartë ose për pamundësinë e tij për të kërkuar në atë gjykatë përjashtimin e gjyqtarës E. M.(S.). Megjithatë, ndonëse për Gjykatën paraqitet për diskutim çështja e shterimit të mjeteve juridike në dispozicion për këtë pretendim, ajo çmon të mos ndalet në këtë aspekt, për sa kohë që ky pretendim rezulton të jetë haptazi i pabazuar për arsyet që do të parashtrohen në vijim (*shih më poshtë paragrafët 33–35 të vendimit*).

31. Për sa u përket pretendimeve të tjera të parashtruara në ankimin kushtetues, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual.

32. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, për sa i përket pretendimit për cenimin e *së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, rezulton se në datën 26.2.2024, pas përfundimit të çështjes administrative në gjykatën e shkallës së parë dhe gjatë kohës që çështja ishte për gjykim në gjykatën e apelit, kërkuesi ka depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë padi me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 157/1995, të KKKP-së, për pjesën që ka disponuar kthimin ish-pronarit të pasurisë së paluajtshme nr. 8/409. Për këtë shkak, gjatë procesit administrativ në gjykatën e apelit ai ka kërkuar pezullimin e gjykimit të kësaj çështjeje (administrative) deri në përfundimin me vendim gjyqësor të formës së prerë të çështjes civile. Kjo kërkesë është rrëzuar nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila ka vlerësuar se nuk janë kushtet e nenit 297, shkronja “a”, të KPC-së pasi, pavarësisht lidhjes mes gjykimeve, gjykata administrative do të kontrollojë nëse VKM-ja nr. 207/2000, është ose jo një akt administrativ pjesërisht absolutisht i pavlefshëm, gjë që nuk varet nga përfundimi i gjykimit civil. Sipas asaj gjykate, nëse personi i tretë (kërkuesi) do të rezultojë gjyqfitues në gjykimin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ASHK-ja ka detyrimin ligjor të regjistrojë pasurinë sipas disponimeve të vendimit gjyqësor civil të formës së prerë. Po kështu, referuar edhe përmbajtjes së vendimeve gjyqësore, nuk rezulton që gjykata e apelit të ketë vënë në diskutim vetë titullin e pronësisë së paditësit, por mënyrën e ushtrimit të kompetencave të tij nga organi administrativ (Këshilli i Ministrave) në miratimin e aktit



administrativ të kundërshtuar, referuar akteve dhe provave në kohën e miratimit të VKM-së nr. 207/2000. Gjykata e apelit është shprehur për faktin se kjo çështje i përket juridiksionit administrativ, çka do të thotë se ka marrë në shqyrtim dhe i ka dhënë përgjigje në thelb këtij pretendimi, duke u shprehur edhe se çdo pretendim që mund të kenë palët për ligjshmërinë e titullit të pronësisë i takon një gjykimi tjetër, atij civil, dhe nuk mund të merret në shqyrtim në procesin administrativ përpara saj. Për rrjedhojë, për sa kohë që edhe pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike të lidhur me pritsmëritë e ligjshme* lidhet me zbatimin e normës ligjore detyruese për shqyrtimin kryesisht të kompetencës lëndore të gjykatave administrative për shqyrtimin e çështjes, ai është, gjithashtu, haptazi i pabazuar.

33. Për sa i përket pretendimit për njëanshmërinë e gjyqtarës E. M.(S.) që ka marrë pjesë në trupin gjykues që ka shqyrtuar çështjen në Gjykatën e Lartë, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se respektimi i *parimit të paanshmërisë*, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, duhet të verifikohet duke aplikuar testin *subjektiv*, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes ose interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar dhe testin *objektiv*, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë. Veçanërisht për sa i përket kriterit të dytë, kur zbatohet për anëtarët e trupit gjykues, ai nënkupton se përveç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme mund të ketë njëfarë rëndësie. Në përcaktimin nëse, në një çështje konkrete, ekzistojnë arsye logjike për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që ankohen për diçka të tillë është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Në fakt, vendimtar është nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshëm i bazuar (*shih vendimet nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 49, datë 16.10.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Paragjykimi eventual për paanshmërinë e gjyqtarit mund të ngrihet edhe në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt (*shih vendimet nr. 15, datë 26.3.2012; nr. 12, datë 13.4.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, fakti i thjeshtë që gjyqtari ka marrë vendim, në vetvete nuk mjafton për të

mbështetur dyshimet rreth paanshmërisë së tij, por ajo që ka rëndësi është qëllimi dhe natyra e veprimeve që kryen ai gjatë procesit gjyqësor. Në të njëjtën mënyrë, njohuritë e detajuara të gjyqtarit për çështjen nuk përbëjnë ndonjë shkak për të dyshuar për paanshmërinë e tij gjatë marrjes së vendimit në themel (*shih vendimet nr. 25, datë 11.6.2013; nr. 16, datë 19.4.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Gjykata, duke pasur parasysh se procesi i gjykimit kushtetues është i natyrës argumentuese, që nënkupton se u takon palëve të parashtrojnë argumentet faktike dhe ligjore mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre (*shih vendimet nr. 57, datë 25.7.2017; nr. 42, datë 25.5.2017; nr. 45, datë 29.6.2015, të Gjykatës Kushtetuese*), vlerëson se në lidhje me këtë pretendim kërkuar nuk ka paraqitur asnjë provë për ta mbështetur atë, përveçse ai është edhe haptazi i pabazuar, për sa kohë që pjesëmarrja në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë edhe e një gjyqtari që ka dhënë, më parë, disa vendime të ndërmjetme në gjykatën e apelit, nuk sjell *a priori* cenim të parimit të paanshmërisë. Edhe pse gjyqtarja E. M. (S.), gjatë ushtrimit të funksionit të saj si gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit ka dhënë disa vendime të ndërmjetme në çështjen e kërkuar, pjesëmarrja në këto vendimmarrje të mëparshme nuk përfshin qëndrime që mund të krijojnë dyshime objektivisht të justifikuara për paanshmërinë e saj në shqyrtimin e çështjes së kërkuar si anëtare e trupës gjyqësore të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Gjyqtarja E. M. (S.) nuk rezulton dhe as nuk pretendohet të ketë gjykuar dhe të jetë shprehur për faktet dhe ligjin që qëndrojnë në themel të mosmarrëveshjes së palëve ndërgjyqëse, e cila ka qenë objekt i procesit gjyqësor të kundërshtuar. Në kontekst të rrethanave të rastit konkret, për sa kohë që ajo gjyqtare nuk ka gjykuar dhe nuk është shprehur më parë për themelin e kësaj çështjeje, pra për të njëjtën çështje, vetëm fakti se ajo ka qenë më parë anëtare e trupës gjyqësore që ka dhënë vendimet e ndërmjetme në gjykatën e apelit nuk krijon dyshim të justifikuar për mungesën e paanshmërisë në procesin gjyqësor të kundërshtuar. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi për cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme* është haptazi i pabazuar.

36. Gjykata vëren se kërkuar ka pretenduar edhe cenimin e *së drejtës së aksesit substancial*, pasi Kolegji Administrativ nuk ka shqyrtuar kryesisht çështjet ligjore që janë parakushte procedurale në çdo fazë



gjykimi dhe shkaqet e rekursit, duke mos u dhënë përgjigje. Po kështu, ai ka pretenduar edhe cenimin e *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka bërë asnjë arsyetim dhe asnjë analizë ligjore se përse shkaqet e ngritura në rekurs nga kërkuesi ishin të pabazuara dhe vendimi i tij nuk plotësonte kriteret e një vendimi gjyqësor të arsytuar. Në lidhje me këto pretendime të kërkuesit, për nga natyra dhe përmbajtja e argumenteve mbi të cilat janë bazuar ato, Gjykata vlerëson që t'i shqyrtojë në vijim së bashku në drejtim të bazueshmërisë së tyre në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

37. Sipas kërkuesit, Kolegji Administrativ nuk ka shqyrtuar kryesisht çështjet ligjore të cilat, në përputhje me KPC-në dhe jurisprudencën kushtetuese e të Gjykatës së Lartë, duhen shqyrtuar kryesisht nga gjykata si parakushte procedurale në çdo fazë gjykimi dhe nuk ka shqyrtuar dhe nuk i ka dhënë përgjigje asnjë prej shkaqeve të ngritura në rekurs. Po sipas tij, ai kolegji nuk ka arsytuar dhe nuk ka bërë analizë ligjore se përse shkaqet e ngritura në rekurs ishin të pabazuara, nuk ka shqyrtuar çështjet ligjore që duhen shqyrtuar kryesisht, konkretisht lidhur me kompetencën e gjykatave dhe pjesëmarrjen e kërkuesit në gjykim në cilësinë e personit të tretë. Kërkuesi ka pretenduar se vendimi i kundërshtuar është kontradiktor, alogjik dhe i pakuptueshëm, duke mos respektuar standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

38. *Subjekti i interesuar, Genci Begiri*, ka prapësuar se ky pretendim është i pabazuar, pasi kërkuesit i është siguruar akses formal dhe substancial dhe Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me jurisprudencën kushtetuese, me ligjin dhe kompetencën e asaj gjykate.

39. *Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave*, ka parashtruar se këto pretendime janë të bazuara, pasi Kolegji Administrativ nuk ka shqyrtuar kryesisht çështjet ligjore dhe parakushtet procedurale që shqyrtohen në çdo fazë dhe shkallë gjykimi, si kompetenca lëndore, identifikimi i shkakut ligjor të padisë në funksion të përcaktimit të kompetencës lëndore dhe formimi i drejtë i ndërgjyqësisë. Sipas tij, rekursi është shndërruar në një mjet ankimi formal dhe joefektiv.

40. *Subjekti i interesuar, ASHK-ja*, ka parashtruar se vendimi i Kolegjit Administrativ bie ndesh me nenet 42 dhe 43 të Kushtetutës, duke e shndërruar rekursin në një mjet ankimi formal dhe jo efektiv. Sipas tij, arsyetimi i vendimit është formal dhe ai përmbledhet në një paragraf, çka do të thotë se vendimi që ka mbyllur në mënyrë përfundimtare procesin gjyqësor është i mangët, duke mos respektuar standardin e domosdoshmërisë së arsytimit të vendimit gjyqësor.

41. Në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, përpara së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj, të arsytuar, për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 11, datë 21.4.2022; nr. 17, datë 24.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

42. E drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsytuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkcioni i vendimit gjyqësor është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, duke u dhënë mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Me arsyetimin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo standardet kushtetuese, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsytuar. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsytuar (*shih vendimet nr. 2, datë*



11.2.2021; nr. 63, datë 23.9.2015; nr. 55, datë 18.12.2012, të Gjykatës Kushtetuese).

43. Gjykata ka theksuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrар, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 11, datë 11.2.2026; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.5.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

44. Për sa më sipër, Gjykata vlerësoi të verifikojë, në vijim, nëse Gjykata e Lartë, duke pasur parasysh edhe rolin e funksionin e saj si gjykatë ligji, ka marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në rekurs nga kërkuuesi dhe u ka dhënë atyre përgjigje përfundimtare të arsyetuar, në këndvështrim të së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit.

45. Pas shqyrtimit të këtij pretendimi, në përfundim të diskutimeve, vlerësimet e gjyqtarëve u ndanë dhe Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje në lidhje me (pa)bazueshmërinë e tij në themel, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës.

46. *Sipas një qëndrimi*⁵, pretendimi i kërkuessit për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë në aspektin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i bazuar. *Së pari*, Gjykata e Lartë nuk ka dhënë një përgjigje të arsyetuar ndaj pretendimit, të parashtruar në substancë në rekurs, që lidhet me formimin e rregullt të ndërgjyqësisë dhe pasojat që kjo çështje kishte mbi pozitën procedurale të kërkuessit, veçanërisht në lidhje me mundësinë e tij për të marrë pjesë efektivisht në proces dhe për të mbrojtur të drejtat e pretenduara. *Së dyti*, ajo nuk i është përgjigjur as pretendimit për pezullimin e gjykimit administrativ deri në përfundimin e procesit civil, në të cilin po

shqyrtohej vlefshmëria e titullit të pronësisë mbi truallin. Ky pretendim kishte rëndësi thelbësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, pasi vetë VKM-ja e kundërshtuar kishte disponuar mbi të drejtën e pronësisë mbi atë truall, duke u mbështetur në dispozitat e Kodit Civil që rregullojnë marrëdhëniet e pronësisë. Në këto kushte, Gjykata e Lartë duhej të vlerësonte nëse vijimi i gjykimit administrativ përpara përfundimit të procesit civil ishte i pajtueshëm me kërkesat e një mbrojtjeje gjyqësore efektive dhe me nevojën për të shmangur vendime potencialisht kontradiktore.

47. Për rrjedhojë, sipas këtij qëndrimi, Gjykata e Lartë nuk ka përmbushur detyrimin kushtetues për t'u dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve thelbësore të rekursit. Mungesa e arsyetimit, si për çështjen e formimit të rregullt të ndërgjyqësisë dhe ndikimit të saj në të drejtat procedurale të kërkuessit, ashtu edhe për kërkesën për pezullimin e gjykimit administrativ deri në përfundimin e mosmarrëveshjes civile, ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë në aspektin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Për këtë arsye, në respektim të parimit të subsidiaritetit, vendimi i Gjykatës së Lartë duhej të shfuqizohej dhe çështja t'i kthehej asaj për rishqyrtim, me qëllim që këto pretendime të shqyrtoheshin dhe të merrnin përgjigje në përputhje me standardet kushtetuese të procesit të rregullt ligjor.

48. *Sipas qëndrimit tjetër*⁶, kërkuuesi ka ushtruar lirisht të drejtën e tij të rekursit në Gjykatën e Lartë, ku ka parashtruar pretendimet e tij për vendimin e gjykatës së apelit, shkaqe që rezultojnë të kenë gjetur pasqyrimin në pjesën hyrëse të vendimit të Kolegjit Administrativ. Për sa i përket vlerësimit të këtyre shkaqeve në dhomën e këshillimit, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se kjo është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Dhoma e këshillimit njihet edhe si faza seleksionuese për shqyrtimin e rekursit në lidhje me kushtet e pranueshmërisë, ku në mungesë të ekzistencës të të cilave Gjykata e Lartë disponon për mospranimin e tij, duke i dhënë kështu

⁵ Votuan për pranimin e këtij pretendimi gjyqtarët Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska dhe Marjana Semini.

⁶ Votuan për rrëzimin e këtij pretendimi gjyqtarët Sonila Bejtja, Sandër Beci dhe Genti Ibrahim.



fund shqyrtimit (*shih vendimet nr. 64, datë 1.10.2024; nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 26, datë 27.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

49. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, edhe pse me një arsyetim të kufizuar, ka vepruar në përputhje me rolin e tij dhe në ushtrim të funksionit si gjykatë ligji, si dhe në zbatim të dispozitave procedurale që rregullojnë atë formë gjykimi, duke vlerësuar se shkaqet e rekursit të parashtruara nga kërkuesi përpara asaj gjykate, qoftë në formë a në substancë, nuk janë të tilla që të bëjnë të cenueshëm procesin gjyqësor të zhvilluar në gjykatën e apelit, për rrjedhojë duke lënë në fuqi interpretimin dhe zbatimin e ligjit nga Gjykata Administrative e Apelit. Ky arsyetim nuk rezulton të jetë alogjik ose haptazi i paarsyeshëm, pra që të vërë në dyshim vetë thelbin e së drejtës për gjykim të drejtë. Duke vendosur mospranimin e rekursit për shkak se nuk përmbante shkaqe ligjore, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në thelb, i ka dhënë përgjigje kërkuesit për pabazueshmërinë e shkaqeve të ngritura në formë e substancë në recurs, duke marrë ai, në këtë mënyrë, përgjigje të arsyetuar për të gjitha pretendimet e tij të parashtruara përpara asaj gjykate. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë përmes parashtrimit të shkaqeve të parashtruara në recurs në vendimin gjyqësor të kundërshtuar tregon se i ka vlerësuar këto shkaqe, duke mos cenuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit dhe duke konfirmuar në thelb se interpretimi i ligjit nga gjykata e apelit ishte i drejtë. Vetëm fakti se Kolegji Administrativ ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomën e këshillimit nuk është i mjaftueshëm, në këndvështrimin kushtetues, për të vënë në dyshim të drejtën për proces të rregullt ligjor. Për këto arsye, sipas këtij qëndrimi, pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, si pasojë e mospranimit të rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit është i pabazuar ndaj kërkesa duhej të rrëzohej.

50. Për sa më sipër, në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh, ky pretendim, në kuptim të nenit 73, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, konsiderohet i rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja

“I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72, 73, pika 4, e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 23.6.2026.

Shpallur më 31.7.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sandër Beci, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahimi, Ilir Toska, Sonila Bejtja, Marjana Semini

VENDIM

Nr. 79, datë 30.6.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Ilir Toska,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar;
Genti Ibrahimi,	anëtar,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 30.6.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 14 (I) 2025 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Ilirian Cani, përfaqësuar nga avokati Elgert Rusi, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Agjencia e Trajtimit të Pronës, përfaqësuar nga avokati i shtetit Irma Qosja.

Avokatura e Shtetit, përfaqësuar nga avokati i shtetit Irma Qosja.

Arben Cani, Albana Theodhori (Cani), Enerita Vozga (Cani), Nadire Bacelli, Emin Shijaku, Merita Toska, Ismail Murthi, Fatlinda Struga, në mungesë.



OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 27, datë 13.2.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, nr. 00-2025-2165, datë 5.6.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë, me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, 18, 41, 42, 122, 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*), si dhe neni 1, i Protokollit nr. 1 të saj; ligji nr. 8577/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahim, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit Ilirian Cani (*kërkuari*), që ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit si përfaqësuese e Agjencisë së Trajtimit të Pronës (*ATP*), i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve me shkrim të subjekteve të interesuara Arben Cani, Albana Theodhori (Cani), Enerieta Vozga (Cani), Nadire Bacelli, Emin Shijaku, Merita Toska, Ismail Murthi, Fatlinda Struga, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuari është një nga trashëgimtarët ligjorë të subjekteve të shpronësuara, bashkëpronarëve S. S., M. S. dhe M. S., të cilët, me vendimin nr. 1278, datë 27.11.1996 (*vendimi nr.1278/1996*) të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*KKKP*), Tiranë, janë njohur pronarë të një trualli me sipërfaqe 130.000 m², të zënë pjesërisht nga Liqeni Artificial dhe Parku i Madh i Tiranës, si dhe janë kompensuar me një nga mënyrat që parashikon ligji.

2. Në pritje të ekzekutimit të këtij vendimi nga Agjencia e Trajtimit të Pronës (*ATP*), kërkuari i është drejtuar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e

Njeriut (*GJEDNJ*) me aplikimin nr. 510/15, datë 12.3.2015, duke pretenduar moszbatimin për një kohë të tejzgjatur të vendimit të formës së prerë nr. 1278/1996, të KKKP-së, e cila më pas është bashkuar me kërkesa të tjera të ngjashme drejtuar asaj gjykate në çështjen nr. 13618/10, datë 1.10.2020 *Gjergo dhe Babicenko kundër Shqipërisë dhe 76 kërkesa të tjera*.

3. Bazuar në parashikimet e ligjit nr. 133/2015, datë 5.12.2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” (*ligji nr.133/2015*), ATP-ja ka publikuar në Buletinin e njoftimeve zyrtare nr. 17, datë 10.4.2018, regjistrin e vendimeve elektronike të vlerësimeve financiare për vendimet e kompensimit të viteve 1993–1997, ndër to edhe pasurinë e trashëgimtarëve të tjerë, e pasqyruar me nr. rendor 214, e vlerësuar me 230 lekë/m² për një shumë totale prej 15.210.000 lekësh, sipas zërit kadastral “kullotë-livadh”.

4. Duke mos qenë dakord me vlerën e akorduar, kërkuari dhe trashëgimtarët e tjerë në datën 8.5.2018, i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesëpadi kundër ATP-së, me objekt ndryshimin e vendimit administrativ të publikuar në Buletinin e publikimeve zyrtare nr. 17, datë 10.4.2018, i cili ka bërë vlerësimin financiar të vendimit nr. 1278/1996, të KKKP-së, Tiranë, duke vlerësuar sipërfaqen e njohur për kompensim si tokë “kullotë-livadh” dhe jo sipas zërit kadastral “truall” që ka pasur në momentin e shpronësimit.

5. Në datën 8.5.2018, ndërkohë që çështja ishte në pritje të gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit, ATP-ja ka ripublikuar në Buletinin e publikimeve zyrtare nr. 30, datë 6.8.2018, vlerësimin financiar të vendimit nr. 1278/1996, të KKKP-së, duke përcaktuar të njëjtën vlerë financiare për pronën. Kërkuari i është drejtuar sërish Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesëpadi për kundërshtimin edhe të këtij publikimi dhe, në kushtet kur para gjykatës së apelit ishin ngritur dy padi me të njëjtat palë ndërgjyqëse e me të njëjtin objekt gjykimi, ajo gjykatë, me kërkesë të përfaqësuesit ligjor të palës paditëse (trashëgimtarët ligjorë ndër të cilët edhe kërkuari), ka vendosur bashkimin e padive në një të vetme.

6. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 27, datë 13.2.2019, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se sipas ligjit nr. 133/2015, VKM-së nr. 223, datë 23.3.2016,



“Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave” (VKM-ja nr. 223/2016) dhe VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë” (VKM-ja nr. 89/2016), të zbatueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, nuk ka vlerë për zërin “tokë bujqësore” në zonën kadastrale ku ndodhet prona e kërkuarit dhe e trashëgimtarëve të tjerë paditës dhe vlerësimi financiar i pronës së njohur për kompensim është bërë në zbatim të vlerës së pronës së përcaktuar për “kullotë – livadh”, sipas hartës së miratuar me VKM-në nr. 89/2016, referuar faktit se në origjinën e saj kjo pronë ka pasur këtë zë kadastral. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs kërkuar dhe trashëgimtarët e tjerë paditës, duke pretenduar, ndër të tjera, se Gjykata Administrative e Apelit nuk ka pasur juridiksion për gjykimin në themel të padisë, pasi çështja ishte marrë në shqyrtim nga GJEDNJ-ja, por ndërkohë mund të konstatonte pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ.

7. Në lidhje me kërkesën e drejtuar GJEDNJ-së (*shih paragrafin 2 të vendimit*), kjo e fundit, me vendimin e datës 1.10.2020, i ka deklaruar kërkesat të papranueshme, përfshirë edhe kërkesën e kërkuarit, me arsyetimin se mjeti juridik i prezantuar nga ligji për pronat i vitit 2015 është efektiv, brenda kuptimit të nenit 35, paragrafi 1 dhe neni 13 të KEDNJ-së, qëndrim ky i mbajtur prej saj edhe në çështjen *Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, ndaj nuk ka asnjë arsye për t’u larguar nga ky konstatim në kontekstin e çështjes në fjalë dhe konsideron se ankimi i kërkuarve, sipas nenit 13 të KEDNJ-së është qartazi i pabazuar e duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35, paragrafët 3 dhe 4, të KEDNJ-së. Gjithashtu, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se nuk ka asnjë rrethanë të jashtëzakonshme që mund të përjashtojë kërkuarët nga detyrimi për të shteruar mjetet e brendshme juridike (*shih Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë*).

8. Me vendimin nr. 00-2025-2165, datë 5.6.2025, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk i referohej asnjë prej shkaqeve të parashikuara nga neni 58, i ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

9. Ndërkohë që çështja ishte për gjykim në Gjykatën e Lartë, ATP-ja, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 77/2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në

ligjin nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” (*ligji nr. 77/2022*), ka kryer një rivlerësim të vendimit nr. 1278/1996, të KKKP-së, Tiranë, i cili është publikuar në Buletinin e publikimeve zyrtare nr. 12, datë 30.3.2023 (*publikimi i tretë*), duke e vlerësuar pronën financiarisht në shumën 384.059.000 lekë.

10. Duke mos qenë dakord me vlerësimin e dytë, kërkuar i është drejtuar sërish Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesëpadi me objekt anulimin/shfuqizimin e vlerësimit të dytë të ATP-së dhe detyrimin e këtij organi për të vlerësuar pronën si tokë “truall”.

11. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin e datës 30.9.2024, ka vendosur pezullimin e gjykimit deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes administrative objekt i vendimit nr. 27, datë 13.2.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit për të cilën ishte ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. Mbi rekursin e veçantë të kërkuarit dhe të trashëgimtarëve të tjerë paditës, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-2461, datë 19.6.2025, ka vendosur mospranimin e tij, pasi nuk i referohej asnjë prej shkaqeve të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012.

12. Në datën 7.10.2025, kërkuar i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 16.10.2025. Me vendimin e datës 13.1.2026, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

13. **Kërkuar**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara kanë cenuar:

13.1 *Të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të:*

13.1.1 *Së drejtës së ankimit efektiv*, pasi Gjykata Administrative e Apelit nëpërmjet vendimit të pezullimit i ka mohuar kërkuar dhe trashëgimtarëve të tjerë të drejtën për të kundërshtuar vlerësimin e dytë të publikuar në Buletinin e publikimeve zyrtare nr. 12, datë 30.3.2023.



13.1.2 *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi gjykata e apelit përmes vendimit të pezullimit ka shtyrë në mënyrë artificiale procesin e dytë gjyqësor.

13.1.3 *Parimin e sigurisë juridike*, pasi çështja e kërkuarit dhe e trashëgimtarëve të tjerë ligjorë ka qenë objekt shqyrtimi ndërkombëtar dhe GJEDNJ-ja, me vendimin nr. 13618/10, datë 1.10.2020, *Gjergo dhe Babichenko kundër Shqipërisë dhe 76 kërkesa të tjera*, ka konstatuar se praktikën e ndjekura nga shteti shqiptar kanë sjellë shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe të së drejtës së pronës. Gjykata e Lartë duhet të zbatonte në mënyrë të drejtpërdrejtë këtë vendimarrje të GJEDNJ-së dhe vendimet e tjera të saj. Po kështu, vendimi nr. 56937/10, datë 3.6.2021, *Ruci dhe Bejleri kundër Shqipërisë dhe 191 kërkesa të tjera*, ka vendosur standardin që shteti shqiptar duhet t'u garantojë ish-pronarëve të paktën 10% të pronës si truall ose një kompensim real që pasqyron vlerën e tregut. Këto vendime të GJEDNJ-së edhe pse janë të detyrueshme nuk janë marrë parasysh nga gjykatat në vendimarrjet e tyre.

13.1.4 *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk ka dhënë arsyetim bindës lidhur me konkluzionet në aktin e ekspertimit që e përcaktonin sipërfaqen prej 130.000 m² si tokë “truall” dhe vetëm pjesë të kufizuara të saj mund të kategorizoheshin ndryshe. Ndërkohë, vendimi përmbysës i procesit të parë gjyqësor nr. 00-2025-2165, datë 5.6.2025, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve, nuk ka arsyetuar mjaftueshëm për pretendimet thelbësore të kërkuarit.

13.2 *Të drejtën e pronës lidhur me parimin e proporcionalitetit*, pasi vendimi nr. 1278/1996, është burim fillestar dhe i padiskutueshëm i së drejtës së pronësisë së kërkuarit dhe të trashëgimtarëve të tjerë ligjorë. Mohimi i trajtimit të pronës si truall ka sjellë ulje drastike të vlerës së saj duke përbërë një kufizim arbitrar dhe të padrejtë të saj. Gjithashtu, edhe kompensimi i përcaktuar është në kundërshtim me standardin kushtetues dhe konventor, i cili kërkon që çdo kufizim i pronës të shoqërohet me një dëmshpërblim proporcional dhe të arsyeshëm.

14. **Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar:

14.1 Pretendimet për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* të lidhura me të drejtën e pronës dhe *parimin e proporcionalitetit* nuk qëndrojnë, pasi kanë të bëjnë me mënyrën e shqyrtimit dhe

vlerësimit të provave, si dhe me interpretimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme. Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar qartë dhe ka bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve, në analizë të hollësishme të kuadrit normativ të zbatueshëm, duke arsyetuar se vlerësimi financiar i pronës së njohur për kompensim kërkuarit dhe paditësve të tjerë është bërë sipas zërit kadastral “kullotë-livadh”, në zbatim të vlerës të përcaktuar për të me VKM-në nr. 89/2016. Qëndrimi i kësaj gjykate për masën/vlerën e kompensimit financiar është në përputhje me nenin 6.1, shkronja “a”, të ligjit nr.133/2015, VKM-në nr. 89/2016 dhe kreun 1, pika 3, të VKM-së nr. 233/2016, duke qenë se në vlerësimin e pronës ATP-ja i është referuar vlerës për “kullotë-livadh” në zonën më të afërt me zonën kadastrale ku ndodhet prona, pasi në vendndodhjen e saj (të pronës) mungon çmimi për tokën për këtë zë kadastral. Po kështu, vendimi i Gjykatës së Lartë ka plotësuar kriteret e vendosura nga jurisprudenca për arsyetimin e vendimit gjyqësor. Arsyetimi i Gjykatës Administrative të Apelit, i cili është gjetur i pacenueshëm nga Gjykata e Lartë, lidhur me shpërblimin e drejtë, nuk rezulton të jetë arbitrar.

14.2 Pretendimet për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* nuk qëndrojnë, pasi vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit për rrëzimin e padisë, lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë me mospranim rekursi, ka pasur si objekt ligjshmërinë e një akti konkret administrativ dhe jo rivlerësimin e së drejtës së pronës në kuptimin material. Ndërkohë, këto pretendime bien ndesh me faktin se vlerësimi i dytë i ATP-së përbën një akt administrativ të ri, i cili ka krijuar një situatë të re faktike dhe juridike që i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor dhe në këto kushte nuk mund të flitet për rihapje të një çështjeje të gjykuar përfundimisht, por për ushtrim të mekanizmave ligjorë të parashikuar për verifikimin e ligjshmërisë së akteve të reja administrative.

15. **Subjektet e interesuara**, Arben Cani, Albana Theodhori (Cani), Enerieta Vozga (Cani), Nadire Bacelli, Emin Shijaku, Merita Toska, Ismail Murthi dhe Fatlinda Struga, nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht nga Gjykata.



III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësit

16. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

17. Për sa i takon kriterit për legjitimitimin *ratione personae*, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “P”, të pikës 1, të nenit 131 dhe shkronjës “I”, të pikës 1, të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ka qenë palë ndërgjyqëse në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual dhe, për rrjedhojë, ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

18. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, i Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.6.2022; nr. 12, datë 9.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës së ankimit efektiv dhe të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, me argumentin se përmes vendimit të pezullimit të datës 30.9.2024, i cili ka sjellë si pasojë shtyrjen artificiale të procesit gjyqësor, Gjykata Administrative e Apelit i ka

mohuar të drejtën për të kundërshtuar vlerësimin e dytë të ATP-së të datës 30.3.2023. Lidhur me këtë kërkim, subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive për pretendimet që lidhen me vendimin e datës 30.9.2024, të Gjykatës Administrative të Apelit për pezullimin e gjykimit për vlerësimin e dytë dhe vendimin nr. 00-2025-2461, datë 19.6.2025, të Gjykatës së Lartë që ka vendosur mospranimin e rekursit ndaj këtij vendimi.

20. Në rastin në shqyrtim, në vlerësim të pretendimeve të kërkuësit dhe prapësimeve të subjektit të interesuar, Gjykata konstaton se këto pretendime kanë të bëjnë me vendimin gjyqësor të datës 30.9.2024, të Gjykatës Administrative të Apelit, i cili nuk është objekt i këtij gjykimi kushtetues, ndaj në këto rrethana çdo kërkim për këtë proces gjyqësor nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata, pasi kërkuesi ka mjete të tjera në dispozicion në lidhje me të.

21. Lidhur me pretendimet e tjera, Gjykata konstaton se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të dyja shkallët e gjykimit dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

22. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 5.6.2025, ndërkohë që ankimi kushtetues është paraqitur në datën 7.10.2025. Me informacionin e datës 4.12.2025, Gjykata e Lartë ka sqaruar se vendimi i kundërshtuar nga kërkuesi është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 14.7.2025, datë nga e cila është bërë i disponueshëm për palët. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor dhe kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*.

23. Për sa i përket legjitimitimit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, parimit të sigurisë juridike, si dhe të së drejtës së pronës të lidhur me parimin e proporcionalitetit, të garantuara respektivisht nga nenet 42, 41 dhe 17 të



Kushtetutës, të cilat në thelb lidhen me përmbushjen e pritshmërive të ligjshme të kërkuarit për një shpërblim të drejtë për pronën. Duke mbajtur në konsideratë se neni 41 i Kushtetutës parashikon se e drejta e pronës private është e garantuar (*pika 1*) dhe shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin lejohen vetëm përkundrajt një shpërblimi të drejtë (*pika 4*), ndërsa neni 42 garanton shprehimisht procesin e rregullt ligjor për të drejtën e pronës, duke u shprehur se prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë, Gjykata do t'i analizojë pretendimet në vijim në këndvështrim të parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, me pasoja në të drejtën e pronës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit

24. Kërkuari ka pretenduar se Gjykata e Lartë duhet të zbatonte në mënyrë të drejtpërdrejtë vendimet e detyrueshme nr.13618/10, datë 1.10.2020, *Gjergo dhe Babicenka kundër Shqipërisë dhe 76 kërkesa të tjera* dhe nr. 56937/10, datë 3.6.2021, *Ruci dhe Bejleri kundër Shqipërisë dhe 191 kërkesa të tjera* të GJEDNJ-së që kanë vendosur standardin që shteti shqiptar duhet t'iu garantojë ish-pronarëve të paktën 10% të pronës si truall ose një kompensim real që pasqyron vlerën e tregut. Sipas tij, këto vendime të GJEDNJ-së edhe pse janë të detyrueshme nuk janë marrë parasysh nga gjykatat në vendimmarrjet e tyre. Nga ana tjetër, po sipas tij, Gjykata Administrative e Apelit nuk ka dhënë arsyetim bindës lidhur me konkluzionet në aktin e ekspertimit, ndërsa Gjykata e Lartë, në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve, nuk ka arsyetuar mjaftueshëm për pretendimet thelbësore të tij. Vendimi nr. 1278/1996, i KKKP-së, Tiranë është burim fillestar dhe i padiskutueshëm i së drejtës së pronësisë dhe mohimi i trajtimit të pronës si “truall” ka sjellë ulje drastike të vlerës së saj, duke përbërë një kufizim arbitrar dhe të padrejtë të saj. Kompensimi i përcaktuar nga ATP-ja dhe gjykatat është në kundërshtim me standardin kushtetues dhe konventor, i cili kërkon që çdo kufizim i pronës të shoqërohet me një dëmshpërblim proporcional dhe të arsyeshëm.

25. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se Gjykata Administrative e Apelit ka bërë një cilësim të saktë të fakteve e veprimeve, në analizë të hollësishme të kuadrit normativ të zbatueshëm, duke arsyetuar se vlerësimi financiar i pronës së njohur për kompensim kërkuarit dhe paditësve të tjerë është bërë sipas zërit kadastral “kullotë-livadh”, në zbatim të vlerës të përcaktuar për të me VKM-në nr. 89/2016, ndërsa masa e vlerës së kompensimit financiar është në përputhje me nenin 6.1, shkronja “a”, të ligjit nr. 133/2015, VKM-në nr. 89/2016 dhe kreun 1, pika 3, të VKM-së nr. 233/2016. Po kështu, sipas subjektit të interesuar, vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit për rrëzimin e padisë, lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë me mospranim rekursi, ka pasur si objekt ligjshmërinë e një akti konkret administrativ dhe jo rivlerësimin e së drejtës së pronës në kuptimin material.

26. Gjykata thekson se siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin (*shih vendimet nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 50, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u përket të drejtave të fituara si element i parimit të sigurisë juridike, Gjykata është shprehur se çdo proces ku vihen në dyshim të drejtat e fituara nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të “procesit të rregullt”, përderisa diskutohet e vendoset lidhur me këto të drejta të fituara. Ky parim është i detyrueshëm të respektohet në të gjitha fazat e një procesi ku pretendohet cenimi i të drejtave të fituara, për rrjedhojë parimi i sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 11, datë 16.4.2018; nr. 10, datë 13.2.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. E drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkcioni i vendimit të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 17, datë 23.3.2023; nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 34, datë 13.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Arsyetimi i kufizuar i vendimeve të mospranimit të rekursit, si rregull, nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Megjithatë, kur në rekurs janë ngritur pretendime kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në parimin e



subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 11, datë 16.4.2018; nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Kriteret që parashikon neni 41 i Kushtetutës, që janë garantimi i pronës private dhe shpërblimi i drejtë, si dhe koncepti i përcaktuar nga KEDNJ-ja për gëzimin e pronës në mënyrë të qetë, janë orientimet bazë mbi të cilat duhet të zgjidhen të gjitha çështjet që lidhen me shpronësimet dhe kufizimet e pronës. Për sa i përket konceptit të shpërblimit të drejtë, Gjykata e ka interpretuar të lidhur me konceptet kushtetuese që kanë të bëjnë me interesin publik, si dhe respektimin e parimeve të drejtësisë, të proporcionalitetit dhe të shtetit social. Ajo ka vlerësuar se e drejta e pronës, në kuptimin që i jep neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, nuk mund të barazohet me kuptimin që ka në vetvete e drejta dhe se e drejta e pronës nuk njësohet me të drejtën e kthimit të saj. Referuar kriterit kushtetues të “shpërblimit të drejtë”, Gjykata ka theksuar se shpërblimi ose kompensimi në dobi të subjektit të shpronësuar nuk mund të jetë i plotë, por i drejtë (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 4, datë 15.2.2021; nr. 30, datë 1.12.2005, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Nisur nga çështja në shqyrtim, Gjykata vlerëson të evidentojë se ligji nr. 133/2015 dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij kanë qenë objekt shqyrtimi kushtetues. Më konkretisht, me vendimin nr. 1, datë 16.1.2017, në vlerësimin e Gjykatës skema e re e kompensimit ka ndryshuar metodën e vlerësimit, e cila, pavarësisht se mund të rezultojë në një masë më të ulët kompensimi për subjektet e shpronësuara, në tërësinë e saj respekton proporcionalitetin e ndërhyrjes në të drejtën e pronës dhe, si e tillë, është në respektim të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Ndërsa me vendimin nr. 4, datë 15.2.2021, objekt i të cilit kanë qenë sërish dispozitat e ligjit nr. 133/2015 dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, përfshirë edhe VKM-ja nr. 223/2016, duke mbajtur në konsideratë edhe qëndrimin e mbajtur nga GJEDNJ-ja në çështjen *Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, Gjykata ka vlerësuar se sistemi aktual i vlerësimit të pronës nuk respekton në të gjitha rastet prapagun minimal prej 10% të vlerësimit financiar dhe, për këtë arsye, është

një ndërhyrje joproporcionale në të drejtën e pronës private. Sipas Gjykatës, kufizimi i së drejtës së pronës private ishte rrjedhojë e mungesës së rregullimit nga pika 2, e nenit 7, të ligjit nr. 133/2015 të ndryshimit që ka pësuar zëri kadastral i pronës ndër vite, çka përbënte një boshllëk ligjor nga i cili vinin pasoja negative për të drejtat kushtetuese të individëve, të cilëve u mohohet kompensimi i drejtë.

30. Gjykata ka theksuar se zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të saj garantohet nga Kushtetuta, e cila në nenet 132 dhe 145 sanksionon shprehimisht këtë koncept kushtetues. Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës është i tillë që iu imponon të gjitha organeve shtetërore fuqinë detyruese të arsytimit të vendimit të saj (*shih vendimin nr. 17, datë 10.4.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Arsytimi që përdor Gjykata në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur (*shih vendimin nr. 78, datë 12.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se nga standardi i detyrueshmërisë së zbatimit të vendimmarrjes kushtetuese nuk mund të bëjë përjashtim as vetë Gjykata (*shih vendimet nr. 4, datë 15.2.2021; nr. 78, datë 12.12.2017; nr. 44, datë 29.6.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Po ashtu, Gjykata rithekson detyrimin e shtetit shqiptar për zbatimin e së drejtës ndërkombëtare mbështetur në nenin 5 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, vendimet e GJEDNJ-së janë të detyrueshme për t'u zbatuar, në përputhje me angazhimin që Republika e Shqipërisë, si shtet anëtar i Këshillit të Evropës, ka ndërmarrë sipas nenit 46, pika 1, të KEDNJ-së, që parashikon se palët e larta kontraktuese zotohen t'u binden vendimeve përfundimtare të GJEDNJ-së në mosmarrëveshjet në të cilat janë palë (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 20, datë 1.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme, Gjykata do të vlerësojë nëse Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme në përcaktimin e zërit kadastral të pronës dhe të vlerës së kompensimit financiar të saj, duke mbajtur në konsideratë respektimin e parimit të sigurisë juridike, si dhe nëse Gjykata e Lartë u ka kthyer përgjigje të arsyetuar pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs në përputhje me jurisprudencën kushtetuese dhe të GJEDNJ-së.



33. Duke iu rikthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuksi është një nga trashëgimtarët ligjorë të subjektit të shpronësuar, të cilit me vendimin nr. 1278/1996 të KKKP-së, Tiranë i është njohur pronësia mbi një sipërfaqe 130.000 m², si dhe e drejta për kompensim sipas ligjit. Ndërkohë që kërkuksi i ishte drejtuar GJEDNJ-së lidhur me moszbatimin e tejkzgjatur të vendimit të KKKP-së, Tiranë, ATP-ja ka publikuar vlerësimin e parë financiar të vendimit të KKKP-së në shumën 15.210.000 lekë. Kërkuksi, duke mos qenë dakord me këtë vlerësim, e ka kundërshtuar atë në gjykatën e apelit, por ndërkohë që çështja ishte në shqyrtim në atë gjykatë, ATP-ja ka publikuar rivlerësimin financiar të vendimit nr. 1278/1996 të KKKP-së, duke dhënë të njëjtën vlerë. Edhe ky rivlerësim është kundërshtuar nga kërkuksi në gjykatën e apelit dhe gjykata ka vendosur bashkimin e padive në një të vetme. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor gjykata e apelit ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se, në përputhje me kuadrin ligjor të zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes (ligji nr. 133/2015, VKM-ja nr. 223/2016 dhe VKM-ja nr. 89/2016), vlerësimi financiar i pronës së njohur për kompensim ishte bërë në zbatim të vlerës së pronës së përcaktuar për “kullotë–livadh”, sipas hartës së miratuar me VKM-në nr. 89/2016, referuar faktit se në kohën e shpronësimit kjo pronë ka qenë e zërit kadastral “kullotë–livadh” dhe jo “truall” (brenda vijave kufizuese të qytetit), sikurse ka pretenduar kërkuksi. Sipas asaj gjykate, metoda e vlerësimit ishte në përputhje me Kushtetutën dhe me vendimin nr. 1, datë 16.1.2017, të Gjykatës. Në datën 5.6.2025, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuksit.

34. Në kohën kur çështja ishte për gjykim në Gjykatën e Lartë, GJEDNJ-ja, me vendimin nr. 13618/10, datë 1.10.2020, *Gjergo dhe Babicenko kundër Shqipërisë dhe 76 kërkesa të tjera*, i ka deklaruar kërkesat të papranueshme, përfshirë edhe kërkesën e kërkuksit, me arsyetimin se mjeti juridik i prezantuar nga ligji për pronat i vitit 2015 ishte efektiv, për rrjedhojë aplikantët duhet të përdornin më parë mjetin juridik të brendshëm para se t'i drejtoheshin GJEDNJ-së. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 77/2022, ATP-ja ka kryer një vlerësim të dytë të vendimit nr. 1278/1996, në shumën 384.059.000 lekë, të cilin kërkuksi e ka kundërshtuar sërish në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, të cilat kanë vendosur

pezullimin e gjykimit deri në përfundimin e procesit gjyqësor të vlerësimit të parë.

35. Në përmbledhje të rrethanave të konstatuara, Gjykata vëren se kërkuksi në procesin ligjor të zhvilluar nga ATP-ja dhe në vijim në procesin gjyqësor të zhvilluar nga gjykatat, që kanë vendosur për vlerësimin/rivlerësimin e parë financiar të pronës, ka pritur që kompensimi i saj të bëhej sipas zërit kadastral të llojit “truall” në kohën e shpronësimit, të njohur edhe me vendimin nr. 1278/1996, të KKKP-së, Tiranë, ndërkohë që ATP-ja në vitin 2018 e ka vlerësuar pasurinë duke e kategorizuar atë në zërin kadastral “kullotë–livadh”. Gjykata Administrative e Apelit në vendimmarrjen e saj u referohet të dhënave arsyetuese të ATP-së, por pa marrë parasysh përcaktimin e zërit kadastral sipas vendimit nr. 1278/1996 të KKKP-së, Tiranë, ndërkohë që ka pretenduar që barrën e provës për përcaktimin e zërit kadastral të pronës e ka kërkuksi. Pavarësisht se gjatë gjykimit ka vlerësuar domosdoshmërinë e kryerjes të një akti ekspertimi teknik për përcaktimin e zërit kadastral në kohën e shpronësimit, nuk rezulton që gjykata e apelit t’u jetë referuar konkluzioneve të ekspertit, i cili ka konstatuar një paqartësi të dukshme të dokumentacionit shkresor e hartografik të viteve 1930-1945 lidhur me përcaktimin e zërit kadastral të pronës.

36. Nga ana tjetër, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë i është referuar vendimit nr. 1, datë 16.1.2017, të Gjykatës dhe vendimit të GJEDNJ-së për çështjen *Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, datë 31.7.2012, por nuk ka përmendur dhe analizuar vendimin nr. 4, datë 15.2.2021, të Gjykatës, që ka hyrë në fuqi në datën 12.9.2021 dhe vendimin e GJEDNJ-së për çështjen *Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, datë 17.3.2020, të njoftuar me shkrim në datën 7.5.2020. Këto dy vendimmarrje të fundit, të cilat janë marrë dhe kanë hyrë në fuqi përpara dhënies së vendimit nga Gjykata e Lartë, kanë sjellë ndryshime me rëndësi për të drejtën e pronës private, duke përcaktuar standardin minimal 10 % të vlerës aktuale të saj. Në këto kushte, Gjykata e Lartë, megjithëse ndodhej përpara pretendimeve me natyrë kushtetuese, në lidhje me të drejtën e pronës të kërkuksit për shpërblim të drejtë sipas zërit kadastral “truall” të përcaktuar me vendimin e formës së prerë nr. 1278/1996, të KKKP-së, Tiranë, në ushtrim të funksionit të saj dhe të parimit të subsidiaritetit, duhej të kishte mbajtur një qëndrim



të shprehur për pretendimet e ngritura në rekurs. Për më tepër, Gjykata vëren se në kuadër të qëndrimit të GJEDNJ-së në çështjen *Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë* e jurisprudencës kushtetuese (vendimit nr. 4/2021, të Gjykatës), në datën 30.3.2023, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 77/2022, ATP-ja në rastin në shqyrtim ka bërë rivlerësimin e pronës së kërkuarit, në një vlerë dukshëm të ndryshme nga ajo e përcaktuar në vlerësimin e parë, objekt i kontrollit kushtetues. Mospranimi nga kjo gjykatë i rekursit të kërkuarit, duke u mjaftuar vetëm me shqyrtimin *de plano* të çështjes dhe me arsyetimin e kufizuar se shkaqet e rekursit nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji, pa i dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimit me natyrë kushtetuese për të drejtën e pronës, si dhe mosrespektimi i fuqisë detyruese të jurisprudencës kushtetuese dhe asaj ndërkombëtare, ka vënë në dyshim respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore kushtetuese.

37. Në përmbledhje të rrethanave të konstatuara, në rastin e kërkuarit nuk është analizuar nëse vlerësimi i pronës ka respektuar standardin minimal “10% për diferencën në vlerësim midis zërit kadastral të sotëm dhe atij të kohës së shpronësimit”, në kuptim të neneve 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, pasi në përmbajtjen e vendimit të Gjykatës së Lartë nuk janë marrë në konsideratë vendimet detyruese të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së. Kjo situatë është rrjedhojë e disa faktorëve, duke filluar me mosveprimin e Kuvendit për plotësimin e detyrimit të caktuar me vendimin nr. 4, datë 15.2.2021, të kësaj Gjykate, me ekzistencën për një kohë të konsiderueshme të boshllëkut ligjor, me mosrespektimin e fuqisë detyruese të jurisprudencës kushtetuese dhe ndërkombëtare, për të përfunduar me arsyetimin e gjykatave, të cilat, në çdo rast, duhet të luajnë rolin e tyre subsidiar për respektimin e të drejtave themelore, pa u shmangur nga ky rol edhe në rastet e boshllëkut ligjor.

38. Në përmbledhje të argumenteve të mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin se në rastin në shqyrtim është cenuar parimi i sigurisë juridike i lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

39. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuarit është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-2165, datë 5.6.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 30.6.2026.

Shpallur më 31.7.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Ilir Toska

Anëtarë kundër: Sandër Beci, Genti Ibrahim, Asim Vokshi

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e çështjes që i përket kërkesës së kërkuarit Ilirian Cani, me objekt shfuqizimi i vendimeve nr. 27, datë 13.2.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit; 00-2025-2165, datë 5.6.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në gjyqtarët Sandër Beci, Genti Ibrahim dhe Asim Vokshi jemi kundër vendimit të shumicës për pranimin e kërkesës, për arsyet e mëposhtme.

2. Shumica vendosi shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim pranë asaj gjykate, pasi konstatoi se ajo gjykatë nuk kishte analizuar nëse vlerësimi i pronës ka respektuar standardin minimal “10% për diferencën në vlerësim midis zërit kadastral të sotëm dhe atij të kohës së shpronësimit”, në kuptim të neneve 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Po ashtu,



Gjykata e Lartë nuk ka marrë në konsideratë vendimet detyruese të Gjykatës dhe GJEDNJ-së, duke cenuar parimin e sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

3. Pakica, për sa i përket çështjes konkrete të shqyrtuar pranë gjykatave të zakonshme dhe veçanërisht fakteve e pretendimeve të ngritura nga kërkuesi në këtë ankim kushtetues, lidhur me rivlerësimin e ri substancial të kryer nga ATP-ja në vitin 2023 (pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 77/2022), vlerëson se jo çdo “gabim” procedural justifikon cenimin e vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme. Vetëm gabimet procedurale që pasjellin njëkohësisht dëmtimin serioz edhe të një të drejte substanciale kushtetuese mund të pasjellin cenimin e vendimmarrjes së atyre gjykatave.

4. Rasti në shqyrtim, për shkak të vlerësimit të ri të ATP-së në vitin 2023, i cili zhbënte vlerësimin e parë, nuk ka passjellë asnjë cenim substancial të interesave kushtetues të kërkuesit. Rezulton se në kohën kur Gjykata Administrative e Apelit ka dhënë vendimin e saj (2019), nuk ishte miratuar e nuk ishte në fuqi ligji nr. 77/2022, i cili implementoi në të drejtën e brendshme parimet e afirmuara nga GJEDNJ-ja dhe vendimet e Gjykatës në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 133/2015 dhe imponoi respektimin e standardit minimal 10% për dëmtshpërblim kur kishte ndryshim të zërit kadastral aktual në raport me atë të kohës së shpronësimit. Në kohën e gjykimit pranë Gjykatës Administrative të Apelit, kjo e fundit ka zbatuar me përpikëri dispozitat ligjore në fuqi, të cilat kërkonin që të përcaktohej sipas rregullave në fuqi “zëri kadastral” i pronave sot dhe në kohën e shpronësimit. Ajo gjykatë ka marrë prova të shumta, përfshirë edhe vendimin nr. 1278/1996, të ish-KKKP-së, si dhe harta të vjetra të Tiranës, për të arritur në përfundimin se, sipas rregullave ligjore në fuqi në kohën e shpronësimit, por edhe atyre që janë të detyrueshme për zbatim sot, zëri kadastral i tokës të vlerësohej si “kullotë-livadh”. Bëhet fjalë për një pronë që ndodhet brenda sipërfaqes së Parkut të Ligenit në Tiranë dhe që ka pasur natyrën e “kullotës-livadh” në periudhën pas vitit 1944 (koha e shpronësimit). Gjykata Administrative e Apelit i është referuar në vendimmarrjen e saj provave të depozituara nga palët dhe aktit të ekspertimit të marrë gjatë gjykimit dhe ka arsyetuar mjaftueshëm për konkluzionet në të cilat ka arritur. Meqë ka konstatuar se zëri kadastral i origjinës nuk ishte

truell, por mund të klasifikohet si “kullotë-livadh”, Gjykata Administrative e Apelit në atë kohë nuk kishte mundësi të njëjte të drejtën e paditësve për të përfituar 10% të vlerës që do të dilte sipas zërit kadastral aktual, pasi siç u përmend më sipër as Gjykata nuk kishte marrë ende vendimin nr. 4/2021 dhe as ligji nr. 77/2022 nuk ishte miratuar ende.

5. Gjykata e Lartë, nëse ATP-ja nuk do të kishte zbatuar vetë ligjin nr. 77/2022 e të bënte rivlerësim sipas zërit kadastral aktual (duke njohur një vlerë të re dhjetrafish më të lartë) për të nxjerrë vlerën 10%, do të duhej të kishte prishur vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit e ta kthente për rigjykim vetëm për këtë element ligjor, e jo për faktin e llojit të zërit kadastral të pronës në kohën e shpronësimit (që është provuar se nuk ishte truell). Mirëpo, duke qenë se kërkuesi i vuri në dispozicion gjykatës informacionin për vlerësimin e vitit 2023 të ATP-së, ku pozita e tyre financiare ishte përmirësuar ndjeshëm, pakica e sheh të panevojshëm cenimin e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë, pasi ajo vendimmarrje, ndonëse nuk e ka përmendur faktin e ekzistencës së vlerësimit të ri, dukshëm rezulton se nuk ka kontribuar në cenimin e së drejtës së kërkuesit në lidhje me standardin minimal prej 10%.

6. Për këtë arsye jemi të mendimit se nuk kishte vend për cenimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, pasi për sa i përket zërit kadastral të origjinës, Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar mjaftueshëm dhe bindshëm sipas kompetencës që i njeh ligji dhe përfundimet e saj e kalojnë testin e dhënies së vendimit nga një gjykatë e kujdesshme (*rrjedhimisht të pacenueshme, pasi Gjykata Kushtetuese nuk është shkallë e katërt e gjykimit*), ndërsa për sa i përket respektimit të standardit minimal prej 10%, ka rezultuar qartë se cenimi i sigurisë juridike në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit nga Gjykata e Lartë është mënjanuar, zbehur e relativizuar ndjeshëm për shkak të vlerësimit të ri të vitit 2023 të ATP-së, që ka rivendosur vetë në vend të drejtën, pa qenë e nevojshme ndërhyrja e gjykatave të zakonshme. Për rrjedhojë kthimi i kësaj çështjeje për rigjykim nuk duket se mund të ndikojë në mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të kërkuesit, ndaj jemi kundër vendimmarrjes së shumicës së Gjykatës.

Anëtarë: Sandër Beci, Genti Ibrahim, Asim Vokshi

**VENDIM****Nr. 197, datë 21.7.2026**

**MBI PEZULLIMIN E AFATIT TË
VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-
s, LIDHUR ME KËRKESËN E
SHOQËRISË “GREENSOL” SHPK PËR
PËRFSHIRJEN E VEPRAVE
NDIHMËSE/NJËSIVE TË
DEPOZITIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NË ANEKSIN A, TË
LICENCËS SË PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE, PA
NDRYSHUAR KAPACITETIN TOTAL TË
INSTALUAR TË CENTRALIT
FOTOVOLTAIK**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.7.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1662/12 prot., datë 16.7.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Greensol’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, konstatoi se:

- Shoqëria “Greensol” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1662 prot., datë 22.5.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, me vendndodhje në Njësinë Administrative Mesopotam, Bistricë, Bashkia Finiq, qarku Vlorë, me kapacitet të instaluar 49.96 mw.

- Në vijim të këtij aplikimi, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 158, datë 5.6.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 6.6.2026 dhe

8.6.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 6.7.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, po ashtu, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 1662/3 prot., datë 16.6.2026, ku i ka kërkuar të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe, në lidhje me vlefshmërinë e kontratës dhe të drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur ndonjë qëndrim.

- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1662/5 prot., datë 19.6.2026, shoqëria ka përditësuar projektin, duke përfshirë edhe veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

- Për sa më sipër, me vendimin nr. 179, datë 29.6.2026, Bordi i ERE-s vendosi të ndryshojë vendimin nr. 158/2026, duke pranuar për shqyrtim në këtë fazë dhe përfshirjen e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë vetëm për fuqinë 49.96 mw, të parashikuar dhe në VKM-në nr. 770, datë 19.12.2025 dhe në kontratën nr. 602 rep., nr. 164 kol., datë 10.2.2026, të nënshkruar me MIE-n, e reflektuar kjo dhe në konstatimet e vendimit.

- Për vendimin e sipërcituar, ERE botoi njoftimin në median e shkruar, në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s në datat 1.7.2026 dhe 2.7.2026.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1662/7 prot., datë 29.6.2026, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Me shkresën 4755/1 prot., datë 29.6.2026, protokolluar në ERE me nr. 1291/9 prot., datë 1.7.2026, MIE, ka bërë me dije, ndër të tjera: se referuar të drejtës për ndërtim të lëshuar nga MIE dhe parashikimeve të kontratës së nënshkruar ndërmjet palëve në vijim, çdo ndryshim në projekt, përfshirë modifikimet që lidhen me numrin e paneleve dhe shtimin e veprave ndihmëse apo njësive të depozitimit të energjisë elektrike, duhet të trajtohet në përputhje me kushtet kontraktuale dhe kuadrin rregullator në fuqi, duke sjellë në vëmendje të ERE-s për të mbajtur në konsideratë këtë qëndrim për të gjitha njoftimet e vendimeve të Bordit të ERE-s, lidhur me modifikimin e licencave



për shtimin e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike.

- Referuar qëndrimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të paraqitur me shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.6.2026, sipas të cilit ndryshimet e propozuara në projekt duhet të trajtohen në përputhje me të drejtën për ndërtim dhe kontratën e lidhur ndërmjet ministrisë dhe shoqërisë, si dhe duke qenë se ERE i është drejtuar shoqërisë, duke i kërkuar qëndrimin e MIE-s, në lidhje me shtimin e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike, vlerësohet se ky qëndrim përbën një element paraprak të nevojshëm për vlerësimin e plotë të ligjshmërisë së kërkesës për modifikimin e licencës. Për këtë arsye, vlerësohet pezullimi i afatit të vendimmarrjes së Bordit deri në marrjen e këtij sqarimi.

Pezullimi i vendimmarrjes

- Po ashtu, në nenin 14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, parashikohet se: Bordi i ERE-s, rast pas rasti, pas fillimit të procedurës, mund të vendosë të pezullojë vendimmarrjen e tij.

- Referuar qëndrimit të MIE-s, të paraqitur me shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.6.2026, në të cilin evidentohet se ndryshimet e propozuara nga shoqëria duhet të trajtohen në përputhje me të drejtën për ndërtim dhe me kontratën e lidhur ndërmjet ministrisë dhe subjektit, ERE vlerëson se, përpara marrjes së një vendimi përfundimtar mbi kërkesën për modifikimin e licencës, është e nevojshme të sqarohet sa më sipër me MIE për verifikimin e ekzistencës ose jo të një kërkesë ligjore apo kontraktore që mund të kushtëzojë realizimin e ndryshimeve të kërkuara nga licencuari.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pezullojë vendimmarrjen e Bordit të ERE-s për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Greensol” sh.p.k., për përfshirjen e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike në aneksin A, të licencës së prodhimit të energjisë elektrike, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit fotovoltaiik.

2. Pezullimi do të zgjasë deri në administrimin nga ERE të qëndrimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

3. Në përfundim të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, procedura administrative rifillon dhe afati i vendimmarrjes vijon të llogaritet për pjesën e mbetur.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Originës të njoftojë shoqërinë “Greensol” sh.p.k. dhe MIE-n për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Petra Lika

VENDIM Nr. 198, datë 21.7.2026

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE- s, LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË “ASSA ENERGY SOLUTIONS” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.7.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1641/16 prot., datë 16.7.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Originës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘ASSA Energy Solutions’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:



- Shoqëria “ASSA Energy Solutions” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1641 prot., datë 20.5.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaiik, me vendndodhje në Sheq Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier, me kapacitet të instaluar 10 mw.

- Në vijim të këtij aplikimi, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 159, datë 5.6.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 6.6.2026 dhe 8.6.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 6.7.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, po ashtu, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 1641/3 prot., datë 16.6.2026, ku i ka kërkuar të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe, në lidhje me vlefshmërinë e marrëveshjes dhe të drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur një përgjigje.

- Me shkresën nr. 1641/4 prot., datë 16.6.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar depozitimin e dokumentacionit/informacionit të munguar.

- Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1641/5 prot., datë 1.7.2026, shoqëria ka depozituar një pjesë të informacionit/dokumentacionit të munguar të aplikimit dhe ka kërkuar shtyrjen e afatit të plotësimit të dokumentacionit me 10 (dhjetë) ditë, duke bërë me dije se nuk ka qenë objektivist e mundur që të përgatitet dhe depozitohet në kohë.

- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, parashikohet se: Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.

- Për gjithë sa më sipër, vlerësohet pranimi i kërkesës së shoqërisë, me qëllim që t'i jepet

mundësia të plotësojë dokumentacionin e munguar. Duke marrë në konsideratë kohën e nevojshme për zhvillimin e korrespondencës dhe shqyrtimin e dokumentacionit, vlerësohet që afati i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “ASSA Energy Solutions” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaiik, me vendndodhje në Sheq Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier, me kapacitet të instaluar 10 mw. Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin e munguar brenda 10 (dhjetë) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “ASSA Energy Solutions” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 10 mw, me vendndodhje në Sheq Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Shoqëria të depozitojë dokumentacionin e munguar brenda 10 (dhjetë) ditëve.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “ASSA Energy Solutions” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT

Petra Lika

VENDIM

Nr. 199, datë 21.7.2026

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “BUSHTERICA 2017” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin,



njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.7.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 671/3 prot., datë 16.7.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Bushtrica 2017’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Bushtrica 2017” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2726 prot., datë 27.10.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Bushtrica 2”, me kapacitet të instaluar 4,800 kw, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushtricë, në qarkun e Elbasanit.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 283, datë 6.11.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 8.11.2025 dhe 10.11.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 9.12.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, po ashtu, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 2726/4 prot., datë 20.11.2025. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur ndonjë qëndrim, në lidhje me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë.

- Me shkresën nr. 2726/3 prot., datë 13.11.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar depozitimin e informacionit/dokumentacionit të aplikimit të konstatuar të paplotësuar ose të plotësuar pjesërisht.

- Pas korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë, në lidhje me plotësimin e informacionit/dokumentacionit të munguar, ka rezultuar se nuk është depozituar dokumentacioni, në lidhje me mbështetjen financiare, ndaj në mbështetje të kërkesës së shoqërisë për pezullimin e aplikimit, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 341, datë 23.12.2025, vendosi të pezullojë afatin e

vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “Bushtrica 2017” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Bushtrica 2”, me kapacitet të instaluar 4,800 kw, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushtricë, në qarkun e Elbasanit, deri në depozitimin e dokumentacionit të munguar.

- Ky vendim i është njoftuar shoqërisë nëpërmjet shkresës së ERE-s me nr. 2726/9 prot., datë 29.12.2025.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 671/2 prot., datë 29.6.2026, shoqëria ka depozituar dokumentacion, në lidhje me mbështetjen financiare, duke kërkuar rinisjen e procedurës së licencimit.

- Për sa depozituar nga shoqëria rezulton se plotësohet kushti për heqjen e pezullimit, por vlerësohet i nevojshëm një afat prej 30 ditësh për të vijuar korrespondencën me shoqërinë përpara se të merret vendimi përfundimtar, në lidhje me kërkesën e saj për licencim.

Heqja e pezullimit dhe zgjatja e vendimmarrjes

- Në nenin 14, pika 3, të rregullores parashikohet se: Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.

- Për gjithë sa më sipër, në zbatim të nenit 14, pika 3 e rregullores, vlerësohet që të hiqet pezullimi dhe të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Bushtrica 2017” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Bushtrica 2”, me kapacitet të instaluar 4,800 kw, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushtricë, në qarkun e Elbasanit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të heqë pezullimin e vendosur me vendimin e Bordit nr. 341 datë 23.12.2025, “Mbi pezullimin e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë ‘Bushtrica 2017’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”.

2. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “Bushtrica 2017” sh.p.k. për licencim në



veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Bushtrica 2”, me kapacitet të instaluar 4,800 kw, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushtricë, në qarkun e Elbasanit.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Bushtrica 2017” sh.p.k., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Petra Lika

VENDIM
Nr. 200, datë 21.7.2026

**MBI PEZULLIMIN E AFATIT TË
VENDIMARRJES SË BORDIT TË ERE-s,
LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË
“ERSEKA SOLAR PARK 1” SHPK PËR
MODIFIKIMIN E LICENCËS NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA
CENTRALI FOTOVOLTAIK ME
KAPACITET TË INSTALUAR 20 mw**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.7.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1082/20 prot., datë 16.7.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Erseka Solar Park 1’ sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 mw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Erseka Solar Park 1” sh.p.k., është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 176, datë 18.5.2023, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 mw.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1082 prot., datë 3.4.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për modifikim, për ndryshim në aneksin A të licencës së saj, duke shtuar në të dhe sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, prej 20 mw.

- Në vijim të këtij aplikimi, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 110, datë 21.4.2026, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure në datat 22.4.2026 dhe 23.4.2026. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresat nr. 1082/4 prot., datë 24.4.2026 dhe nr. 1082/9 prot., datë 1.6.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës dhe informacionin/dokumentacionin që duhet të plotësohet në këtë aplikim. Shoqëria ka kthyer përgjigje përkatësisht me shkresat nr. 1082/5 prot., datë 14.5.2026, nr. 1082/6 prot., datë 20.5.2026 dhe nr. 1082/10 prot., datë 8.6.2026.

- Për fillimin e kësaj procedure, ERE ka njoftuar dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 1082/3 prot., datë 24.4.2026. Nga ana e AKM-së dhe OST sh.a. nuk rezulton të ketë pasur ndonjë qëndrim në lidhje me këtë procedurë.

- Brenda afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga palët e treta, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1082/7 prot., datë 20.5.2026, janë paraqitur objeksione nga z. A. Q., ndaj me qëllim shqyrtimin e tyre dhe parashtrimet e depozituara nga shoqëria mbi këto objeksione, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 175, datë 22.6.2026, vendosi të zgjasë me 30 ditë afatin e vendimarrjes së Bordit mbi kërkesën e shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. për modifikimin e licencës.

- Në vijim, me shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.6.2026, protokolluar në ERE me nr. 1291/9 prot., datë 1.7.2026, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), ka bërë me dije, ndër të tjera se:



referuar të drejtës për ndërtim të lëshuar nga MIE dhe parashikimeve të kontratës së nënshkruar ndërmjet palëve në vijim, çdo ndryshim në projekt, përfshirë modifikimet që lidhen me numrin e paneleve dhe shtimin e veprave ndihmëse apo njërive të depozitimit të energjisë elektrike, duhet të trajtohet në përputhje me kushtet kontraktuale dhe kuadrin rregullator në fuqi, duke sjellë në vëmendje të ERE-s për të mbajtur në konsideratë këtë qëndrim për të gjitha njoftimet e vendimeve të Bordit të ERE-s, lidhur me modifikimin e licencave për shtimin e veprave ndihmëse/njërive të depozitimit të energjisë elektrike.

- Referuar qëndrimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të paraqitur me shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.6.2026, sipas të cilit ndryshimet e propozuara në projekt duhet të trajtohen në përputhje me të drejtën për ndërtim dhe kontratën e lidhur ndërmjet ministrisë dhe shoqërisë, si dhe duke qenë se ERE i është drejtuar shoqërisë, duke i kërkuar qëndrimin e MIE-s, në lidhje me shtimin e veprave ndihmëse/njërive të depozitimit të energjisë elektrike, vlerësohet se ky qëndrim përbën një element paraprak të nevojshëm për vlerësimin e plotë të ligjshmërisë së kërkesës për modifikimin e licencës. Për këtë arsye, vlerësohet pezullimi i afatit të vendimmarrjes së Bordit deri në marrjen e këtij sqarimi.

Pezullimi i vendimmarrjes

- Po ashtu, në nenin 14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, parashikohet se: Bordi i ERE-s, rast pas rasti, pas fillimit të procedurës, mund të vendosë të pezullojë vendimmarrjen e tij.

- Referuar qëndrimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të paraqitur me shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.6.2026, në të cilin evidentohet se ndryshimet e propozuara nga shoqëria duhet të trajtohen në përputhje me të drejtën për ndërtim dhe me kontratën e lidhur ndërmjet ministrisë dhe subjektit, ERE vlerëson se, përpara marrjes së një vendimi përfundimtar mbi kërkesën për modifikimin e licencës, është e nevojshme të sqarohet sa më sipër me MIE-n për verifikimin e ekzistencës ose jo të një kërkesë ligjore apo kontraktore që mund të kushtëzojë realizimin e ndryshimeve të kërkuara nga licencuari.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pezullojë vendimmarrjen e Bordit të ERE-s për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k., për modifikimin e licencës, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 176, datë 18.5.2023, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 20 mw, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

2. Pezullimi do të zgjasë deri në administrimin nga ERE të qëndrimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

3. Në përfundim të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, procedura administrative rifillon dhe afati i vendimmarrjes vijon të llogaritet për pjesën e mbetur.

Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancive të Origjinës të njoftojë shoqërinë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. dhe MIE-n për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Petraç Lika

VENDIM
Nr. 201, datë 21.7.2026

**MBI PEZULLIMIN E AFATIT TË
VENDIMARRJES SË BORDIT TË
ERE-s, LIDHUR ME KËRKESËN E
SHOQËRISË “ERSEKA SOLAR PARK 2”
SHPK PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS
NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA
CENTRALI FOTOVOLTAIK ME
KAPACITET TË INSTALUAR 20 mw**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit



14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.7.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1081/21 prot., datë 16.7.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Originës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Erseka Solar Park 2’ sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 20 mw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Erseka Solar Park 2” sh.p.k., është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 253, datë 23.8.2023, të ndryshuar, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 20 mw, me vendndodhje në Njësinë Administrative Qendër Ersekë, Bashkia Kolonjë, qarku Korçë.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1081 prot., datë 3.4.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për saktësim/modifikim të aneksit A të licencës së saj, duke shtuar në të dhe sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, prej 20 mw.

- Në vijim të këtij aplikimi, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 109, datë 21.4.2026, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë për prodhimin e energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure në datat 22.4.2026 dhe 23.4.2026. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresat nr. 1081/6 prot., datë 27.4.2026, dhe me nr. 1081/9 prot., datë 1.6.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës dhe informacionin/dokumentacionin që duhet të plotësohet për këtë aplikim. Shoqëria ka kthyer përgjigje përkatësisht me shkresat nr. 1081/7 prot., datë 14.5.2026, nr. 1081/8 prot., datë 20.5.2026 dhe nr. 1081/10 prot., datë 8.6.2026.

- Për fillimin e kësaj procedure, ERE ka njoftuar dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 1081/5 prot., datë 27.4.2026. Nga ana e AKM-së dhe OST sh.a. nuk rezultoi të ketë pasur ndonjë qëndrim në lidhje me këtë procedurë.

- Brenda afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga palët e treta, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1627 prot., datë 19.5.2026, janë paraqitur objeksione nga z. A. Q., ndaj, me qëllim shqyrtimin e tyre dhe të parashtrimeve të depozituara nga shoqëria mbi këto objeksione, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 176, datë 22.6.2026, vendosi të zgjasë me 30 ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit mbi kërkesën e shoqërisë “Erseka Solar Park 2” sh.p.k. për modifikimin e licencës.

- Në vijim, me shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.6.2026, protokolluar në ERE me nr. 1291/9 prot., datë 1.7.2026, MIE, ka bërë me dije, ndër të tjera, se: referuar të drejtës për ndërtim të lëshuar nga MIE dhe parashikimeve të kontratës së nënshkruar ndërmjet palëve në vijim, çdo ndryshim në projekt, përfshirë modifikimet që lidhen me numrin e paneleve dhe shtimin e veprave ndihmëse apo njërive të depozitimit të energjisë elektrike, duhet të trajtohet në përputhje me kushtet kontraktuale dhe kuadrin rregullator në fuqi, duke sjellë në vëmendje të ERE-s për të mbajtur në konsideratë këtë qëndrim për të gjitha njoftimet e vendimeve të Bordit të ERE-s, lidhur me modifikimin e licencave për shtimin e veprave ndihmëse/njërive të depozitimit të energjisë elektrike.

- Referuar qëndrimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të paraqitur me shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.6.2026, sipas të cilit ndryshimet e propozuara në projekt duhet të trajtohen në përputhje me të drejtën për ndërtim dhe kontratën e lidhur ndërmjet ministrisë dhe shoqërisë, si dhe duke qenë se ERE i është drejtuar shoqërisë, duke i kërkuar qëndrimin e MIE-s, në lidhje me shtimin e veprave ndihmëse/njërive të depozitimit të energjisë elektrike, vlerësohet se ky qëndrim përbën një element paraprak të nevojshëm për vlerësimin e plotë të ligjshmërisë së kërkesës për modifikimin e licencës. Për këtë arsye, vlerësohet pezullimi i afatit të vendimmarrjes së Bordit deri në marrjen e këtij sqarimi.



Pezullimi i vendimarrjes

- Po ashtu, në nenin 14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, parashikohet se: Bordi i ERE-s, rast pas rasti, pas fillimit të procedurës, mund të vendosë të pezullojë vendimarrjen e tij.

- Referuar qëndrimit të MIE-s, të paraqitur me shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.6.2026, në të cilin evidentohet se ndryshimet e propozuara nga shoqëria duhet të trajtohen në përputhje me të drejtën për ndërtim dhe me kontratën e lidhur ndërmjet ministrisë dhe subjektit, ERE vlerëson se, përpara marrjes së një vendimi përfundimtar mbi kërkesën për modifikimin e licencës, është e nevojshme të sqarohet sa më sipër me MIE-n për verifikimin e ekzistencës ose jo të një kërkesë ligjore apo kontraktore që mund të kushtëzojë realizimin e ndryshimeve të kërkuara nga licencuari.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të pezullojë vendimarrjen e Bordit të ERE-s për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Erseka Solar Park 2” sh.p.k., për modifikimin e licencës, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 253, datë 23.8.2023, të ndryshuar, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 20 mw, për shtimin e veprave ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

2. Pezullimi do të zgjasë deri në administrimin nga ERE të qëndrimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

3. Në përfundim të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, procedura administrative rifillon dhe afati i vendimarrjes vijon të llogaritet për pjesën e mbetur.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Erseka Solar Park 2” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Petra Lika

VENDIM
Nr. 202, datë 21.7.2026

**MBI PEZULLIMIN E AFATIT TË
VENDIMARRJES SË BORDIT TË ERE-s,
LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË
“GREENNAT SOLAR PARK BALLSH”
SHPK PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS
NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALI FOTOVOLTAIK ME
KAPACITET TË INSTALUAR 100 mw**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.7.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1291/12 prot., datë 16.7.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘GreeNNat Solar Park Ballsh’ sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 100 mw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k., është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 132, datë 2.7.2024, të ndryshuar, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 100 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 1090, Njësia Administrative Ballsh, Bashkia Mallakastër, qarku Fier, i ndryshuar.



- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1291 prot., datë 28.4.2026, shoqëria ka paraqitur aplikim për modifikimin e licencës, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike, në aneksin A të saj, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

- Nga shqyrtimi paraprak i dosjes rezultoi se shoqëria nuk kishte kryer pagesën e aplikimit, ndaj ERE, me *email*-in nr. 1291/1 prot., datë 5.5.2026, i kërkoi kryerjen e saj. Pas kryerjes së pagesës përkatëse, shoqëria, me *email*-in nr. 1291/2 prot., datë 18.5.2026, ka paraqitur disa saktësime/sqarime, në lidhje me aplikimin e saj, duke bërë me dije se kërkon të ndryshojë dhe numrin e paneleve, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 146, datë 28.5.2026, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë për prodhimin e energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 30.5.2026 dhe 1.6.2026). Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 1291/6 prot., datë 2.6.2026, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së saj, si dhe i ka bërë me dije, në lidhje me dokumentacionin/informacionin i cili ka ende nevojë për t'u plotësuar.

- Shoqëria, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1291/8 prot., datë 24.6.2026, dhe me nr. 1291/10 prot., datë 8.7.2026, ka depozituar dokumentacion plotësues.

- Gjithashtu ERE, me shkresën nr. 1291/7 prot., datë 2.6.2026, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. për fillimin e kësaj procedure. Nga ana e AKM-së dhe OST sh.a. nuk rezulton të ketë pasur ndonjë qëndrim në lidhje me këtë procedurë.

- Brenda afatit të pritjeve të komenteve, MIE, me shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.6.2026, protokolluar në ERE me nr. 1291/9 prot., datë 1.7.2026, ka bërë me dije, ndër të tjera, se: referuar të drejtës për ndërtim të lëshuar nga MIE dhe parashikimeve të kontratës së nënshkruar ndërmjet palëve në vijim, çdo ndryshim në projekt, përfshirë modifikimet që lidhen me numrin e paneleve dhe shtimin e veprave ndihmëse apo njërive të

depozitimit të energjisë elektrike, duhet të trajtohet në përputhje me kushtet kontraktuale dhe kuadrin rregullator në fuqi, duke sjellë në vëmendje të ERE-s për të mbajtur në konsideratë këtë qëndrim për të gjitha njoftimet e vendimeve të Bordit të ERE-s, lidhur me modifikimin e licencave për shtimin e veprave ndihmëse/njërive të depozitimit të energjisë elektrike.

- Referuar qëndrimin të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të paraqitur me shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.6.2026, sipas të cilit ndryshimet e propozuara në projekt duhet të trajtohen në përputhje me të drejtën për ndërtim dhe kontratën e lidhur ndërmjet ministrisë dhe shoqërisë, si dhe duke qenë se ERE i është drejtuar MIE-së për qëndrimin e saj nëse ndryshimi i numrit të paneleve dhe shtimi i veprave ndihmëse/njërive të depozitimit të energjisë elektrike kërkojnë një qëndrim ose miratim specifik të saj, vlerësohet se ky qëndrim përbën një element paraprak të nevojshëm për vlerësimin e plotë të ligjshmërisë së kërkesës për modifikimin e licencës. Për këtë arsye, vlerësohet pezullimi i afatit të vendimarrjes së Bordit deri në marrjen e këtij sqarimi.

Pezullimi i vendimarrjes

- Po ashtu, në nenin 14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, parashikohet se: Bordi i ERE-s, rast pas rasti, pas fillimit të procedurës, mund të vendosë të pezullojë vendimarrjen e tij.

- Referuar qëndrimin të MIE-s, të paraqitur me shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.6.2026, në të cilin evidentohet se ndryshimet e propozuara nga shoqëria duhet të trajtohen në përputhje me të drejtën për ndërtim dhe me kontratën e lidhur ndërmjet ministrisë dhe subjektit, ERE vlerëson se, përpara marrjes së një vendimi përfundimtar mbi kërkesën për modifikimin e licencës, është e nevojshme të sqarohet sa më sipër me MIE-n për verifikimin e ekzistencës ose jo të një kërkesë ligjore apo kontraktore që mund të kushtëzojë realizimin e ndryshimeve të kërkuara nga licencuari.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të pezullojë vendimmarrjen e Bordit të ERE-s për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k. për modifikimin e licencës, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 132, datë 2.7.2024, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 100 mw, duke ndryshuar numrin e paneleve dhe duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

2. Pezullimi do të zgjasë deri në administrimin nga ERE të qëndrimit së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

3. Në përfundim të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, procedura administrative rifillon dhe afati i vendimmarrjes vijon të llogaritet për pjesën e mbetur.

4. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Petra Lika

VENDIM
Nr. 203, datë 21.7.2026

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS
ADMINISTRATIVE PËR SHQYRTIMIN
E KËRKESËS SË SHOQËRISË “SPV
BLUE 2” SHPK PËR MODIFIKIMIN E
LICENCËS NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK ME KAPACITET
TË INSTALUAR 50 mw**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të neneve 10, pikat 1 dhe 3, dhe 15, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e

licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.7.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2037/2 prot., datë 17.7.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Originës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘SPV Blue 2’ sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 50 mw”,

konstatoi se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria “SPV Blue 2” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 296 datë 30.12.2024, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 50 mw.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2037/1 prot., datë 9.7.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për modifikimin e aneksit A të licencës së saj, duke shtuar në të sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse. Nga dokumentacioni i depozituar në kuadër të këtij aplikimi, rezulton se objekti i këtij aplikimi lidhet me modifikimin e aneksit A të licencës së prodhimit të energjisë elektrike, me qëllim pasqyrimin e rritjes së kapacitetit të instaluar të centralit nga 50 mw në 100 mw, si dhe shtimin e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2038/1 prot., datë 13.7.2026, shoqëria ka saktësuar objektin e kërkesës, duke kërkuar përfshirjen në aneksin A të licencës të sistemit të depozitimit të energjisë (BESS) me kapacitet të instaluar 200 mw, duke sqaruar se sistemi BESS synon të krijojë një mekanizëm fleksibiliteti që mundëson absorbimin e tepcave të prodhimit të parqeve fotovoltaiik të projekteve BLUE, me qëllim uljen e disbalancave të shkaktuara nga gjenerimi.

- Po ashtu, shoqëria ka depozituar në ERE, shkresën e saj të datës 30.6.2026, drejtuar Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), me anë të së cilës njofton mbi ndërtimin e sistemeve depozituese për një kapacitet 200 mw, duke



theksuar se instalimi i këtij sistemi nuk ndryshon kapacitetin maksimal të injehtimit në rrjet.

- Për sa kërkuar nga shoqëria në lidhje me veprat ndihmëse, sjellim në vëmendje se në shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.6.2026, protokolluar me tonën nr. 1291/8 prot., datë 1.7.2026, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka sjellë në vëmendje të ERE-s se: referuar të drejtës për ndërtim të lëshuar nga MIE dhe parashikimeve të kontratës së nënshkruar ndërmjet palëve në vijim, çdo ndryshim në projekt, përfshirë dhe shtimin e veprave ndihmëse apo njërive të depozitimit të energjisë elektrike, duhet të trajtohet në përputhje me kushtet kontraktuale dhe kuadrin rregullator në fuqi.

- Si e tillë, vlerësohet që për sa kërkuar nga shoqëria për të përfshirë në licencën e prodhimit dhe veprat ndihmëse, t'i kërkohej asaj qëndrimi/vlerësimi i MIE-s. Po ashtu, vetë ERE do të njoftojë MIE-n në kuadër të kësaj procedure.

- Rezulton se me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 499, datë 19.6.2026, "Për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike 'Blue 2', me kapacitet të instaluar 50 mw, i cili nuk përfiton nga masat mbështetëse dhe veprave ndihmëse në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive 'Blessed Investment' sh.p.k. dhe 'Matrix Konstruksion' sh.p.k.", është miratuar ndryshimi i kapacitetit të instaluar të centralit nga 50 mw në 100 mw. Duke qenë se kjo VKM ngarkon MIE-n dhe shoqërinë për ndjekjen e zbatimit të tij, si dhe në referencë të kontratës nr. 2721 rep., nr. 2067 kol., datë 9.7.2021, të nënshkruar më herët me MIE-n, vlerësohet se shoqëria duhet të bëjë me dije nëse ka vijuar me nënshkrimin e kontratës ku të jenë pasqyruar këto ndryshime.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën, sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores.

2. Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 15, pika 4 e rregullores, shoqëria ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për modifikimin e licencës sipas germave "c", "e", dhe "f".

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria duhet të plotësojë sa vijon:

Neni 15, "Modifikimi i licencës"

Pika 4"

- germa "a": Autorizimin përkatës për përfaqësuesin e saj, që ka nënshkruar shkresën e

protokolluar në ERE nr. 2038/1 prot., datë 13.7.2026;

- germa "b": Sqarimet përkatëse në lidhje me mënyrën e karikimit për kapacitetin e kërkuar prej saj, pasi nuk është e qartë nëse është vetëm për nevojat e vetë të licencuarit "SPV Blue 2" apo dhe të impianteve fotovoltaike të të licencuarve të tjerë, si dhe informacion shtesë mbi mënyrën se si parashikon financimin e këtyre ndryshimeve;

- germa "g": Miratimin përfundimtar/marrëveshjen e nënshkruar me Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., si dhe sqarimet përkatëse, në lidhje me kapacitetin për të cilin ka marrë opinion paraprak.

- Në lidhje me fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë sipas kërkesës së saj, vlerësohet që të njoftohet Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe OST sh.a.

- Nga analiza paraprake nuk rezultojnë rrethana që të pengojnë fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës, ndërsa vlerësimi mbi përmbushjen e të gjitha kushteve ligjore dhe rregullatore për licencim do të kryhet në përfundim të procedurës administrative, pas administrimit të dokumentacionit të plotë dhe analizës nga ERE.

- Për sa më sipër, vlerësohet se janë plotësuar kushtet procedurale për fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës për licencim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën administrative për modifikimin e licencës së shoqërisë "SPV Blue 2" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 296, datë 30.12.2024, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, për rritjen e kapacitetit të instaluar nga 50 mw në 100 mw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë "SPV Blue 2" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe shoqërinë "Operatori i Sistemit të Transmetimit" (OST) sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të



Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Petra Lika

VENDIM
Nr. 204, datë 21.7.2026

**MBI PEZULLIMIN E AFATIT TË
VENDIMMARRJES SË BORDIT TË
ERE-s, LIDHUR ME KËRKESËN E
SHOQËRISË “IDI 2005” SHPK PËR
MODIFIKIMIN E LICENCËS NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALI FOTOVOLTAIK ME
KAPACITET TË INSTALUAR 8.8 mw**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordin i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.7.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1899/6 prot., datë 16.7.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Originës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘IDI 2005’ sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 8.8 mw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 289, datë

13.11.2025, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 8.8 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1899 prot., datë 18.6.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për modifikimin e aneksit A të licencës së saj, duke shtuar në të dhe sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, prej 8.8 mw.

- Bordin i ERE-s, me vendimin nr. 178, datë 29.6.2026, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë për prodhimin e energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 1.7.2026 dhe 2.7.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 10.7.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 1899/3 prot., datë 6.7.2026, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., për fillimin e kësaj procedure. Nga ana e AKM-së dhe OSSH sh.a. nuk rezulton të ketë ndonjë qëndrim në lidhje me këtë procedurë.

- Me shkresën nr. 1899/4 prot., datë 6.7.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së saj, si dhe i ka bërë me dije, në lidhje me dokumentacionin/ informacionin i cili ka ende nevojë për t’u plotësuar.

- Rezulton se me shkresën 4755/1 prot., datë 29.6.2026, protokolluar në ERE me nr. 1291/9 prot., datë 1.7.2026, MIE ka bërë me dije, ndër të tjera se: referuar të drejtës për ndërtim të lëshuar nga MIE dhe parashikimeve të kontratës së nënshkruar ndërmjet palëve në vijim, çdo ndryshim në projekt, përfshirë modifikimet që lidhen me numrin e paneleve dhe shtimin e veprave ndihmëse apo njërive të depozitimit të energjisë elektrike, duhet të trajtohet në përputhje me kushtet kontraktuale dhe kuadrin rregullator në fuqi, duke sjellë në vëmendje të ERE-s për të mbajtur në konsideratë këtë qëndrim për të gjitha njoftimet e vendime të Bordit të ERE-s, lidhur me modifikimin e licencave për



shtimin e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike.

- Referuar qëndrimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të paraqitur me shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.6.2026, sipas të cilit ndryshimet e propozuara në projekt duhet të trajtohen në përputhje me të drejtën për ndërtim dhe kontratën e lidhur ndërmjet ministrisë dhe shoqërisë, si dhe duke qenë se ERE i është drejtuar shoqërisë, duke i kërkuar qëndrimin e MIE-s, në lidhje me shtimin e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike, vlerësohet se ky qëndrim përbën një element paraprak të nevojshëm për vlerësimin e plotë të ligjshmërisë së kërkesës për modifikimin e licencës. Për këtë arsye, vlerësohet pezullimi i afatit të vendimmarrjes së Bordit deri në marrjen e këtij sqarimi.

Pezullimi i vendimmarrjes

- Po ashtu, në nenin 14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, parashikohet se Bordi i ERE-s, rast pas rasti, pas fillimit të procedurës, mund të vendosë të pezullojë vendimmarrjen e tij.

- Referuar qëndrimit të MIE-s, të paraqitur me shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.6.2026, në të cilin evidentohet se ndryshimet e propozuara nga shoqëria duhet të trajtohen në përputhje me të drejtën për ndërtim dhe me kontratën e lidhur ndërmjet ministrisë dhe subjektit, ERE vlerëson se, përpara marrjes së një vendimi përfundimtar mbi kërkesën për modifikimin e licencës, është e nevojshme të sqarohet sa më sipër me MIE-n për verifikimin e ekzistencës ose jo të një kërkesë ligjore apo kontraktore që mund të kushtëzojë realizimin e ndryshimeve të kërkuara nga licencuari.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pezullojë vendimmarrjen e Bordit të ERE-s për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k., për modifikimin e licencës, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 289, datë 13.11.2025, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 8.8 mw, duke shtuar veprat ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike

në aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

2. Pezullimi do të zgjasë deri në administrimin nga ERE të qëndrimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

3. Në përfundim të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, procedura administrative rifillon dhe afati i vendimmarrjes vijon të llogaritet për pjesën e mbetur.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Petra Lika

VENDIM Nr. 205, datë 21.7.2026

MBI PEZULLIMIN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s, LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË “POWER ENERGY” SHPK PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 25 mw

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.7.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1608/7 prot., datë 16.7.2026, të Drejtorisë së Licencimit,



Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Power Energy’ sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 25 mw”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Power Energy” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 198, datë 15.8.2025, i ndryshuar, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 25 mw, me vendndodhje në fshatin Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1608 prot., datë 15.5.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për modifikimin e aneksit A të licencës së saj, duke shtuar në të dhe sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, prej 25 mw.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 148, datë 28.5.2026, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë për prodhimin e energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 30.5.2026 dhe 1.6.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 29.6.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 1608/4 prot., datë 3.6.2026, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., për fillimin e kësaj procedure. Nga ana e AKM-së dhe OST sh.a. nuk rezultoi të ketë ndonjë qëndrim në lidhje me këtë procedurë.

- Me shkresën nr. 1608/3 prot., datë 3.6.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së saj, si dhe i ka bërë me dije, në lidhje me dokumentacionin/ informacionin i cili ka ende nevojë për t’u plotësuar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1608/5 prot., datë 15.6.2026, shoqëria ka depozituar informacion/dokumentacion plotësues.

- Rezulton se me shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.6.2026, protokolluar në ERE me nr. 1291/9 prot., datë 1.7.2026, Ministria e Infrastrukturës dhe

Energjisë (MIE), ka bërë me dije, ndër të tjera, se: referuar të drejtës për ndërtim të lëshuar nga MIE dhe parashikimeve të kontratës së nënshkruar ndërmjet palëve në vijim, çdo ndryshim në projekt, përfshirë modifikimet që lidhen me numrin e paneleve dhe shtimin e veprave ndihmëse apo njërive të depozitimit të energjisë elektrike, duhet të trajtohet në përputhje me kushtet kontraktuale dhe kuadrin rregullator në fuqi, duke sjellë në vëmendje të ERE-s për të mbajtur në konsideratë këtë qëndrim për të gjitha njoftimet e vendimeve të Bordit të ERE-s, lidhur me modifikimin e licencave për shtimin e veprave ndihmëse/njërive të depozitimit të energjisë elektrike.

- Referuar qëndrimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të paraqitur me shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.6.2026, sipas të cilit ndryshimet e propozuara në projekt duhet të trajtohen në përputhje me të drejtën për ndërtim dhe kontratën e lidhur ndërmjet ministrisë dhe shoqërisë, si dhe duke qenë se ERE i është drejtuar shoqërisë, duke i kërkuar qëndrimin e MIE-s, në lidhje me shtimin e veprave ndihmëse/njërive të depozitimit të energjisë elektrike, vlerësohet se ky qëndrim përbën një element paraprak të nevojshëm për vlerësimin e plotë të ligjshmërisë së kërkesës për modifikimin e licencës. Për këtë arsye, vlerësohet pezullimi i afatit të vendimmarrjes së Bordit deri në marrjen e këtij sqarimi.

Pezullimi i vendimmarrjes

- Po ashtu, në nenin 14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, parashikohet se: Bordi i ERE-s, rast pas rasti, pas fillimit të procedurës, mund të vendosë të pezullojë vendimmarrjen e tij.

- Referuar qëndrimit të MIE-s, të paraqitur me shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.6.2026, në të cilin evidentohet se ndryshimet e propozuara nga shoqëria duhet të trajtohen në përputhje me të drejtën për ndërtim dhe me kontratën e lidhur ndërmjet ministrisë dhe subjektit, ERE vlerëson se, përpara marrjes së një vendimi përfundimtar mbi kërkesën për modifikimin e licencës, është e nevojshme të sqarohet sa më sipër me MIE-n për verifikimin e ekzistencës ose jo të një kërkesë ligjore apo kontraktore që mund të kushtëzojë realizimin e ndryshimeve të kërkuara nga licencuari.



Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pezullojë vendimarrjen e Bordit të ERE-s për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Power Energy” sh.p.k., për modifikimin e licencës, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 198, datë 15.8.2025, të ndryshuar, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 25 mw, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

2. Pezullimi do të zgjasë deri në administrimin nga ERE të qëndrimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

3. Në përfundim të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, procedura administrative rifillon dhe afati i vendimarrjes vijon të llogaritet për pjesën e mbetur.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Power Energy” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Petraq Lika

VENDIM
Nr. 206, datë 21.7.2026

**MBI PEZULLIMIN E AFATIT TË
VENDIMARRJES SË BORDIT TË ERE-s,
LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË
“SUNNY SIDE ENERGY” SHPK PËR
MODIFIKIMIN E LICENCËS NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALI FOTOVOLTAIK ME
KAPACITET TË INSTALUAR 100 mw**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit

14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.7.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1611/8 prot., datë 16.7.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Sunny Side Energy’ sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 100 mw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Sunny Side Energy” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 13, datë 16.1.2025, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 100 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 1451, fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, i ndryshuar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1611 prot., datë 15.5.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për modifikimin e aneksit A të licencës së saj, duke shtuar në të dhe sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, prej 100 Mw.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 145, datë 28.5.2026, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë për prodhimin e energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 30.5.2026 dhe 1.6.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 29.6.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 1611/3 prot., datë 3.6.2026, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., për fillimin e kësaj procedure. Nga ana e AKM-së dhe OST sh.a. nuk



rezulton të ketë ndonjë qëndrim në lidhje me këtë procedurë.

- Me shkresën nr. 1611/4 prot., datë 3.6.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së saj, si dhe i ka bërë me dije në lidhje me dokumentacionin/informacionin që duhet të plotësohet.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1611/5 prot., datë 15.6.2026, shoqëria ka depozituar dokumentacion/informacion plotësues.

- Në vijim, me shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.6.2026, protokolluar në ERE me nr. 1291/9 prot., datë 1.7.2026, MIE, ka bërë me dije, ndër të tjera, se: referuar të drejtës për ndërtim të lëshuar nga MIE dhe parashikimeve të kontratës së nënshkruar ndërmjet palëve në vijim, çdo ndryshim në projekt, përfshirë modifikimet që lidhen me numrin e paneleve dhe shtimin e veprave ndihmëse apo njërive të depozitimit të energjisë elektrike, duhet të trajtohet në përputhje me kushtet kontraktuale dhe kuadrin rregullator në fuqi, duke sjellë në vëmendje të ERE-s për të mbajtur në konsideratë këtë qëndrim për të gjitha njoftimet e vendimeve të Bordit të ERE-s, lidhur me modifikimin e licencave për shtimin e veprave ndihmëse/njërive të depozitimit të energjisë elektrike.

- Referuar qëndrimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të paraqitur me shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.6.2026, sipas të cilit ndryshimet e propozuara në projekt duhet të trajtohen në përputhje me të drejtën për ndërtim dhe kontratën e lidhur ndërmjet ministrisë dhe shoqërisë, si dhe duke qenë se ERE i është drejtuar shoqërisë, duke i kërkuar qëndrimin e MIE-s, në lidhje me shtimin e veprave ndihmëse/njërive të depozitimit të energjisë elektrike, vlerësohet se ky qëndrim përbën një element paraprak të nevojshëm për vlerësimin e plotë të ligjshmërisë së kërkesës për modifikimin e licencës. Për këtë arsye, vlerësohet pezullimi i afatit të vendimarrjes së bordit deri në marrjen e këtij sqarimi.

Pezullimi i vendimarrjes

- Po ashtu, në nenin 14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, parashikohet se Bordi i ERE-s, rast pas rasti, pas fillimit të procedurës, mund të vendosë të pezullojë vendimarrjen e tij.

- Referuar qëndrimit të MIE-s, të paraqitur me shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.6.2026, në të cilin evidentohet se ndryshimet e propozuara nga shoqëria duhet të trajtohen në përputhje me të drejtën për ndërtim dhe me kontratën e lidhur ndërmjet ministrisë dhe subjektit, ERE vlerëson se, përpara marrjes së një vendimi përfundimtar mbi kërkesën për modifikimin e licencës, është e nevojshme të sqarohet sa më sipër me MIE-n për verifikimin e ekzistencës ose jo të një kërkesë ligjore apo kontraktore që mund të kushtëzojë realizimin e ndryshimeve të kërkuara nga licencuari.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pezullojë vendimarrjen e Bordit të ERE-s për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k., dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 13, datë 16.1.2025, për prodhimin e energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 100 mw, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

2. Pezullimi do të zgjasë deri në administrimin nga ERE të qëndrimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

3. Në përfundim të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, procedura administrative rihet dhe afati i vendimarrjes vijon të llogaritet për pjesën e mbetur.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Originës të njoftojë shoqërinë “Sunny Side Energy” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Petra Lika

**VENDIM****Nr. 207, datë 21.7.2026****MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË “DIEZELA” SHPK**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të neneve 5, 7, 9, pika 4 dhe 5, dhe nenit 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.7.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1799/3 prot., datë 16.7.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancive të Origjinës, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Diezela’ sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e të licencuarit”,

konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë “Diezela” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria “Diezela” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 16, datë 23.1.2020, i ndryshuar, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ljusa” me kapacitet të instaluar 1.98 Mw, me vendndodhje në Përroin e Zallit të Madh, degë e përroit të Lusës, Bashkia Mat, qarku Dibër.

- Me shkresën nr. 1799 prot., datë 5.6.2026 shoqëria ka depozituar kërkesën dhe dokumentacionin për marrjen e autorizimit të ERE-s për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e të licencuarit, specifikisht nga z. K. M. (me 100% të

kapitalit) tek z. L. M. (55% të kapitalit), i cili bëhet ortak kryesor i saj dhe z. C. Q. (45% të kapitalit).

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- ERE, me shkresën nr. 1799/1 port., datë 18.6.2026 i ka kërkuar shoqërisë të përcjellë dokumentacionin/informacionin e pa plotësuar për këtë aplikim.

- Shoqëria, me shkresën nr. 1799/2 prot., datë 2.7.2026, depozitoi sa kërkuar.

3. Përfundime dhe kërkesa të tjera për dhënien e autorizimit

- Nga analiza përfundimtare e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “Diezela” sh.p.k., rezulton se është dorëzuar dokumentacioni, në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 5 dhe 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2022, si vijon:

- Neni 5, pika 2 – Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese janë nënshkruar nga administratori i shoqërisë.

Plotësimi i kërkesave të nenit 5:

- Neni 5, pika 4 – Dokumentacioni është paraqitur në gjuhën shqipe, në format origjinal ose të noterizuar dhe i shoqëruar me kopje elektronike.

- Neni 5, pika 5 – Shoqëria ka bërë me dije se kërkon që të mos jenë të hapura për publikun dokumentet si vijon: kontrata e huas më datë 15.12.2025, deklarata noteriale e z. K. M., deklarata noteriale të z. L. M. dhe z. C. Q., të dhëna financiare mbi ortakët, vërtetim i gjendjes gjyqësore për z. L. M. dhe z. C. Q., si dhe përveç tyre kërkohet të mos jenë të hapura për publikun dhe çdo dokument tjetër që ka natyrë sensitive.

Pavarësisht kërkesës së shoqërisë, ERE në zbatim të “Rregullores për mbrojtjen e informacionit konfidencial”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 65, datë 26.3.2018, ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” si dhe ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ka kryer shqyrtimin e dokumentacionit për të identifikuar konkretisht dokumentacionin apo



pjesë të dokumentacionit i cili trajtohet konform ligjit dhe akteve nën ligjore sa më lart referuar.

Nga analizimi i dokumentacionit të depozituar, do të trajtohet si konfidencial, si vijon:

- Shkresat e shoqërisë “Diezela” sh.p.k., të datave 5.6.2026 dhe 2.7.2026, me lëndë “Kërkesë për dhënien e autorizimit për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e të licencuarit” dhe “Dërgohet informacion plotësues në vijim të aplikimit për ndryshim ortaku të shoqërisë” (këto dokumente do të konsiderohen si konfidenciale, duke qenë se përmbajnë të dhëna personale të administratorit të shoqërisë, si dhe informacione të aktivitetit tregtar të vetë shoqërisë);

- “Kontratë huaje e zakonshme” me nr. 7426 rep., nr. 2685 kol., datë 15.12.2025 (ky dokument do të konsiderohet si konfidencial për arsye se përmban të dhëna me natyrë ekonomike/kontraktuale që mund të dëmtojnë interesat e subjektit/palëve të treta nëse publikohen si dhe informacione të aktivitetit tregtar të shoqërisë)

- Vërtetim i gjendjes gjyqësore për ortakët z. Qato dhe z. Mavriqi (këto dokumente do të konsiderohen si konfidencial, duke qenë se përmbajnë të dhëna identifikuese të tilla si emër, mbiemër, atësinë, datëlindjen, vendlindje dhe nr. personal).

Nga ana tjetër, do të konsiderohet dhe trajtohet si jokonfidencial, për arsye se janë dokumente të aksesueshme pranë institucioneve publike kompetente, dokumentacioni si vijon:

- Ekstrakti i thjeshtë/historik i regjistrit tregtar të shoqërisë “Diezela” sh.p.k.;

- Ekstrakti i thjeshtë/historik i regjistrit tregtar të shoqërisë “Brianza Dent” sh.p.k.;

- Ekstrakti i thjeshtë/historik i regjistrit tregtar të shoqërisë “Vokopola Energji” sh.p.k.;

- Ekstrakti i thjeshtë/historik i regjistrit tregtar të shoqërisë “Geri-01” sh.p.k.;

- Ekstrakti i regjistrit tregtar i subjektit “Luan Mavriqi” person fizik;

(Ekstraktet e regjistrit tregtar të shoqërive e subjekteve të sipërcituara, do të konsiderohen si jokonfidenciale, në rrethanat që janë të publikuara dhe të aksesueshme pranë institucioneve publike kompetente, në rastin konkret QKB);

- Pasqyrat financiare të viteve 24–25 të shoqërisë “Brianza Dent” sh.p.k.;

- Pasqyrat financiare të viteve 24–25 të shoqërisë “Vokopola Energji” sh.p.k.;

- Pasqyrat financiare të viteve 24–25 të shoqërisë “Geri-01” shpk;

- Pasqyrat financiare të viteve 24–25 të subjektit “Luan Mavriqi” person fizik;

(Pasqyrat financiare të shoqërive e subjekteve të sipërcituara, do të konsiderohen si jokonfidenciale, në rrethanat që janë të publikuara dhe të aksesueshme pranë institucioneve publike kompetente, në rastin konkret QKB);

- “Kontratën për transferimin e pronësisë së kuotave” me nr. 2957 rep, nr. 1289 kol., datë 11.5.2026 (ky dokument do të konsiderohet jokonfidencial, në rrethanat që është i publikuar dhe i aksesueshëm pranë institucioneve publike kompetente, në rastin konkret QKB).

- Vendimi i ortakut të vetëm të shoqërisë “Diezela” sh.p.k., datë 11.5.2026 (ky dokument do të konsiderohet jokonfidencial, pasi konsiderohet si një akt me karakter deklarativ, që lidhet me organizimin dhe vendimmarrjen e shoqërisë dhe janë dokumente që depozitohen pranë QKB-së).

- Deklarata noteriale e z. Kujtim Mersinaj nr. rep. 554, kol. 214 dhe deklarata noteriale të z. L. M. dhe z. C. Q., me nr. rep. 3206, kol. 1392, datë 18.5.2026 (këto dokumente përbëjnë akte të brendshme deklarative, që lidhen me organizimin dhe vendimmarrjen e shoqërisë. Ato nuk përmbajnë në vetvete sekret tregtar apo informacion financiar të ndjeshëm, ndaj konsiderohen dokumente me natyrë jokonfidenciale, por me redaktim selektiv të elementeve që kanë të dhëna financiare dhe personale).

- Shkresa e MIE-s nr. 4603/1 prot., datë 4.6.2026, me lëndë: “Miratohet transferimi i kuotave të kapitalit të mbajtësit të miratimit” (ky dokument do të konsiderohet si jokonfidencial, duke qenë se nuk përmban të dhëna personale apo të aktivitetit tregtar që mund të dëmtojnë shoqërinë në rast publikimi).

4. Plotësimi i kërkesës sipas nenit 7:

- Pika 1 – Janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi shoqërinë, përfaqësuesin e autorizuar, arsyet mbi ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit dhe ndikimin e transferimit në ushtrimin e aktivitetit të licencuar, një përshkrim të kandidatit të propozuar, informacion mbi kontributin financiar që do të japë;

- Pika 2 – Janë dorëzuar të gjitha dokumentet përkatëse, përfshirë ekstraktin historik të regjistrit



tregtar, vendimet e organeve drejtuese, marrëveshjen përkatëse dhe dokumentacionin tjetër shtetëror si më poshtë vijon:

- germa “a” – Ekstrakti historik i regjistrit tregtar;
- germa “c” – Vendimi i organeve drejtuese: është depozituar vendimi i Asamblesë së Ortakut të Vetëm të shoqërisë “Diezela” sh.p.k., datë 11.5.2026, nëpërmjet të cilit është miratuar transferimi i kuotës;

- germa “d” – Marrëveshjet paraprake përkatëse:
 - “Kontratë për transferimin e pronësisë së kuotave” me nr. 2957 rep., nr. 1289 kol., datë 11.5.2026, nënshkruar midis palëve, me anë të së cilës është dakordësuar transferimi i kuotave nga z. K. M. tek ortakët z. L. M. (55% të kapitalit) dhe z. C. Q. (45% të kapitalit).

- Pika 3 – Shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj ERE-s.

5. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Diezela” sh.p.k., nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratimet e nevojshme nga palë të treta, në rast se kërkohet prej tyre.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor që kontrollon interesat e shoqërisë “Diezela” sh.p.k., sipas strukturës së kërkuar, nga z. K. M. (me 100% të kuotave të kapitalit), tek z. L. M. (me 55% të kuotave të kapitalit) dhe z. C. Q. (me 45% të kuotave të kapitalit), ku z. L. M. bëhet ortaku kryesor që kontrollon interesat e shoqërisë “Diezela” shpk (sipas kontratës për transferimin e pronësisë së kuotave, datë 11.5.2026).

2. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Diezela” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në rast të depozitimit të dokumentacionit të ndryshëm nga ai që i ka shërbyer kësaj vendimmarrje.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancive të Origjinës të njoftojë shoqërinë “Diezela” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT

Petra Lika

VENDIM

Nr. 208, datë 24.7.2026

**MBI MIRATIMIN E DISA SHITESAVE
DHE NDRYSHIMEVE NË KONTRATËN
“PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË
ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË
SË PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, TË NGARKUAR ME
DETYRIMIN E SHËRBIMIT PUBLIK,
AKSIONET E SË CILËS
KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE
PJESËRISHT NGA SHTETI (KESH SHA),
DHE FURNIZUESI I SHËRBIMIT
UNIVERSAL (FSHU) SHA, PËR
FURNIZIMIN E KLIENTËVE QË
FURNIZOHEN NGA FSHU SHA”**

Në zbatim të neneve 16, 20, germa “h”, 49, 61 germa “f”, 70, 135 pika 4 dhe 136 pika 2, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; pjesës I, nenit 5, pika 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-



s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.7.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2202 prot., datë 22.7.2026, “Mbi disa shtesa dhe ndryshime në kontratën tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, KESH sh.a., dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a.”,

konstatoi se:

- Bordin i ERE-s, me vendimin nr. 95, datë 20.5.2024, ka miratuar kontratën tip “Për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti (KESH sh.a.) dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a.”, e ndryshuar me vendimin nr. 133, datë 7.7.2025.

1. Kërkesa për rishikimin e kontratës tip

- ERE, me shkresën nr. 1886 prot., datë 16.6.2026, ka kërkuar informacion mbi lidhjen dhe ecurinë e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. për periudhën 1.1.2026–31.12.2026.

- Me shkresën e përbashkët nr. 3016 prot., datë 1.7.2026, të KESH sh.a. dhe nr. 4280/2 prot., datë 1.7.2026, të FSHU sh.a., protokolluar në ERE me nr. 1886/1 prot., datë 6.7.2026, palët kanë depozituar për miratim kontratën e nënshkruar për shitblerjen e energjisë elektrike për vitin 2026.

- Palët kanë propozuar disa shtesa dhe ndryshime në kontratën tip të miratuar me vendimin nr. 95, datë 20.5.2024, të ndryshuar me vendimin nr. 133, datë 7.7.2025.

2. Përmbajtja e ndryshimeve të propozuara

Riformulime dhe saktësime në tekst

- Në nenin 9, pika 2, germa “b”, propozohet që pagesa e faturave sistemuese të lidhet me datën e lëshimit të faturës dhe jo me datën e livrimit të energjisë elektrike. Konkretisht në fund të saj të shënohet: “Pagesa e faturave sistemuese mes palëve do të bëhet brenda 45 ditëve nga dita e lëshimit të faturës”.

- Në nenin 14, pika 1, saktësohet se fatura përkatëse do të lëshohet jo më vonë se data 10 e

muajit pasardhës të livrimit të energjisë elektrike. Konkretisht “faturimi dhe pagesa” propozohet të saktësohet: “Fatura përkatëse do të lëshohet jo më vonë se data 10 e muajit pasardhës të livrimit të energjisë elektrike”.

- Në nenin 14, pika 2, unifikohet afati i pagesës prej 45 ditësh nga data e lëshimit të faturës tatimore, si për faturat kryesore ashtu edhe për faturat sistemuese. Konkretisht paragrafi ndryshon dhe bëhet: “Pagesa e faturave do të bëhet brenda 45 ditëve nga data e lëshimit të faturës tatimore. Afati i pagesës së faturave sistemuese do të jetë i njëjtë me faturën për të cilën bëhet sistemimi.”.

Shtesa në kontratë

- Në nenin 3 “Përkufizime”, është propozuar shtimi i pikës 16.1 “data e maturimit të faturës” me përmbajtje: është data e fundit e periudhës së pagesës së faturës.

- Në nenin 14 është propozuar shtimi i pikës 3, të parë të “pagesës”, palët kanë dakordësuar të shtojnë pikën 3 me përcaktimet si më poshtë:

“Ndryshimi i datës së maturimit të faturës: Për raste të veçanta, me kërkesë zyrtare të arsyetuar të blerësit, paraqitur jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune përpara datës së maturimit të faturës përkatëse, shitësi mund të bie dakord për ndryshimin e datës së maturimit të asaj fature. Kërkesa dhe miratimi i shtyrjes së afatit të pagesës së faturës do të bëhet sipas formularit të aneksit 3 të kësaj kontrate. Me miratimin e kërkesës, palët përcaktojnë datën e re të maturimit.

Ndryshimi i datës së maturimit konsiderohet si data e detyrimit të pagesës për faturën përkatëse dhe deri në këtë datë, pagesa nuk konsiderohet e vonuar.

Pas skadimit të afatit të ri të maturimit, çdo pagesë e papaguar konsiderohet e vonuar dhe i nënshtrohet automatikisht interesave të vonës dhe mjeteve ligjore të parashikuara në këtë kontratë dhe legjislacionin në fuqi.

Palët justifikojnë vendosjen e kësaj dispozite të re me argumentin se: Ky parashikim është bërë për raste të veçanta në kushtet e vështirësive të mundshme financiare të blerësit. Në funksion të këtij parashikimi është shtuar aneksi 3 “Formular për kërkesë dhe miratim të shtyrjes së afatit të pagesës”.

Vlerësojmë se ERE, si organi që monitoron zbatimin e kontratave ndërmjet të licencuarve dhe përmbushjen e detyrimit të shërbimit publik, duhet të ketë dijeni për çdo rast kur blerësi i ngarkuar me



këtë detyrim (FSHU) has vështirësi likuiditeti që e detyrojnë të kërkojë shtyrje pagese, pasi kjo kontratë nuk është një marrëveshje tregtare e zakonshme, por instrumenti konkret nëpërmjet të cilit zbatohet detyrimi i shërbimit publik i vendosur nga shteti; një përsëritje apo përkeqësim i këtyre rasteve prek drejtpërdrejt qëndrueshmërinë financiare të vetë modelit të detyrimit të shërbimit publik, jo vetëm marrëdhënien dypalëshe të palëve. Për këtë arsye, vlerësojmë se neni duhet të riformulohet në mënyrë që blerësi, njëkohësisht me paraqitjen e kërkesës për shtyrje pranë shitësit, të njoftojë brenda të njëjtit afat edhe ERE-n, duke na siguruar informacionin e nevojshëm për ushtrimin e funksionit të saj monitorues.

Për raste të veçanta, me kërkesë zyrtare të arsyetuar të blerësit, paraqitur jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune përpara datës së maturimit të faturës përkatëse, shitësi mund të bie dakord për ndryshimin e datës së maturimit të asaj fature. Për këtë qëllim, blerësi, në të njëjtin afat prej 5 (pesë) ditësh pune, njofton njëkohësisht edhe Entin Rregullator të Energjisë (ERE). Kërkesa dhe miratimi i shtyrjes së afatit të pagesës së faturës do të bëhet sipas formularit të aneksit 3 të kësaj kontrate. Me miratimin e kërkesës, palët përcaktojnë datën e re të maturimit. Ndryshimi i datës së maturimit nuk mund të kalojë një periudhë më të gjatë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga data fillestare e maturimit. Data e re e maturimit konsiderohet si data e detyrimit të pagesës për faturën përkatëse dhe deri në këtë datë, pagesa nuk konsiderohet e vonuar. Pas skadimit të afatit të ri të maturimit, çdo pagesë e papaguar konsiderohet e vonuar dhe i nënshtrohet automatikisht interesave të vonës dhe mjeteve ligjore të parashikuara në këtë kontratë dhe në legjislacionin në fuqi.”.

- Propozohet shtimi i aneksit III “Formular për kërkesë dhe miratim të shtyrjes së afatit të pagesës”, i cili operacionalizon procedurën e parashikuar në nenin 14.

3. Përditësimi i bazës ligjore

- Në kontratën e nënshkruar për vitin 2026, janë reflektuar saktësimet teknike në përputhje me fazën e katërt të hapjes së tregut, sipas urdhrit nr. 322, datë 30.12.2024, të ministrit përgjegjës për energjinë.

- Në bazën ligjore të kontratës është shtuar referenca ndaj vendimit nr. 1212/1 prot., datë 19.2.2026, të ministrit përgjegjës për energjinë, për

miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për furnizimin e FSHU sh.a. gjatë vitit 2026.

- Gjatë shqyrtimit të kontratës u konstatua se referencat ndaj ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, duhet të zëvendësohen me referencat përkatëse të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i cili ka hyrë në fuqi më 15.7.2026. Për këtë arsye, KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. duhet të depozitojnë kontratën me bazën ligjore të përditësuar sipas ligjit të ri, pasi vlerësojmë se dispozitat kalimtare të po këtij ligji (neni 135, pika 4, dhe neni 136, pika 2) parashikojnë se: aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 43/2015 (pra VKM-ja nr. 456/2022, dhe në vijim të saj kontrata tip e miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 95/2024, ndryshuar me vendimin nr. 133/2025) vazhdojnë të zbatohen, për aq sa nuk bien ndesh me ligjin e ri, derisa të nxirren aktet e reja nënligjore sipas ligjit të ri, të drejtat dhe detyrimet ekzistuese të pjesëmarrësve në treg vazhdojnë të përmbushen deri në hyrjen në fuqi të akteve të reja.

- Konkretisht vlerësojmë se:

- “Bazë ligjore”, rreshti i parë (f. 1) “Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, neni 20 germa “h”),” duhet të zëvendësohet me: “Ligjit nr. 59/2026 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neni 20, germa “h”, neni 135, pika 4, dhe neni 136, pika 2”.

- “Në kushtet kur:”, pika e parë (f. 2)”...në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 109, të ligjit nr. 43/2015, referenca duhet zëvendësuar me “...në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 106, nenit 135, pika 4, dhe nenit 136, pika 2, të ligjit nr. 59, datë 18.6.2026, “Për sektorin e energjisë elektrike.”.

- Neni 8, pika 1, “Përkufizimi i Forcës Madhore”...siç përcaktohet në ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar...” zëvendësohet me “...ligjin nr. 59/2026, neni 3, pika 25, neni 135, pika 4, dhe neni 136, pika 2”.

4. Konsultimi publik

- Në zbatim të: Rregullores për procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik të akteve të miratuara nga ERE, kontrata është publikuar në faqen zyrtare të internetit të ERE-s në rubrikën “Konsultime” më datë 8.7.2026 dhe nuk rezulton të jenë paraqitur komente apo sugjerime nga palë të treta.

5. Vlerësimi i ERE-s



- Kontrata e depozituar nga KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. për vitin 2026 mbështetet në kontratën tip të miratuar nga Bordi i ERE-s dhe përbën aktin operativ që rregullon marrëdhëniet ndërmjet palëve për periudhën 1.1.2026–31.12.2026, në përputhje me pikën 4, të nenit 5, të VKM-së nr. 456, datë 29.6.2022, të ndryshuar.

- Neni 5, pika 4, i VKM-së nr. 456, datë 29.6.2022, i ndryshuar, parashikon se ndërmjet FSHU sh.a. dhe shoqërisë publike të prodhimit “negociohet kontrata, e cila miratohet nga ERE dhe nënshkruhet nga palët”, pa e cilësuar atë si “kontratë tip”. Kontrata tip, miratuar me vendimin nr. 95, datë 20.5.2024, ndryshuar me vendimin nr. 133, datë 7.7.2025, përbën aktin rregullator-model mbi bazën e të cilit negociohet e nënshkruhet kontrata konkrete e parashikuar nga dispozita e sipërcituar. Rrjedhimisht, kontrata e nënshkruar nga KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. për periudhën 1.1.2026–31.12.2026 përbën vetë “kontratën” sipas nenit 5, pika 4, të VKM-së nr. 456/2022, e jo kontratën tip, term që mbetet i rezervuar për aktin e miratuar me vendimet nr. 95/2024 dhe nr. 133/2025, në përputhje edhe me dispozitat kalimtare të neneve 135, pika 4, dhe 136, pika 2, të ligjit nr. 59/2026. Për sa më sipër, vlerësojmë se togfjalëshi “Kontratë tip” duhet zëvendësuar me “Kontrata” kudo në tekstin e kontratës konkrete.

- Për sa më sipër, vlerësohet të miratohen shtesat dhe ndryshimet e propozuara në kontratën tip, ndërsa KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. duhet të përditësojnë referencat ligjore në përputhje me nenet 20, germa “h”, 135 pika 4 dhe 136, pika 2, e ligjit nr. 59/2026 dhe të depozitojnë pranë ERE-s kontratën e nënshkruar me ndryshimet e reflektuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë shtesat dhe ndryshimet e propozuara në kontratën “Për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e

shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti (KESH sh.a.) dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a. për periudhën 1.1.2026–31.12.2026, lidhur në zbatim të kontratës tip, miratuar me vendimin nr. 95, datë 20.5.2024, ndryshuar me vendimin nr. 133, datë 7.7.2025, duke përfshirë shtimin e aneksit III “Formular për kërkesë dhe miratim të shtyrjes së afatit të pagesës” (tabela bashkëlidhur).

2. Shoqëria e Prodhimit të Energjisë Elektrike, e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, KESH sh.a. dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., të zëvendësojë kudo në tekst referencën e ligjit nr. 43/2025 me referencën ligjore të ligjit nr. 59/2026, si dhe të zëvendësojnë kudo në tekstin e kontratës togfjalëshin “Kontratë tip” me “Kontrata” (tabela bashkëlidhur).

3. Kontrata e nënshkruar nga palët me ndryshimet sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, të dërgohet në ERE brenda 5 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

4. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqëritë KESH sh.a., FSHU sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Petraq Lika



SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË NGARKUAR ME
DETYRIMIN E SHËRBIMIT PUBLIK, AKSIONET E SË CILËS KONTROLLOHEN
PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI (KESH SHA) DHE FURNIZUESI I
SHËRBIMIT UNIVERSAL (FSHU) SHA, PËR FURNIZIMIN E KLIENTËVE QË
FURNIZOHEN NGA FSHU SHA, PËR PERIUDHËN 1.1.2026–31.12.2026, LIDHUR NË
ZBATIM TË KONTRATËS TIP, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 95, DATË 20.5.2024,
NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR. 133, DATË 7.7.2025, DUKE PËRFSHIRË SHTIMIN E
ANEKSIT III “FORMULAR PËR KËRKESË DHE MIRATIM TË SHTYRJES SË AFATIT TË
PAGESËS”

Lloji	Vendndodhja	Ishte	Bëhet
Ndryshon dhe bëhet	Kudo në tekstin e kontratës togfjalëshi “Kontratë tip” zëvendësohet me “kontrata”	Togfjalëshi “Kontratë tip”.	Togfjalëshi “Kontrata”.
Ndryshon dhe bëhet	Baza ligjore, rreshti i parë	<i>“Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, neni 20 germa “h”</i>	“Ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neni 20, germa “h”, neni 135, pika 4, dhe neni 136, pika 2”.
Ndryshon dhe bëhet	Në kushtet kur	<i>“...në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 109, të ligjit nr. 43/2015, referenca”</i>	“...në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 106, nenit 135, pika 4, dhe nenit 136, pika 2, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike.”.
Ndryshon dhe bëhet	Neni 8, pika 1, “Përkufizimi i Forcës Madhore”	<i>“...siç përcaktohet në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar”.</i>	“...siç përcaktohet në Ligjin nr. 59/2026, neni 3, pika 25, neni 135, pika 4, dhe neni 136, pika 2.”.
Shtesë	Neni 3, Përkufizimet (pika e re 16.1)	(nuk ekziston në kontratën tip të miratuar me vendimin nr. 95/2024, të ndryshuar me vendimin nr. 133/2025)	Shtohet pika 16.1: “Data e maturimit të faturës”, është data e fundit e periudhës së pagesës së faturës.
Ndryshon dhe bëhet	Neni 9, pika 2, germa “b” (fjalë e fundit)	“Pagesat sipas faturave sistemuere mes palëve do të bëhen brenda 45 ditëve nga dita e fundit e livrimit për muajin përkatës.”.	“Pagesa e faturave sistemuere mes palëve do të bëhet brenda 45 ditëve nga dita e lëshimit të faturës.”.
Ndryshon dhe bëhet	Neni 14, pika 1 (paragrafi i fundit)	“Paraqitja e kësaj fature do të bëhet brenda datës 10 të muajit pasardhës të livrimit të energjisë elektrike.”.	“Fatura përkatëse do të lëshohet jo më vonë se data 10 e muajit pasardhës të livrimit të energjisë elektrike.”.
Ndryshon dhe bëhet	Neni 14, “Pagesa” (paragrafi kryesor)	“Pagesa e faturës principale do të bëhet brenda 45 ditëve nga data e lëshimit të faturës tatimore. Për faturat sistemuere, data e pagesës do të jetë e njëjtë me faturën principale për të cilën bëhet sistemimi.”.	“Pagesa e faturave do të bëhet brenda 45 ditëve nga data e lëshimit të faturës tatimore. Afati i pagesës së faturave sistemuere do të jetë i njëjtë me faturën për të cilën bëhet sistemimi.”.
Shtohet	Neni 14 (pikë e re 3) dhe aneksi 3 i ri	(nuk ekziston në kontratën tip)	Shtohet pika 3: “Ndryshimi i datës së maturimit të faturës: Për raste të veçanta, me kërkesë zyrtare të arsyetuar të blerësit, paraqitur jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune përpara datës së maturimit të faturës përkatëse, shitësi mund të bie dakord për ndryshimin e datës së maturimit të asaj fature. Për këtë qëllim, blerësi, në të njëjtin afat prej 5 (pesë) ditësh pune, njofton njëkohësisht edhe Entin Rregullator të Energjisë (ERE).



			Kërkesa dhe miratimi i shtyrjes së afatit të pagesës së faturës do të bëhet sipas formularit të aneksit 3 të kësaj kontrate. Me miratimin e kërkesës, palët përcaktojnë datën e re të maturimit. Ndryshimi i datës së maturimit nuk mund të kalojë një periudhë më të gjatë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga data fillestare e maturimit. Data e re e maturimit konsiderohet si data e detyrimit të pagesës për faturën përkatëse dhe deri në këtë datë, pagesa nuk konsiderohet e vonuar. Pas skadimit të afatit të ri të maturimit, çdo pagesë e papaguar konsiderohet e vonuar dhe i nënshtrohet automatikisht interesave të vonës dhe mjeteve ligjore të parashikuara në këtë kontratë dhe në legjislacionin në fuqi.”.
--	--	--	--

Shtohet: Aneksi III

“ANEKS III

FORMULAR PËR KËRKESË DHE MIRATIM TË SHTYRJES SË AFATIT TË PAGESËS

Referuar kontratës nr... , datë ... ndërmjet:

Shitësi: Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a.

dhe

Blerësi: Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a.

Blerësi paraqet kërkesë për shtyrjen e afatit të pagesës për faturën e mëposhtme:

1. Numri i faturës:
2. Data e faturës:
3. Vlera e faturës:
4. Data aktuale e maturimit:
5. Data e re e kërkuar e maturimit:
6. Arsyeja kërkesës për

[Përshkrimi i detajuar i rrethanave dhe dokumentacionit mbështetës]

Blerësi deklaron se informacioni i mësipërm është i saktë dhe se kërkesa paraqitet në përputhje me kontratën.

Palët bien dakord që data e re e maturimit për faturën e sipërpërmendur të jetë

Për qëllime të kontratës dhe të ligjit nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, data e mësipërme do të konsiderohet data e re e maturimit të detyrimit dhe pagesa nuk do të konsiderohet e vonuar përpara skadimit të saj.

Ky miratim vlen vetëm për faturën e identifikuar në këtë formular dhe nuk përbën heqje dorë nga asnjë e drejtë tjetër e shitësit sipas kontratës.

Miratuar nga KESH: Miratuar nga FSHU:

**VENDIM****Nr. 209, datë 24.7.2026****MBI MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 139, DATË 14.4.2023, “MBI MIRATIMIN E KUFIJVE MINIMALË DHE MAKSIMALË TË LEJUAR TË ÇMIMIT PËR TREGUN E DITËS NË AVANCË”**

Në zbatim të neneve 16, 18, pika 1, germa “a” dhe “dh”; 19, germa “a”; 121, 122 dhe 136, pika 2, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikës 3.5, të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; të “Rregullave të tregut të energjisë elektrike” (kushtet e përgjithshme, përkufizimet, procedura e tregtimit si dhe procedura e klerimit dhe shlyerjes), të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022, të ndryshuara; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.7.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 957/7 prot., datë 21.7.2026, të për gatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Zhvillimit të Burimeve të Rinovueshme, “Mbi miratimin e një ndryshimi në vendimin të Bordit të ERE-s nr. 139, datë 14.4.2023, ‘Mbi miratimin e kufijve minimalë dhe maksimalë të lejuar të çmimit për tregun e ditës në avancë’”.

konstatoi se:

- Shoqëria “ALPEX” sh.a., me shkresën nr. 170 prot., datë 18.3.2026, protokolluar në ERE me nr. 957 prot., datë 24.3.2026, i parashitroi ERE-s propozimin për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 139, datë 14.4.2023, “Mbi miratimin e kufijve minimalë dhe maksimalë të lejuar të çmimit për tregun e ditës në avancë”, duke propozuar që kufiri minimal i lejuar i çmimit për tregun e ditës në avancë të ndryshojë nga 0 €/mwh në -50 €/mwh, ndërsa kufiri maksimal i lejuar të mbetet i pandryshuar, në vlerën +900 €/mwh.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 131, datë 21.5.2026, vendosi fillimin e procedurës për një

ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 139, datë 14.4.2023, “Mbi miratimin e kufijve minimalë dhe maksimalë të lejuar të çmimit për tregun e ditës në avancë”, lidhur me kufirin minimal të lejuar të çmimit për tregun e ditës në avancë, të propozuar nga “ALPEX” sh.a., nga 0 €/mwh në -50 €/mwh.

- Në zbatim të vendimit nr. 131/2026, me shkresën nr. 957/6, datë 26.5.2026, ERE njoftoi shoqëritë “ALPEX” sh.a., “OST” sh.a., “KESH” sh.a., “FTL” sh.a., Shoqatën Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), shoqatën “Albania Renewable Energy Association” (AREA), si dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), për fillimin e procedurës për ndryshimin e propozuar. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Gjithashtu, ERE publikoi njoftimin për fillimin e procedurës në faqen zyrtare të internetit, në rubrikën konsultime (më datë 22.5.2026), duke përfshirë dhe kërkesën e bërë nga “ALPEX” sh.a. në shkresën me nr. 170 prot. datë 18.3.2026 të protokolluar në ERE me nr. 957 prot., datë 24.3.2026, dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët, nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Rezulton se përgjatë vitit 2025 në tregun e ditës në avancë në të dyja zonat e ofertimit janë shënuar rritje të volumeve të tregtuara në “ALPEX” sh.a., me rreth 39% krahasuar me vitin 2024.

- Gjithashtu, volumi total i tregtuar nga “ALPEX” sh.a., për vitin 2025 në tregun e ditës në avancë në zonën e ofertimit në Shqipëri arriti vlerën 1,017,823 mwh duke shënuar një rritje të volumeve me rreth 26% krahasuar me vitin 2024 që rezultoi në sasinë prej 807,328 mwh.

- “ALPEX” sh.a., është pranuar si vëzhgues në SDAC që prej datës 7 shkurt 2025. Në tregun e vendeve anëtare të SDAC-së është tashmë praktikë pasja dhe operimi me çmime negative në treg. Në vendet e Ballkanit të cilat nuk janë pjesë e BE-së aktualisht ka filluar aplikimi i çmimeve negative.

- Sipas të dhënave të publikuara për 4-mujorin e parë të vitin 2026 të “ALPEX” sh.a. për zonën e ofertimit të Shqipërisë në tregun DAM rezultojnë të tregtuara në sasinë 470,762 mwh me një rritje pothuajse dyfishi i sasisë së tregtuar në “ALPEX” sh.a., për të njëjtën periudhë të vitit 2025, ku volumet e tregtuara rezultojnë në 238,368 mwh.



- Ky element tregon ruajtjen e një tendence të fortë të rritjes së volumeve të cilat tregtohen në bursën e energjisë elektrike, element ky që kërkon më shumë fleksibilitet në operimin e këtij tregu nga “ALPEX” sh.a., për t’u përgjigjur volumeve gjithmonë në rritje të tregtuara.

- Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 347/2022, i ndryshuar, aplikohen nga “ALPEX” sh.a., në të dyja zonat e ofertimit, të Shqipërisë dhe të Kosovës.

- Vlerësohet që kufiri minimal i lejuar i çmimit për tregun e ditës në avancë për zonën e ofertimit të Shqipërisë, i cili propozohet të bëhet -50 €/mwh, është një qasje propocionale dhe graduale drejtë kufirit të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 265, datë 10.12.2024, ku evidentohet se çmimi minimal klerues është parashikuar -500 €/mwh. Ky çmim i propozuar për zonën e ofertimit të Shqipërisë në -50 €/mwh përbën vetëm 10 % të atij të miratuar për tregun e bashkuar ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë prej -500 €/mwh.

- Aktualisht, në “ALPEX” sh.a. operojnë kompani vendase dhe të huaja të cilat janë pjesëmarrëse në bursat evropiane të cilat karakterizohen nga pranimi i çmimeve negative si pjesë integrale e formimit të lirë të çmimit klerues në tregjet e energjisë elektrike, ndaj është vlerësuar që të ndiqet një qasje graduale drejt përafrimit me këto praktika.

- Miratimi i ndryshimit të çmimit minimal klerues në -50 EUR/mwh do të krijojë një fleksibilitet të shtuar për aktivizimin e mekanizmit të ankandit të dytë në tregun e ditës në avancë për faktin se që prej vitit 2024 e në vijim në këtë treg vijnë urdhërporosi me çmime negative.

- Në vijim, për sa i përket vitit 2026, që prej muajit janar dhe deri më 18 prill janë regjistruar 13 (trembëdhjetë) raste të arritjes së kufirit minimal të lejuar të çmimit të tregut të ditës në avancë prej 0 €/mwh dhe në asnjë prej këtyre rasteve anëtarët e bursës nuk kanë ndryshuar ofertat e tyre gjatë aktivizimit të ankandit të dytë, duke treguar se mekanizmi i përdorur nuk ka ndikuar në arritjen e objektivit të tij.

- Sikurse argumentuar më sipër, çmimi minimal klerues prej -50 EUR/mwh respekton një qasje graduale dhe rrit fleksibilitetin për aktivizimin e ankandit të dytë në procesin e rritjes së volumeve të cilat tregtohen në DAM nga “ALPEX” sh.a.

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, u shfuqizua shprehimisht me nenin 136, pika 1, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”, hyrë në fuqi më 15.7.2026. Sipas nenit 136, pika 2, të ligjit nr. 59/2026, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 43/2015, i ndryshuar, ndër to vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe rregullat e tregut të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022, të ndryshuara, vazhdojnë të zbatohen për aq kohë sa nuk bien në kundërshtim me ligjin e ri, deri në miratimin e akteve të reja nënligjore në zbatim të tij. Për rrjedhojë, baza ligjore e këtij vendimi mbështetet në dispozitat përkatëse të ligjit nr. 59/2026, në vijimësi me aktet nënligjore ende në fuqi, sipas dispozitës kalimtare të sipërpërmendur.

- Në mbështetje të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, vlerësohet ndryshimi i pikës 1, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 139, datë 14.4.2023, si vijon: **Ishte:** Kufiri minimal i lejuar i çmimit për tregun e ditës në avancë: 0 €/mwh; **Bëhet:** Kufiri minimal i lejuar i çmimit për tregun e ditës në avancë: -50 €/mwh.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 139, datë 14.4.2023, lidhur me kufirin minimal të lejuar të çmimit për tregun e ditës në avancë.

2. Pika 1, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 139, datë 14.4.2023, për kufirin minimal të lejuar të çmimit për tregun e ditës në avancë, ndryshon si vijon:

“a) Kufiri minimal i lejuar i çmimit për tregun e ditës në avancë: -50 €/mwh.”.

3. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Zhvillimit të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe palët e tjera të interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Petraq Lika

KËRKESË
Nr. 796/16, datë 4.8.2026

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Pastrim i kolektorit nga rruga ‘Demokracia’ deri tek rruga ‘Vasil Puka’, Bashkia Vlorë”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Vlorë.

1. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për

pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit “truall+ndërtësë”, bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave”, dhe vlerësimi i pasurisë së llojit “ndërtësë” është llogaritur bazuar në VKM-në nr. 138, datë 3.2.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë për interes publik”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit pranë Bashkisë Vlorë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është prej 1,732,845 (një milion e shtatëqind e tridhjetë e dy mijë e tetëqind e dyzet e pesë lekë).

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena



LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “PASTRIMI I KOLEKTORIT NGA RRUGA ‘DEMOKRACIA’ DERI TEK RRUGA ‘VASIL PUKA’, BASHKIA VLORE”

Pronari		Të dhëna hipotekore								Vlerësimet për shpronësim							
Nr.	Emër/Mbiemër	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m²)	Trrall (m²)	Ndërtësë (m²)	Volum	Faqe	Trrall			Ndërtësë			Vlera totale (lekë)	Shënime
										Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sip. e shpronësuar (m²)	Çmimi (lekë / m²)	Vlera (lekë)		
1	Fatmira Canaj (Fataj) Kimet Fataj Gezime Koço (Fataj) Servet Fataj Petrin Fataj Hava Fataj Qerem Fataj	8605	37/118	Trrall dhe ndërtësë	35	35	35	18	133	1	8300	8,300	35	32,625.29	1,141,885	1,150,185	Duke qenë objekt i llojit jobanimi, në bazë të VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, llogaritjet janë bërë me situacion punimesh. Seksioni E: Lokal 2-katësh me leje ndërtimi me ref. 07664. Aktualisht objekti është 1-katësh.
2	Artur Dhano	8605	38/32	Trrall	219	219	0	11	9	24.3	8300	201,690	0	0	-	201,690	
3	Hysen Bimo Kadri Bimo	8605	38/6	Trrall	120	120	0	14	142	45.9	8300	380,970	0	0	-	380,970	Seksioni D: Me nr. 0006598 datë 10.7.2006. Mungon e dëshmia e trashëgimisë e Zenel Bimo.
VLERA PARAPRAKE															-	1,732,845	



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 304 lekë



[[FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË[Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare]Viti: 2026 - Numri: 177]Datë: 10.08.2026 14:40:24
+02:00[[fd094d26-44e4-4721-9845-37e0423f093b

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik(Qendra e Botimeve Zyrtare)